

Hartëzimi i Shërbimeve Sociale



në Shqipëri

2025



Leave
No One
Behind



Hartëzimi i Shërbimeve Sociale në Shqipëri 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

Ekspertiza dhe asistenca teknike për përgatitjen e këtij dokumenti është mbështetur nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara – PNUD, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas” faza e dytë (LNB2), që zbatohet në partneritet me Qeverinë Shqiptare dhe financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të PNUD në Shqipëri.

Tiranë, Prill 2025

Të dhënat e këtij raporti i përkasin periudhës Janar 2025.

Përgatitur nga:

Prof. Asoc. Dr. Arlinda Ymeraj

Ndihmuan:

Ermelinda Jankishta, specialiste e shërbimeve shoqërore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Shërbimi Social Shtetëror Rajonal, degët Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Shkodër, Korçë, Berat, Lezhë, Dibër, Kukës, Gjirokastrë dhe Vlorë.

Punonjësit e drejtorive të shërbimit social në 61 bashkitë e vendit.

Punonjësit e institucioneve të përkujdesit social në të gjitha institucionet publike dhe “Jo-Publike” të vendit.

I.	Hyrje	7
II.	Shkurtesa	8
III.	Përmbledhje	10
IV.	Lista e tabelave dhe figurave	16
V.	Metodologjia	20
	V.1 Instrumentat dhe metoda e kërkimit	20
	V.2 Analiza në nivel kombëtar	21
	V.3 Analiza në nivel rajonal/bashki	22
	V.4 Terminologjia, përkufizimet dhe baza ligjore	23
	Kapitulli 1: Analiza në nivel kombëtar	26
	1.1. Ofruesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror/shërbimet e siguruara për qytetarët në nevojë	26
	1.2. Përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në nivel qarku	47
	1.3. Burimet njerëzore, financiare dhe institucionale, në funksion të shërbimeve të përkujdesit shoqëror	58
	1.3.1. Përdorimi i aplikimit për Fondin Social	64
	1.4. Vlerësimi i nevojës për shërbime të përkujdesit shoqëror	65
	Kapitulli 2: Analiza në nivel qarku/bashkie	70
	2.1. Bashkitë e qarkut Berat	72
	2.2. Bashkitë e qarkut Durrës	81
	2.3. Bashkitë e qarkut Dibër	88
	2.4. Bashkitë e qarkut Elbasan	96
	2.5. Bashkitë e qarkut Fier	106
	2.6. Bashkitë e qarkut Gjirokastrë	116
	2.7. Bashkitë e qarkut Korçë	126
	2.8. Bashkitë e qarkut Kukës	135
	2.9. Bashkitë e qarkut Lezhë	143
	2.10. Bashkitë e qarkut Shkodër	151
	2.11. Bashkitë e qarkut Tiranë	160
	2.12. Bashkitë e qarkut Vlorë	169
	Kapitulli 3: Vlerësime përfundimtare dhe rekomandime	180
	Kapitulli 4: Shtojcat	182
	Shtojca 1 Tregues jo të drejtpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime	182
	Shtojca 2 Grupet në nevojë (numër dhe individë) dhe shkalla e plotësimit të nevojës në %	184
	Shtojca 3 Shërbimet sipas tipologjisë dhe llojit të ofruesve	190
	Shtojca 4 Shërbimet e kujdesit social sipas llojit, 2021-2025	196
	Shtojca 5 Pyetësor	206



I. HYRJE

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, 2024-2030, nënvizon se “Zgjerimi i shërbimeve sociale të integruara, të aksesueshme e cilësore dhe të përgjegjshme gjinore si dhe avancimi i deinstitutionalizimit, në partneritet me pushtetin vendor dhe aktorët e tjerë”, është një nga dy shtyllat e politikës të mbrojtjes sociale në Shqipëri. Ky qëllim do të realizohet nëpërmjet tre objektivave specifike, përkatësisht: Konsolidimit të procesit të decentralizimit të shërbimeve të kujdesit social për financim të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm gjinor, mbulim gjeografik, aksesueshmëri dhe që i përgjigjen krizave dhe emergjencave; Zbatimit të standardeve dhe forcimit të kapaciteteve njerëzore të personelit të shërbimeve të kujdesit social për shërbime efektive dhe të përgjegjshme gjinore; si edhe Deinstitutionalizimit të shërbimeve të kujdesit rezidencial dhe zhvillimit të shërbimeve në familje, komunitare dhe ditore duke respektuar parimin e të drejtave të njeriut dhe respektimet gjinore.

Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm drejt krijimit të një shteti demokratik, një ekonomie tregu funksionale, ruajtjes së rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe arritjes së zhvillimit njerëzor. Për të mbështetur përfshirjen sociale të përmirësuar, Agjencitë e OKB-së janë angazhuar në zbatimin e projektit Programi i përbashkët i Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas, faza e dytë” (LNB2) synon të fuqizojë individët dhe grupet e përjashtuara që të kenë mundësi të barabarta në përdorimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, kështu, duke ndihmuar pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrjen publike, për çështje që ndikojnë në jetën e tyre dhe në atë të shoqërisë shqiptare si edhe në rritjen e përgjegjshmërisë të institucioneve – sigurues të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Programi LNB 2 është një program i rëndësishëm zhvillimi për qeverinë shqiptare, në veçanti për Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Shoqërore, që është edhe partneri kryesor. Ky program zbatohet nga UNDP, UNICEF, UN Women, dhe UNFPA me mbështetje financiare të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Mbështetja e ofruar për Shërbimin Social Shtetëror për hartëzimin e shërbimeve të kujdesit social në Shqipëri, si pjesë e programit LNB, është një komponent i mbështetjes ndaj qeverisë qendrore për të zbatuar dhe monitoruar politikat dhe legjislacionin kombëtar ekzistues që promovojnë përfshirjen sociale.

Në vijim të këtij procesi, janë ndërmarrë disa inisiativa të hartëzimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, më i fundit në Korrik 2023, të cilat kanë synuar përveç identifikimit të shërbimeve sipas vendndodhjes, llojit, mënyrës së administrimit dhe financimit, tipologjisë, grupeve përfituese, edhe vlerësimin të nevojës për shërbime me qëllim orientimin e investimeve për ngritjen e shërbimeve të reja, sa më pranë nevojës.

Në këtë këndvështrim, Hartëzimi i Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror 2025, në përputhje të plotë me objektivat e programit LNB2, ndërmjet të tjerave, sjell risitë që vijnë:

- Krahasimin e numrit të shërbimeve me periudhat paraardhëse dhe vlerësimin e shpërndarjes të shërbimeve të reja në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal;
- Rolin e Fondit Social në ngritjen e shërbimeve të reja si edhe në zvogëlimin e pabarazive ndërmjet bashkive dhe grupeve në kushte më kritike;
- Vlerësimin e shkallës së përfshirjes të bashkive në sigurimin e shërbimeve pranë komuniteteve të qytetarëve;
- Vlerësimin e nivelit të plotësisht të nevojës për shërbime në përgjithësi, sipas grupeve dhe në çdo bashki të vendit;
- Vlerësimin e Koefficientit të Mjaftueshmërisë Akomoduese të sistemit në nivel bashkie.

Hartëzimi i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, sjell evidenca teknike të mjaftueshme, të plota dhe shumë dimensionale, të vlefshme për mbështetjen e debatit politik mbi drejtimit e zhvillimit të sistemit në të ardhmen, me qëllim realizimin e të drejtës së qytetarëve për mbrojtje shoqërore në çdo bashki të vendit.

II. SHKURTESA

AK	Aftësi të kufizuara
DRSHSH	Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve Shoqërore
FJKP	Fëmijë Jashtë Kujdesit Prindëror
KMA	Koeficienti i Mjaftueshmërisë Akomoduese
LNB 2	Leave no one behind 2 (Askush të mos mbetet pas)
MIS	Menaxhimi i Sistemit të Informacionit për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NjMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
NjVNR	Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
UN Women	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Gratë
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

SHKURTESA në Tabelat 2 të qarqeve

O	Ofrues të shërbimeve të përkujdesit shoqëror
Sh	Shërbimeve të përkujdesit shoqëror
P	Përfitues të shërbimeve të përkujdesit shoqëror




III.

PËRMBLEDHJE

Raporti i studimit “Hartëzimi i Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror” mbështetur në metodologjinë e ndërtuar për qëllim të këtij studimi, duke përdorur të dhëna dhe informacione të mbledhura nga punonjësit e sektorëve të mbrojtjes dhe shërbimeve shoqërore në të gjitha bashkitë e vendit, analizon sistemin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në Shqipëri në drejtim të:

- Shërbimeve të ofruara për qytetarët në nevojë dhe mundësisë të tyre për të aksesuar shërbime.
- Përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe mundësisë së tyre për të plotësuar nevojën.
- Vlerësimit të kapaciteteve administrative dhe institucionale, njerëzore dhe financiare në raport me funksionimin efektiv të sistemit.
- Vlerësimit të nevojës për shërbime të përkujdesit shoqëror.



Analiza në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror identifikoi disa arritje thelbësore, siç vijojnë:

- ✓ Metodologjia e mbledhjes të të dhënave ka mundësuar vlerësimin e **nevojave për shërbime**.
- ✓ Numri i shërbimeve të përkujdesit shoqëror është rritur në krahasim me vitin 2023 (**13% më shumë ofrues, 56% më shumë shërbime, 11% më shumë përfitues**).
- ✓ Gjatë periudhës 2023-2025, **roli i fondit social ka ardhur duke u rritur**. Ky fond ka mundësuar funksionimin e 78 ofruesve të shërbimeve (18%), që sigurojnë shërbime për 5.457 përfitues (15%) të përfituesve.
- ✓ Numri i përfituesve, 2021-2025, është rritur me 29%, kryesisht për shkak të rritjes të numrit të ofruesve publikë të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.
- ✓ **Qendrat komunitare të shërbimeve sociale** përbëjnë 22% të shërbimeve, mbështesin 28% të përfituesve nëpërmjet 21 % të të gjitha shërbimeve të përkujdesit shoqëror.
- ✓ **Shërbimet e lëvizshme**, të sapo krijuara, të financuara nga Fondi Social, edhe pse përbëjnë vetëm 8% të ofruesve, konsiderohen si formë e përshtatshme dhe jo shumë e kushtueshme e plotësimit të nevojës për shërbime. Ato sigurojnë 9% të shërbimeve për 7% të përfituesve.
- ✓ **Pushteti lokal është më i ndërgjegjshëm për përgjegjësitë** e tij në lidhje me ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror. Pushteti lokal financon 32 % të shërbimeve publike ose 19% të të gjitha shërbimeve.


Analiza në nivel kombëtar e Ofruesve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, evidentoi se:

- Sot në Shqipëri ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror 439 ofrues, të cilët sigurojnë funksionimin e 1.669 shërbimeve të përkujdesit shoqëror për 39.091 përfitues, individë në nevojë.
- Kategorizimi i ofruesve edhe sipas burimit të financimit ri-konfirmon rritjen e përgjegjshmërisë të bashkive, të cilat financojnë të vetme 32 % të shërbimeve publike ose 19% të të gjitha shërbimeve.
- Qarku i Kukësit vijon të jetë qarku me numrin më të vogël të shërbimeve, ndërsa ka pësuar rritje numri i shërbimeve në qarkun e Lezhës, të Fierit dhe veçanërisht, në qarkun e Gjirokastrës. Numri i shërbimeve në qarkun e Elbasanit në krahasim me qarqet e Korçës dhe Durrësit ka pësuar ulje, ndërsa qarku i Tiranës vijon të jetë qarku me numrin më të madh të shërbimeve.
- Tirana siguron më shumë se 1/5 e shërbimeve (23%), e ndjekur nga Korça, 19% dhe Shkodra, (12%) e Elbasani, 11%, për të vijuar me qarqet e tjera, të cilat së bashku sigurojnë rreth 35% të shërbimeve.
- Shërbimet "Parashoqërore" përbëjnë 22% të të gjitha shërbimeve, të pasuara nga ato "Komunitare" dhe "Të specializuara", 13%.

- Shërbimet më pak të përhapura janë "Strehëzat" dhe "Kujdesi alternativ", përkatësisht me 3%.
- Shkalla e shpërndarjes së shërbimeve sipas tipologjisë është deri diku e njëtrajtshme. Vetëm në Qarkun e Kukësit, Dibrës dhe Lezhës mungojnë përkatësisht 3 tipologji (Rezidenciale, Familje, Kujdesi Alternativ); 2 tipologji (Rezidenciale dhe Kujdesi Alternativ) dhe një tipologji (Strehëza).
- Shërbimet për "Fëmijë me AK" (21%) përbëjnë grupin me peshën më të madhe, të pasuar nga "Shërbime për të moshuarit, 18%. Shërbimet për "Individë të familjeve në nevojë", të cilat dy vite më parë përbënin grupin me peshën më të konsiderueshme, 29%, në këtë vlerësim përbëjnë vetëm 16%. Rritje të ndjeshme kanë pësuar gjithashtu "Shërbimet për të rritur AK", të cilat nga 6%, në këtë vlerësim rezultojnë 11%.
- Numri i bashkive në të cilat nuk ofrohet asnjë shërbim është ulur, nga 8 bashki dy vite më parë në dy bashki, Himarë dhe Konispol.
- Në 40 bashki nga 61, nuk është rritur vetëm numri i ofruesve të shërbimeve, por edhe larmishmëria e tipologjive të tyre. Në 19 bashki tipologjitë e ofruesve nuk kanë ndryshuar. Vetëm në dy bashki, përkatësisht Kamëz e Pustec, është zvogëluar numri i tipologjive, nga dy në një.
- Në krahasim me dy vite më parë, edhe pse jo të gjithë grupet në nevojë kanë të njëjtin akses tek shërbimet, në përgjithësi, mundësia për të përdorur shërbime është rritur, sepse ofruesit dhe shërbimet që ato sigurojnë, janë rritur ndjeshëm.
- Shërbimet parashoqërore, komunitare, në familje, të specializuara dhe emergjente aksesohen kryesisht nga individët me AK, fëmijë ose të rritur, të moshuarit si edhe individët në kushte kritike ekonomike dhe shoqërore.
- Fëmijët jashtë kujdesit prindëror aksesojnë thuajse tërësisht shërbimet e kujdesit alternativ, si edhe "kryesisht" shërbimet rezidenciale.
- Shërbimet e qendrave të zhvillimit përdoren thuajse tërësisht nga individët me AK, fëmijë dhe të rritur, ndonëse të rriturit me mundësi më të kufizuara (të rriturit AK 33% kundrejt 63% që aksesojnë fëmijët AK).

Analiza në nivel kombëtar e Përfituesve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, evidentoi se:

- 44% e përfituesve përfitojnë shërbime nga institucione publike, ndërsa pjesa e mbetur, nga institucionet jo publike.
- 34% e përfituesve të shërbimeve publike, i përkasin Institucioneve që financohen nga bashkitë, 24% e përfituesve të shërbimeve publike i përkasin projekteve të financuara vetëm nga fondi social, ndërsa 28% e përfituesve të shërbimeve Jo-Publike i takojnë institucioneve që financohen nga OJF lokale.
- Individët në nevojë, fëmijët dhe të rriturit AK, gratë në nevojë, komuniteti etnik Rom dhe Egjiptian dhe të moshuarit janë grupet që përfitojnë shërbime në çdo qark të vendit.



- Fëmijët jashtë kujdesit prindëror dhe të "Rinjtë në nevojë" përfitojnë shërbime përkatësisht në 9 dhe në 10 qarqe nga 12.
- Në Dibër, Fier, Kukës nuk ofrohen shërbime për fëmijët jashtë kujdesit prindëror, ndërsa në Durrës e Kukës nuk ofrohen shërbime për grupin " të rinj në nevojë".

Analiza në nivel kombëtar e Kapaciteteve të Ofruesve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror evidentoi se:

- Sot në Shqipëri, janë 4,163 punonjës (11% më shumë se sa në vitin 2023), që planifikojnë, administrojnë, sigurojnë dhe ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror në të gjithë vendin, në bashki dhe ofrues të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, qofshin publike ose jo publike.
- 77% e tyre ose 3,187 punonjës janë të angazhuar me funksionimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror drejtëpërsëdrejti tek ofruesit, ndërsa 23% ose 976 punonjës mbështesin funksionimin e sistemit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në bashkitë e vendit.
- 79% e administratës së shërbimeve të përkujdesit shoqëror në institucione dhe 77% e administratës së shërbimeve në bashki, është e gjinisë femërore.
- 95% e stafit të bashkive është me arsim të lartë dhe pas universitar, ndërsa 69% e stafit të ofruesve të shërbimeve është gjithashtu me arsim të lartë.
- Sektori i NE është ende sektori më i vlerësuar, mirë-organizuar dhe i kompletuar me staf profesionist.
- 5 bashki nuk kanë person të caktuar për NjMF. Funksionet e NjMF realizohen, por nga persona të drejtorisë, të cilët mbulojnë 2 deri 3 funksione. Këto bashki janë: Gramsh, Libohovë, Dropull, Pustec, Pukë.
- Në 41 bashki, funksionet e NjVNR nuk realizohen nga staf i emëruar në atë detyrë.
- Për realizimin e MIS, janë emëruar specialistë vetëm në dy bashki, përkatësisht Gjirokastrë dhe Krujë, ndërsa bashkia Tiranë nuk përdor sistemin MIS për menaxhimin e të dhënave por sistemin Opendata.
- Në 16 bashki nuk ka person të emëruar për të mbuluar funksionet e "Shërbimeve për viktimat e dhunës në familje".
- Në 15 bashki nuk ka person të emëruar për AK.
- Vetëm në 9 bashki ka person të emëruar për "Shërbimet ndaj komunitetit Rom dhe Egjiptian".

Analiza në nivel kombëtar e Nevojës për Shërbime të Përkujdesit Shoqëror, evidentoi se:

- 280.491 persona janë në nevojë për shërbime në Shqipëri, nga të cilët mëse 60% janë të varfër, 28% janë të rritur me AK, 6% janë fëmijë me AK, ndërsa 6% janë të gjitha grupet e tjera.
- Nevoja për shërbime në nivel kombëtar plotësohet në masën 12%, ku grupet më të trajtuara janë: Romët, të Rinjtë, Të moshuarit, Fëmijët jashtë kujdesit prindëror, gratë në nevojë, fëmijët me AK, të varfërit dhe në fund , të rriturit me AK.
- Në qarqet Lezhë, Shkodër, Korçë, Elbasan, Dibër dhe Kukës, numri i personave në nevojë për shërbime është më i lartë se sa mesatarja e vendit.

- Vlera e treguesit të nevojës për shërbime për Elbasanin është 2 herë më e lartë se sa mesatarja e vendit, për Dibrën është 3 herë më e lartë, ndërsa për Kukësin është 5 herë më i lartë.

Analiza në nivel bashkie evidentoi se:

- 39 bashki ose 64% e bashkive plotësojnë më pak se 10% të nevojave për shërbime të përkujdesit shoqëror.
- Vetëm 6 bashki plotësojnë më shumë se sa 25% të nevojave për përkujdes shoqëror, përkatësisht Vlorë dhe Korçë, 27%; Gjirokastrë, 31%, Lushnje 33%, Tirana, 43% dhe Shkodra 47%.
- Të rriturit me AK janë grupi më kritik, në nevojë për shërbime, i konsideruar si i tillë, në më shumë se 80% të bashkive të vendit.
- Individët në nevojë ekonomike janë grupi i dytë kritik, në rreth 70% të bashkive.
- Të rinjtë në nevojë janë grupi i tretë kritik, në rreth 60% të bashkive.
- Gratë në nevojë dhe Fëmijët jashtë kujdesit prindëror janë grupi i katërt, në rreth 55% të bashkive.
- Komuniteti Rom dhe Egjiptian është grupi i gjashtë i konsideruar kritik, në rreth 35% të bashkive.
- Të moshuarit janë grupi i shtatë, në rreth 30% të bashkive.
- Fëmijët me AK janë grupi i tetë, në rreth 25% të bashkive

Përfundimisht, analiza e paraqitur këtu, nënvizon çështjet kritike që vijnë, të cilat duhet të jenë në vëmendje të politikave sociale në të ardhmen:


- Shërbimet e përkujdesit shoqëror si në numër e tipologji vijnë të jenë të pamjaftueshme.
- Shpërndarja e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, pavarësisht përmirësimeve, nuk është e njëtrajtshme nga pikëpamja gjeografike dhe as në përputhje me nevojën apo probleme të tjera ekonomike e sociale të zonave të vendit.
- Ofrimi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror, edhe pse ka filluar të orientohet nga vlerësimi i nevojës, nëpërmjet projekteve të hartuara rreth një qëllimi specifik, ende nuk është i mbështetur në vlerësimin dhe analizën e nevojës për shërbime.
- Hartimi i një metodologjike unike të vlerësimit të nevojës në çdo bashki është kërkesë imediate.
- Miratimi i standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, është gjithashtu kritik.
- Legjislacioni mbi Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror duhet të reflektojë tipologjitë dhe llojet e reja të shërbimeve, tashmë funksionale në nivel vendor si edhe t'i paraprijë modeleve të reja, të përshtatshme që do të zbatohen në të ardhmen.
- Pavarësisht rolit jashtëzakonisht të fuqishëm të mbështetjes së shërbimeve nëpërmjet Fondit Social, çështja e qëndrueshmërisë së shërbimeve është kritike. Bashkitë duhet të vijnë të përpiqen për gjetjen e mënyrave të qëndrueshme të financimit të shërbimeve.
- Bashkëpunimi ndër-sektorial, kryesisht ndërmjet sektorëve jo tradicionalë (bashki-sektor privat) dhe nëpërmjet ngritjes së Ndërmarrjeve Sociale, duhet të promovohet dhe të praktikohet, si instrument efektiv i qëndrueshmërisë.

IV.

LISTA E TABELAVE DHE FIGURAVE

Tabela 1	Ofruesit e përkujdesit shoqëror, shërbimet dhe përfituesit sipas qarqeve, mënyrës së administrimit dhe financimit, numër	26
Tabela 2	Ofruesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe përfituesit, 2023-2025	28
Tabela 3	Ofruesit e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, 2021-2025	30
Tabela 4	Shpërndarja gjeografike e ofruesve të përkujdesit shoqëror, mbulimi i territorit dhe statusi i licencimit	35
Tabela 5	Ofruesit e shërbimeve, shërbimet dhe përfituesit e tyre, sipas tipologjisë së ofruesve, numër dhe përqindje	36
Tabela 6	Kategorizimi i ofruesve sipas burimeve të financimit, numër dhe përqindje	38
Tabela 7	Shërbimet e përkujdesit shoqëror sipas tipologjisë dhe qarqeve, numër	42
Tabela 8	Përmbledhje e numrit të ofruesve sipas tipologjive në bashkitë e vendit dhe kategorimi i tyre sipas tipologjive të ofruesve	45
Tabela 9	Përfituesit e shërbimeve sipas qarqeve, llojit të qendrave të përkujdesit shoqëror si edhe mënyrës së administrimit e financimit të shërbimeve, numër dhe përqindje	48
Tabela 10	Ofruesit dhe përfituesit e mbështetur drejtpërsëdrejti ose në partneritet, nga fondi social, numër dhe përqindje	50
Tabela 11	Përfituesit e shërbimeve sipas qarqeve, grupeve dhe gjinisë, numër	52
Tabela 12	Shërbimet sipas grupeve të përfituesve si edhe përfituesit në numër, sipas qarqeve	54
Tabela 13	Kapacitetet administrative, burimet njerëzore që sigurojnë shërbimet e përkujdesit shoqëror tek ofruesit e shërbimeve	58
Tabela 14	Stafi i bashkive sipas llojit të formimit dhe qarqeve, numër	62
Tabela 15	Përmbledhje e treguesve të vlerësimit të nevojës për shërbime	66
Tabela 1 - 8	Bashkitë e qarkut Berat	73-79
Tabela 1 - 6	Bashkitë e qarkut Durrës	81-86
Tabela 1 - 7	Bashkitë e qarkut Dibër	88-94
Tabela 1 - 10	Bashkitë e qarkut Elbasan	96-104
Tabela 1 - 9	Bashkitë e qarkut Fier	106-114
Tabela 1 - 10	Bashkitë e qarkut Gjirokastrë	116-124
Tabela 1 - 10	Bashkitë e qarkut Korçë	126-134
Tabela 1 - 6	Bashkitë e qarkut Kukës	135-141
Tabela 1 - 6	Bashkitë e qarkut Lezhë	143-149
Tabela 1 - 7	Bashkitë e qarkut Shkodër	151-159
Tabela 1 - 8	Bashkitë e qarkut Tiranë	160-167
Tabela 1 - 10	Bashkitë e qarkut Vlorë	169-179

Figura 1	Ofruesit e shërbimeve mbështetur nga fondi social kundrejt të gjithë ofruesve - 2025	29
Figura 2	Ndryshimi i shërbimeve për të moshuar: 2021-2025	32
Figura 3	Ndryshimi i shërbimeve për individë me aftësi të kufizuar:2021-2025	32
Figura 4	Ndryshimi i shërbimeve për fëmijë:2021-2025	33
Figura 5	Ndryshimi i shërbimeve për gra:2021-2025	33
Figura 6	Ndryshimi i shërbimeve multidisiplinare:2021-2025	34
Figura 7	Shërbimet e përkujdesit shoqëror sipas qarqeve dhe viteve, numër	38
Figura 8	Renditja e qarqeve sipas "Shërbimeve të përkujdesit shoqëror për 10 mijë banorë", numër	40
Figura 9	Shpërndarja në përqindje e shërbimeve sipas qarqeve	40
Figura 10	Shërbimet sipas tipologjisë në %, 2023 -2025	44
Figura 11	Shërbimet e kujdesit shoqëror sipas grupeve të përfituesve të shërbimeve	44
Figura 12	Grupet përfituese sipas tipologjive, përqindje	46
Figura 13	Përfituesit e shërbimeve sipas llojit të ofruesve që sigurojnë shërbimet e kujdesit shoqëror	47
Figura 14	Numri mesatar i përfituesve për shërbim dhe ofrues, sipas mënyrës së financimit të shërbimeve	48
Figura 15	Përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror sipas grup moshës	51
Figura 16	Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror sipas grupeve dhe gjinisë, përqindje	53
Figura 17	Grupet e përfituesve dhe shërbimet që përfitojnë në përqindje	54
Figura 18	Qarqet sipas numrit të përfituesve	56
Figura 19	Përfituesit për 10 mijë banorë sipas qarqeve	56
Figura 20	Burimet njerëzore të përgjithshme të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, sipas arsimit , përqindje	60
Figura 21	Treguesi Përfitues/Staf, Ofruesit e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, numër	61
Figura 22	Treguesi Përfitues/Staf, Bashkitë, numër	63
Figura 23	Individë në nevojë për shërbime ndaj popullsisë, sipas qarqeve, %	67
Figura 24	% e individëve që realizojnë nevojën e tyre për shërbime në çdo qark	68
Figurat 1 - 4	Bashkitë e qarkut Berat	72-74
Figurat 1 - 4	Bashkitë e qarkut Durrës	81-83
Figurat 1 - 4	Bashkitë e qarkut Dibër	88-90
Figurat 1 - 4	Bashkitë e qarkut Elbasan	96-98
Figurat 1 - 4	Bashkitë e qarkut Fier	106-108
Figurat 1 - 4	Bashkitë e qarkut Gjirokastrë	116-118
Figurat 1 - 4	Bashkitë e qarkut Korçë	126-128
Figurat 1 - 4	Bashkitë e qarkut Kukës	135-138
Figurat 1 - 4	Bashkitë e qarkut Lezhë	143-146
Figurat 1 - 4	Bashkitë e qarkut Shkodër	151-154
Figurat 1 - 4	Bashkitë e qarkut Tiranë	160-162
Figurat 1 - 4	Bashkitë e qarkut Vlorë	169-172





KONFERENCË
SHËRBIME SOCIALE TË
INTEGRUARA PËR FAMILJEN
Leave No One Behind
Tirane, 11 May 2024

Supporting municipalities
to reach out to
communities in need

LEAVE
NO ONE
BEHIND
ASKUSH
TË MOS
MBETET PAS



V. METODOLOGJIA

“Hartëzimi i Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror” sjell një pasqyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, nëpërmjet analizës së të dhënave dhe të informacionit, të mbledhur për qëllim të këtij studimi, në katër drejtime themelore, përkatësisht në përputhje të plotë me pyetjet themelore kërkimore që udhëhoqën këtë studim:

- Cila është situata e ofruesve dhe shërbimeve që ato sigurojnë në Shqipëri? Cilat janë karakteristikat më themelore të tyre dhe si kanë ndryshuar ato ndër vite?
- Cilët janë përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në Shqipëri? Cilat janë karakteristikat e tyre?
- Si është i ndërtuar dhe si funksionon sistemi që mundëson sigurimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në Shqipëri?
- A janë të mjaftueshme shërbimet ekzistuese të përkujdesit shoqëror për të plotësuar nevojën për shërbime?

Në përputhje me pyetjet kërkimore, metoda përshkruese dhe analitike janë harmonizuar për të prodhuar:

- Analizën shumëdimensionale të situatës së Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror dhe Ofruesve të tyre, përkatësisht sipas vendndodhjes, llojit, mënyrës së organizimit dhe financimit, tipologjisë, grupeve përfituese për çdo tipologji dhe ofrues.
- Analizën e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror sipas numrit, gjinisë, grup-moshës, problemit më kritik, tipologjisë së shërbimeve që përfitojnë si edhe sipas ofruesve përkatës.
- Analizën e burimeve njerëzore dhe institucionale në funksion të sigurimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror;
- Vlerësimin e nevojës për shërbime të kujdesit shoqëror dhe i nivelit të plotësimit të kësaj nevoje sipas rajoneve, grupeve më kritike dhe shërbimeve të kërkuara.

V.1 INSTRUMENTAT DHE METODA E KËRKIMIT

Hartëzimi i Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror” identifikon dhe klasifikon në mënyrë të detajuar shërbimet sociale të disponueshme në Shqipëri, të organizuara sipas vendndodhjes gjeografike, nivelit të qeverisjes, llojit të shërbimeve, strukturave ofruese, burimeve të tyre të financimit, statusin e licencimit dhe grupet përfituese. Përmes këtij informacioni, synohet të sigurohet një bazë të dhënash gjithëpërfshirëse që lehtëson planifikimin, monitorimin dhe përmirësimin e politikave dhe shërbimeve sociale, duke garantuar një mbulim më të gjerë dhe më efektiv për grupet në nevojë.

Në këtë studim është përdorur metoda përshkruese dhe analitike e studimit, e ndërtuar si një kombinim i (a) të dhënave sasiore nga burime parësore, nëpërmjet intervistave ballë për ballë, online me punonjësit e shërbimeve shoqërore në çdo bashki të vendit, dhe (b) të dhënave sasiore, nga burime dytësore, të prodhuara nga statistikat zyrtare në nivel bashkie.

Pyetësi (shtojcë 5) i strukturuar me pyetje të mbyllura është përdorur si instrument i mbledhjes të të dhënave.

Metoda përshkruese dhe analitike janë përdorur në të dyja nivelet e analizës, përkatësisht në:

- A. Analiza në nivel kombëtar;
- B. Analiza në nivel qarku/bashkie.

V.2 ANALIZA NË NIVEL KOMBËTAR

Analiza në nivel kombëtar konsiston në:

Përshkrimin e përgjithshëm i sistemit kombëtar të shërbimeve të përkujdesit shoqëror nëpërmjet mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave sipas treguesve që vijnë:

- Numri i institucioneve/ofruesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në nivel kombëtar, përshkrimi dhe grupimi sipas karakteristikave më themelore, numri, lloji dhe tipologjia e shërbimeve që ato sigurojnë, kategorizimi i shërbimeve sipas cilësive themelore të përbashkëta.
- Krahësimi i ecurisë së sistemit 2025/2023/2021.
- Përshkrimin dhe analizën e financuesve të sistemit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror sot dhe në krahasim me vitin 2023, ndryshimet më thelbësore dhe efektet e tyre, në mënyrë të veçantë identifikimi dhe analiza e rolit të Fondit Social, si një mekanizëm efektiv mbështetës për rritjen dhe zhvillimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në çdo bashki të vendit.
- Shpërndarja gjeografike e qendrave/ofruesve të përkujdesit shoqëror, mbulimi i territorit dhe statusi i licencimit, mbulimi me shërbime i qarqeve, qarqet me më shumë dhe më pak ofrues në raport me popullsinë e tyre, bashkitë në të cilat nuk ushtron veprimtarinë asnjë ofrues ose numri i tyre është shumë i kufizuar dhe si ka ndryshuar kjo pasqyrë në krahasim me vitin 2023 dhe 2021.
- Shërbimet që sigurojnë ofruesit sipas qarqeve, llojit të ofruesve, tipologjisë dhe grupeve të përfituesve. Ndryshimet më të qënësishme në krahasim me vitin 2023, shkaqet dhe ndikimi i tyre, shpërndarja e shërbimeve sipas grupeve në nevojë si edhe pesha specifike e secilës kategori ndaj totalit, shërbimet sipas popullsisë, renditja e qarqeve sipas numrit mesatar të shërbimeve për 10 mijë banorë.
- Përfituesit e shërbimeve sipas qarqeve, gjinisë, moshës, llojit të ofruesve të përkujdesit shoqëror dhe burimit të tyre të financimit, si edhe sipas kategorive të grupeve në nevojë. Shkalla e përputhjes të shpërndarjes së shërbimeve sipas grupeve në nevojë në krahasim me peshën e secilit grup ndaj totalit.

- Qarqet me më shumë dhe me më pak përfitues në raport me popullsinë e tyre.
- Analiza e ngarkesës të ofruesve dhe e kapaciteteve të lira për të ofruar shërbime në çdo qark të vendit.
- Analizën e kapaciteteve që mundësojnë funksionimin e sistemit të shërbimeve; Numrin e punonjësve që mundësojnë funksionimin e sistemit, në bashki dhe drejtëpërsëdrejti tek shërbimet. Cilat janë karakteristikat e përgjithshme: numri, gjinia, arsimi, pozicioni i punës? Cilët janë sektorët më të vlerësuar dhe më pak të vlerësuar në administratën e përgjithshme? Cila është ngarkesa e tyre e punës, cilat janë qarqet me më shumë dhe me më pak ngarkesë pune? Cila është pesha e punës së bashkive për të siguruar përfitime monetare në raport me sigurimin e shërbimeve? A janë të mjaftueshme kapacitetet njerëzore?
- Analizën e kapaciteteve administrative, burimet njerëzore që sigurojnë ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet përkatëse sipas gjinisë, arsimit, sektorëve, numrit mesatar të përfituesve etj.

V.3 ANALIZA NË NIVEL RAJONAL/BASHKI

Analiza në nivel rajonal/bashki konsiston në:

- Përshkrimin e përgjithshëm të sistemit në nivel bashkie sipas secilit qark
- Analizën e funksioneve që kryen ky sistem dhe çfarë siguron ai në çdo bashki të qarkut.
- Vlerësimin e nivelit të përgjigjshmërisë ndaj nevojës së qytetarëve në çdo bashki të qarkut.

Numër i konsiderueshëm tabelash dhe figurash janë ndërtuar për të ilustruar gjetjet e këtij studimi. Për shkak të volumit jashtëzakonisht të madh të të dhënave, shpesh herë disa tregues janë paraqitur nëpërmjet figurave komplekse dhe shumëdimensionale, të shpjeguara në legjendë, por edhe tek pjesa përshkruese e raportit.

Në nivel bashkie, vëmendje e veçantë në metodologji i është kushtuar ndërtimit të treguesve jo të drejtëpërdrejtë të cilët vlerësojnë shkallën e plotësisht të nevojave të qytetarëve. Këta tregues janë:

- Nevoja e paplotësuar në %,
- Koeficienti i aplikimeve të paplotësuar në %; dhe
- Koeficienti i Mjaftueshmërisë Akomoduese në %.

Këta tregues u ndërtuan duke përdorur të dhënat e drejtëpërdrejta mbi:

- Numri i njerëzve në nevojë në total dhe për çdo grup;
- Kapacitetet e shërbimeve ekzistuese në total dhe për çdo grup,
- Numri i aplikimeve të paplotësuar në bashki dhe tek ofruesit e shërbimeve, në total dhe për çdo grup.

V.4 TERMINOLOGJIA, PËRKUFIZIMET DHE BAZA LIGJORE

Në shtesë nga Hartëzimet e mëparshme, në vlerësimin e vitit 2025 janë përdorur disa përkufizime të reja:


Ofrues dhe shërbime: Meqenëse gjatë viteve të fundit shërbimet e përkujdesit shoqëror janë zhvilluar, nuk është më real koncepti se një ofrues siguron një shërbim. Përkundrazi, një ofrues siguron më shumë se sa një shërbim. Gjithashtu, edhe tipologjia e ofruesve të shërbimeve ka ndryshuar. Në të njëjtën strukturë shërbimesh mund të përfitojnë shërbime më shumë se sa një grup në nevojë. Për rrjedhojë:


- Ofrues quhen strukturat, publike ose jo publike që ofrojnë/sigurojnë shërbime të përkujdesit shoqëror.
- Shërbime quhen veprimet e mbrojtjes, zhvillimit, edukimit, rehabilitimit, kurimit, integritit, që ofruesit sigurojnë për individët dhe grupet në nevojë.

Tipologjia e Ofruesve: Nisur nga dallimi ndërmjet konceptit Ofrues dhe Shërbim, në këtë vlerësim, Ofruesit u klasifikuan sipas tipologjisë, sikundër edhe shërbimet. Por, ndërsa për Shërbimet, legjislacioni përcakton qartë tipologjitë e tyre, përkatësisht parashoqërore, rezidenciale, ditore, komunitare, qendër zhvillimi, strehëza, në familje, të specializuara, këshilluese, emergjencë dhe kujdes alternativ, për Ofruesit nuk ekziston një klasifikim i tillë, sepse legjislacioni kurdoherë ka konsideruar faktin që Shërbim dhe Ofrues janë i njëjti koncept. Në këtë vlerësim, u përdor edhe një kategorizim i ofruesve, diktuar nga nevoja, por edhe i bazuar në tiparet më themelore të ofruesve të shërbimeve. Kështu, në këtë vlerësim u kategorizuan Ofruesit, në bazë të cilësisë më themelore të shërbimeve të ofruara, përkatësisht në: Rezidencialë, Ditorë, Komunitare, Qendër zhvillimi, Shumë disiplinorë, Strehëz, Banesë/lëvizës/territor dhe Fondacion/shoqatë.


Nisur nga mënyra e financimit dhe administrimit, ofruesit janë kategorizuar në publikë dhe jo publikë. Ofrues publikë quhen të gjithë ata që financohen dhe administrohen nga burime publike (qeveria qendrore, rajonale, lokale, ndihma e huaj, burime publike të përziera, etj). Ofrues jo publikë quhen të gjithë ata që mbështeten nga burime jo publike (fondacione, shoqata, donatorë privatë, ofj, organizata ndërkombëtare që veprojnë jashtë kontekstit të ndihmës së huaj zhvilluese, burime jo publike të përziera, etj). Në vlerësime të mëparshme është kategorizuar edhe një lloj ofruesi: ofrues i tipit të përzierë, si bashkëpunim i burimeve publike dhe jo publike. Meqenëse në këtë vlerësim, një lloj i tillë nuk u identifikua, lloji i përzierë u hoq nga klasifikimi.

Përcaktimet e tipologjisë së shërbimeve si edhe të grupeve në nevojë i referohen ligjit për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror.





1.1. OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR/SHËRBIMET E SIGURUARA PËR QYTETARËT NË NEVOJË



Sot në Shqipëri ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror 439 ofrues ose 13 % më shumë se sa në vitin 2023. Këto ofrues sigurojnë funksionimin e 1.669 shërbimeve të përkujdesit shoqëror ose 56% më shumë se sa në vitin 2023 për 39.091përfitues, individë në nevojë (11% më shumë se sa në vitin 2023)(Tabela 1).

Tabela 1: Ofruesit e përkujdesit shoqëror, shërbimet dhe përfituesit sipas qarqeve, mënyrës së administrimit dhe financimit, numër

Qarqet	Ofrues të shërbimeve			Shërbime sipas ofruesve			Përfitues sipas ofruesve		
	Publike	Jo Publike	Gjithsej	Publike	Jo Publike	Gjithsej	Publike	Jo Publike	Gjithsej
Berat	16	1	17	82	0	82	621	473	1.094
Durrës	13	19	32	48	84	132	1.426	1.495	2.921
Dibër	10	5	15	37	18	55	415	129	544
Elbasan	14	22	36	73	106	179	1.194	1.000	2.194
Fier	18	11	29	79	25	104	1.386	1.114	2.500
Gjirokastrë	18	3	21	86	19	105	797	109	906
Korçë	26	18	44	130	84	214	905	1.983	2.888
Kukës	5	2	7	24	5	29	256	34	290
Lezhë	5	13	18	38	44	82	534	1.000	1.534
Shkodër	31	21	52	128	77	205	2.375	5.136	7.511
Tiranë	90	57	147	138	237	375	6.181	8.765	14.946
Vlorë	13	8	21	68	36	104	921	842	1.763
Gjithsej	259	180	439	931	738	1.669	17.011	22.080	39.091
Në %	59	41	100	56	44	100	44	56	100

Burimi: Studimi, Janar 2025

Siç tregon tabela 1, Ofruesit publikë të shërbimeve përbëjnë 59% të numrit të përgjithshëm dhe sigurojnë 56% të shërbimeve për 44% të përfituesve. Në krahasim me dy vite më parë, ndërsa pesha specifike e ofruesve publikë ndaj atyre jo publikë nuk ka ndryshuar, pesha e përfituesve të ofruesve publikë është rritur me 6 pikë përqindje kundrejt atyre jo publikë(Tabela 2).

Tabela 2: Ofruesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe përfituesit, 2023-2025


Qarqet	Ofrues të shërbimeve			Përfitues			Fondi Social			
	2023	2025	%	2023	2025	%	Ofrues	%	Përfitues	%
Berat	13	17	21	1.011	1.094	8	5	29	128	13
Durrës	29	32	10	2.487	2.921	17	4	24	492	49
Dibër	14	15	7	473	544	15	4	27	132	28
Elbasan	29	36	24	1.856	2.194	18	12	33	1.176	63
Fier	25	29	16	1.791	2.500	40	9	31	892	50
Gjirokastrë	11	21	91	483	906	88	8	38	478	99
Korçë	44	44	0	3.008	2.888	-4	10	23	513	17
Kukës	5	7	40	264	290	10	2	29	170	64
Lezhë	13	18	38	825	1.534	86	3	17	474	57
Shkodër	49	52	6	6.355	7.511	18	6	12	464	7
Tiranë	140	147	5	14.984	14.946	0	7	5	0	0
Vlorë	18	21	17	1.694	1.763	4	8	38	538	32
Gjithsej	390	439	13	35.231	39.091	11	78	18	5.457	15

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 2 sjell edhe një informacion tjetër tejet thelbësor: Numrin e ofruesve të shërbimeve të mbështetur nga fondi social si edhe përfituesit përkatës. Siç mund të vërehet lehtësisht nga të dhënat e tabelës 2, roli i fondit social ka qenë tejet domethënës gjatë dy viteve. Në rang vendi, 18% e ofruesve dhe 15% e përfituesve i dedikohen fondit social. Në disa qarqe të vendit si Gjirokastrë, Vlorë, Elbasan, Fier, Kukës, Berat, Dibër, kjo mbështetje është edhe më e konsiderueshme. Ajo varion nga 27% deri 38%, duke ndikuar në rritjen e numrit të përfituesve nga 20% deri në dyfishimin e tyre.

Figura 1 e ilustron më tej këtë gjetje duke paraqitur qartazi peshën e ofruesve të mbështetur nga fondi social kundrejt atyre publikë dhe jo publikë në çdo qark të vendit.

Figura 1: Ofruesit e shërbimeve mbështetur nga fondi social kundrejt të gjithë ofruesve - 2025



Burimi: Studimi, Janar 2025

Analiza e krahasuar 2025-2021 e ofruesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në rang vendi (e paraqitur nëpërmjet tabelës 3 dhe figurave komplekse shumëdimensionale 2 deri 6), të kategorizuar sipas llojit dhe tipologjisë, tregon se:

- Numri i ofruesve të shërbimeve gjatë periudhës 2021-2025 është rritur me 29%, rritje e cila i dedikohet kryesisht ofruesve publikë. (Tabela 3).
- Me përjashtim të qarkut Vlorë, në të cilin numri i ofruesve publikë është zvogëluar, si edhe qarqeve Kukës e Durrës në të cilat numri i ofruesve publikë nuk ka ndryshuar, në të gjitha qarqet e tjera ky numër është rritur ndjeshëm (Tabela 3).
- Analiza sipas tipologjisë së ofruesve dëshmon se ofruesit e shërbimeve për të moshuar janë rritur në thuajse të gjitha qarqet e vendit, me përjashtim të qarqeve Berat dhe Lezhë (Figura 2).
- Ofruesit e shërbimeve për individë me AK janë rritur gjithashtu në çdo qark të vendit, me përjashtim të qarkut Vlorë. (Figura 3).
- Ofruesit e shërbimeve për fëmijë me përjashtim të qarqeve Shkodër, Durrës, Tiranë, Fier e Korçë, në qarqet e tjera janë zvogëluar (Figura 4), megjithatë në nivel kombëtar, numri i përgjithshëm i ofruesve të shërbimeve për fëmijë është më i madh se sa në vitin 2021.
- Ofruesit e shërbimeve për gra janë zvogëluar në thuajse të gjitha qarqet e vendit, me përjashtim të Dibrës, Korçës, Tiranës, Fierit e Gjirokastrës (Figura 5).
- Ofruesit e shërbimeve shumëdisiplinare janë rritur në 6 qarqe, nuk kanë ndryshuar në dy të tjera dhe janë zvogëluar në 4 qarqe të vendit, përkatësisht në qarkun e Kukësit, Dibrës, Elbasanit dhe Beratit. (Figura 6)

Tabela 3: Ofruesit e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, 2021-2025

Qarqet	Ofruesit publikë			Ofruesit jo publikë			Ofrues Gjithsej		
	2021	2025	Ndryshimi	2021	2025	Ndryshimi	2021	2025	Ndryshimi
Berat	14	16	14%	3	1	-67%	17	17	0%
Durrës	13	13	0%	12	19	58%	25	32	28%
Dibër	5	10	100%	9	5	-44%	14	15	7%
Elbasan	12	14	17%	41	22	-46%	53	36	-32%
Fier	10	18	80%	7	11	57%	17	29	71%
Gjirokastrë	7	18	157%	7	3	-57%	14	21	50%
Korçë	8	26	225%	16	18	13%	24	44	83%
Kukës	5	5	0%	6	2	-67%	11	7	-36%
Lezhë	2	5	150%	11	13	18%	13	18	38%
Shkodër	9	31	244%	26	21	-19%	35	52	49%
Tiranë	17	90	429%	67	57	-15%	84	147	75%
Vlorë	18	13	-28%	14	8	-43%	32	21	-34%
Gjithsej	120	259	116%	219	180	-18%	339	439	29%

Burimi: Studimi, Janar 2025




Figura 2: Ndryshimi i shërbimeve për të moshuar: 2021-2025




Figura 4: Ndryshimi i shërbimeve për fëmijë:2021-2025




Figura 3: Ndryshimi i shërbimeve për individë me aftësi të kufizuar:2021-2025



Figura 5: Ndryshimi i shërbimeve për gra:2021-2025





Figura 6: Ndryshimi i shërbimeve multidisiplinare:2021-2025



Burimi: Studimi, Janar 2025

Ofruesit e kujdesit shoqëror mbulojnë me shërbime të gjithë territorin e vendit. Pavarësisht vend-ndodhjes së tyre gjeografike, ofruesit sigurojnë shërbime për individë në nevojë nga e gjithë Shqipëria (ofrues kombëtarë), nga qarqet (rajonalë) ose vetëm nga bashkitë (lokalë). Ofruesit kombëtarë janë kryesisht publikë dhe të financuara nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror. Institucionet rajonale janë kryesisht Jo-Publike dhe të financuara nga burime private, ndërsa institucionet lokale janë ose Publike dhe të financuara nga bashkitë dhe/ose burime të përziera, ose Jo-Publike dhe të financuara nga OJF lokale, donatorë ose burime të përziera.

Tabela 4 sjell informacion të detajuar mbi shpërndarjen gjeografike të institucioneve dhe mbulimin e territorit, duke sqaruar edhe statusin e liçensimit të ofruesve. Të dhënat dëshmojnë se 23% e ofruesve ose 101 ofrues janë të pa-liçensuar ende. Këto janë kryesisht ofrues lokalë.

Tabela 4: Shpërndarja gjeografike e ofruesve të përkujdesit shoqëror, mbulimi i territorit dhe statusi i liçensimit

Qarqet	Mbulimi me shërbime			Statusi Liçensimit		
	Kombëtar	Rajonal	Bashki	Po	Jo	Gjithsej
Berat	3	3	11	8	9	17
Durrës	8	8	16	29	3	32
Dibër	0	1	14	7	1	15
Elbasan	8	6	22	22	13	36
Fier	2	5	22	15	14	29
Gjirokastrë	0	2	19	9	12	21
Korçë	4	3	37	33	11	44
Kukës	0	0	7	4	3	7
Lezhë	2	0	16	12	6	18
Shkodër	13	4	35	33	18	52
Tiranë	15	8	124	143	4	147
Vlorë	4	2	15	14	7	21
Gjithsej	59	42	338	329	101	439

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 4 gjithashtu tregon se 13% e ofruesve janë kombëtarë, 10% janë rajonalë, ndërsa pjesa tjetër, 77% janë ofrues lokalë.

Tabela 5 pasqyron përbërjen e ofruesve të shërbimeve, të shërbimeve që ato sigurojnë dhe të përfituesve të tyre sipas tipologjisë së ofruesve, përkatësisht: Rezidenciale, Ditore, Komunitare, Qendra Zhvillimi, Shumë disiplinore, Strehëz emergjence, Shërbim lëvizës dhe Shoqata-fondacione.

Tabela 5: Ofruesit e shërbimeve, shërbimet dhe përfituesit e tyre, sipas tipologjisë së ofruesve, numër dhe përqindje(Informacioni i detajuar sipas bashkive, 2021-2025, paraqitet tek Shtojca 4)

Tipologjia e Ofruesve	Vlerë absolute			Përqindje		
	Ofrues	Shërbime	Përfitues	Ofrues	Shërbime	Përfitues
Rezidenciale	63	187	4.370	14	11	11
Ditore	49	218	4.089	11	13	10
Komunitare	95	346	10.998	22	21	28
Qendra zhvillimi	23	101	1.899	5	6	5
Shumë disiplinore	37	232	3.831	8	14	10
Strehëz emergjence	29	129	2.130	7	8	5
Shërbim lëvizës	37	151	2.851	8	9	7
Fondacione/shoqata	106	305	8.923	24	18	23
Gjithsej	439	1.669	39.091	100	100	100

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 5 evidenton se:

Nëse lëmë mënjanë “Ofruesit-Fondacione/Shoqata” të cilët janë kryesisht të mbështetur nga burime private ose projekte dhe sigurojnë tipologji të kufizuar të shërbimeve (këshillim kryesisht), ofruesit “Qendra Komunitare” përbëjnë pjesën më të konsiderueshme, 22% duke iu shërbyer 28% të përfituesve me 21% të shërbimeve. Fakti që qendrat komunitare zënë një vend të tillë është plotësisht në përputhje me parimin e de-institucionalizimit dhe të decentralizimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, si edhe në përputhje të plotë me Strategjinë e Mbrojtjes Sociale, 2025-2030.

Ndërmjet ofruesve rezidencialë, ditorë, komunitarë dhe qendrave të zhvillimit ekziston një ndarje përpjestimore e peshës të secilës tipologji, peshës së shërbimeve që sigurojnë si edhe peshës të përfituesve që ndihmojnë.

Shërbimet e lëvizshme gjithashtu kanë fituar hapësirën e tyre, 8%, duke iu shërbyer 7% të përfituesve me 9% të shërbimeve, kryesisht në sajë të financimit nëpërmjet fondit social.

Kategorizimi i ofruesve edhe sipas burimit të financimit ri-konfirmon rritjen e përgjegjshmërisë të bashkive, të cilat financojnë të vetme 32 % të shërbimeve publike ose 19% të të gjitha shërbimeve. Nëse konsiderojmë edhe faktin se bashkitë janë partnerë në shumë raste tek “financimet e përziera” atëherë roli i bashkive është dukshëm i rritur në organizimin dhe financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Roli i rritur i bashkive duket gjithashtu edhe në marrjen e përgjegjësisë nëpërmjet projekteve të paraqitura dhe të mbështetura nga Fondi Social, të cilat gjithashtu të vetme mbështesin 8% të ofruesve (Tabela 6).




Tabela 6: Kategorizimi i ofruesve sipas burimeve të financimit, numër dhe përqindje

Qarqet	Ofrues Publikë						Ofrues Jo Publikë					Gjithsej
	Qeveria	Qarku	Bashkia	Fondi social	Përzier	Gjithsej	OJF	Org.Nd	Fondacion/privat	Përzier	Gjithsej	
Berat	1		7	3	5	16			1		1	17
Durrës	2		7	3	1	13	12	2	3	2	19	32
Dibër	2		2	3	3	10			1	4	5	15
Elbasan	0	1	3	3	7	14	1	2	2	17	22	36
Fier	1		6	4	7	18	4	2	5		11	29
Gjirokastrë		1	8	7	2	18			3		3	21
Korçë	2	1	8	5	10	26	2	1	11	4	18	44
Kukës	1		2	0	2	5			2		2	7
Lezhë					5	5	6		2	5	13	18
Shkodër	5		17	3	6	31	6	7	8		21	52
Tiranë	10		19	2	59	90	36	2	18	1	57	147
Vlorë	1		3	1	8	13	1	1	3	3	8	21
Gjithsej	25	3	82	34	115	259	68	17	59	36	180	439
Në %	6	1	19	8	26	59	15	4	13	8	41	100

Burimi: Studimi, Janar 2025

Figura 7 paraqit shpërndarjen e shërbimeve sipas qarqeve, të krahasuar edhe me dy periudhat para-ardhëse, përkatësisht 2023 dhe 2021.

Figura 7: Shërbimet e përkujdesit shoqëror sipas qarqeve dhe viteve, numër




Burimi: Studimi, Janar 2025

Figura 7 dëshmon se qarku i Kukësit vijon të jetë qarku me numrin më të vogël të shërbimeve, ndërsa ka pësuar rritje numri i shërbimeve në qarkun e Lezhës, të Fierit dhe veçanërisht, në qarkun e Gjirokastrës. Numri i shërbimeve në qarkun e Elbasanit në krahasim me qarqet e Korçës dhe Durrësit ka pësuar ulje, ndërsa qarku i Tiranës vijon të jetë qarku me numrin më të madh të shërbimeve.

Megjithatë vetëm treguesi i numrit absolut të shërbimeve nuk është i mjaftueshëm për të dëshmuar nivelin e aksesit të popullsisë tek shërbimet, sepse nuk është konsideruar popullsia për të cilën këto shërbime ofrohen. Figura 8 paraqit numrin e shërbimeve për 10 mijë banorë. Renditja e qarqeve sipas numrit të përgjithshëm të shërbimeve tregon se Qarku i Dibrës siguron numrin më të vogël të shërbimeve, ndërsa Qarku i Shkodrës është qarku me numrin më të lartë të shërbimeve mesatarisht për 10 mijë banorë (Figura 8). Qarku i Tiranës, pavarësisht numrit të lartë të shërbimeve, përballë popullsisë të këtij qarku, ky numër rezulton shumë pak më i lartë se sa mesatarja në rang kombëtar. Treguesi i “Popullsisë” është marrë nga Censusi 2023.


Figura 8: Renditja e qarqeve sipas “Shërbimeve të përkujdesit shoqëror për 10 mijë banorë”, numër



Burimi: Studimi, Janar 2025

Figura 9 paraqit shpërndarjen e shërbimeve sipas qarqeve në përqindje. Dukshëm konstatohet se Tirana siguron më shumë se 1/5 e shërbimeve (23%), e ndjekur nga Korça, 19% dhe Shkodra, (12%) e Elbasani, 11%, për të vijuar me qarqet e tjera, të cilat së bashku sigurojnë rreth 35% të shërbimeve.

Figura 9: Shpërndarja në përqindje e shërbimeve sipas qarqeve



Burimi: Studimi, Janar 2025

Shërbimet e përkujdesit shoqëror sipas tipologjisë dhe qarqeve paraqiten tek tabela 7. Informacioni i detajuar mbi shërbimet sipas tipologjisë, llojit të ofruesve dhe bashkive, paraqitet tek Shtojca 3.



Tabela 7: Shërbimet e përkujdesit shoqëror sipas tipologjisë dhe qarqeve, numër

Qarqet	Shërbimet sipas tipologjisë											
	Parashoqërore	Rezidenciale	Strehëza	Komunitare	Qendër zhvillimi	Qendër ditore	Familje	Të specializuara	Këshillim	Situatë emergjence	Kujdes alternativ	Gjithsej
Berat	21	2	1	11	2	7	3	13	11	11	3	85
Durrës	30	5	6	14	4	13	13	22	11	10	4	132
Dibër	14	0	1	7	4	7	4	9	6	3	0	55
Elbasan	40	10	2	18	7	30	18	17	16	17	4	179
Fier	28	1	3	21	5	2	4	10	13	16	2	105
Gjirokastrë	26	3	3	12	5	3	10	17	9	16	1	105
Korçë	43	9	6	35	13	20	9	29	13	28	9	214
Kukës	6	0	1	1	3	5	0	7	1	5	0	29
Lezhë	17	3	0	16	4	11	3	10	10	5	3	82
Shkodër	47	17	4	31	7	10	11	27	13	26	12	205
Tiranë	69	34	13	34	20	41	14	39	69	36	6	375
Vlorë	26	1	1	16	5	4	9	14	14	12	2	104
Gjithsej	367	85	41	216	79	153	98	214	186	185	46	1.670
Në %	22%	5%	2%	13%	5%	9%	6%	13%	11%	11%	3%	100%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Nga kjo tabelë mësojmë se:

- Shërbimet “Parashoqërore” përbëjnë 22% të të gjitha shërbimeve, të pasuara nga ato “Komunitare” dhe “Të specializuara”, 13%.
- Shërbimet në kushte emergjence si edhe këshilluese zënë gjithashtu një vend të konsiderueshëm, nga 11%.
- Shërbimet më pak të përhapura janë “Strehëzat” dhe “Kujdesi alternativ”, përkatësisht me 3%.
- Ndërsa “Shërbimet Parashoqërore, Familje, Specializuara dhe Emergjente” ofrohen kryesisht nga ofruesit publikë, shërbimet “Rezidenciale” dhe “Këshilluese” ofrohen kryesisht nga ofrues jo publikë.
- Shërbimet e tjera, Strehëza, Qendra zhvillimi, Qendër ditore dhe komunitare, ofrohen në të njëjtën përmasë si nga ofrues publikë, ashtu edhe jo publikë.
- Në përgjithësi shkalla e shpërndarjes së shërbimeve sipas tipologjisë është deri diku e njëtrajtshme. Vetëm në Qarkun e Kukësit, Dibrës dhe Lezhës mungojnë përkatësisht 3 tipologji (Rezidenciale, Familje, Kujdes Alternativ); 2 tipologji (Rezidenciale dhe Kujdes Alternativ) dhe një tipologji (Strehëza).


Analiza sipas numrit të tipologjive nëpër qarqe tregon se në krahasim me dy vite më parë, konstatohen ndryshime pozitive. Përkatësisht:

- Numri i qarqeve në të cilat nuk ofrohen të gjitha tipologjitë është zvogëluar nga 5 në 3 qarqe.
- Në qarqet e Fierit dhe të Gjirokastrës në të cilat dy vite më parë mungonin 1 deri 2 tipologji, tani ofrohen shërbime me të gjitha tipologjitë.
- Gjithashtu numri i tipologjive të munguara është zvogëluar në qarkun e Lezhës, nga 2 në 1, i kufizuar vetëm me mungesën e “Strehëzave”.

Kjo analizë plotësohet me elementët e nevojshëm në Kapitullin e Analizës sipas qarqeve dhe bashkive.

Krahasimi i profilit të shërbimeve sipas tipologjisë, 2025 dhe 2023 (Figura 10) nxjerr në pah disa ndryshime, të cilat justifikohen plotësisht, nëse konsiderojmë faktin se rritja e numrit të ofruesve në vitin 2025 në krahasim me vitin 2023 i dedikohet kryesisht mbështetjes të tipologjisë “Shërbime lëvizëse” (gjithsej 37) nëpërmjet fondit social. “Shërbimet lëvizëse” ofrojnë kryesisht shërbime të specializuara për individë me AK si edhe Shërbime Këshillimi dhe Emergjence për individë të moshuar.


Figura 10: Shërbimet sipas tipologjisë në %, 2023 -2025



Burimi: Studimi, Janar 2025

Figura 11 paraqit përbërjen e shërbimeve të kujdesit shoqëror sipas grupeve përfituese. Siç konstatohet, Shërbimet për “Fëmijë me AK” (21%) përbëjnë grupin me peshën më të madhe, të pasuar nga “Shërbime për të moshuarit, 18%. Shërbimet për “Individë të familjeve në nevojë”, të cilat dy vite më parë përbënin grupin me peshën më të konsiderueshme, 29%, në këtë vlerësim përbëjnë vetëm 16%. Rritje të ndjeshme kanë pësuar gjithashtu “Shërbimet për të rritur AK”, të cilat nga 6%, në këtë vlerësim rezultojnë 11%. Rritje të lehtë kanë pësuar “Shërbimet për të rinjtë në nevojë” (8%) si edhe për “Romë & Egjiptianë” (7%), ndërsa pesha e shërbimeve për fëmijë jashtë kujdesit prindëror si edhe gra në nevojë, nuk ka ndryshuar.

Figura 11: Shërbimet e kujdesit shoqëror sipas grupeve të përfituesve të shërbimeve



Burimi: Studimi, Janar 2025

Rritja e numrit të ofruesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror ka ndikuar në uljen ndjeshëm të numrit të bashkive të cilat nuk ofrojnë asnjë shërbim. Tabela 8 paraqit të përmbledhura bashkitë sipas tipologjive të shërbimeve që ato ofrojnë, duke i krahasuar edhe me vitin 2023.

Për të kuptuar më qartë se çfarë ka ndodhur me shërbimet e përkujdesit shoqëror në secilën bashki (nga pikëpamja sasiore) përdorim përshkrim me ngjyra, përkatësisht me ngjyrë të kuqe janë bashkitë për të cilat tipologjitë janë shtuar; me blu bashkitë për të cilat nuk ka ndryshuar asgjë, ndërsa me të gjelbër bashkitë tek të cilat tipologjitë janë tkurrur.

Tabela 8: Përmbledhje e numrit të ofruesve sipas tipologjive në bashkitë e vendit dhe kategorimi i tyre sipas tipologjive të ofruesve

Tipologjitë e shërbimeve të ofruara	Numri i bashkive		Viti 2023	Viti 2025
	2023	2025		
Asnjë tipologji	8	2	Libohovë, Këlcyrë, Dropull, Memaliaj, Mirditë, Fushë-Arrëz, Himarë, Konsipol	Himarë, Konispol
Vetëm një tipologji	20	17	Kuçovë, Shijak, Skrapar, Bulqizë, Klos, Belsh, Peqin, Gramsh, Patos, Mallakastër, Divjakë, Përmet, Tepelenë, Devoll, Has, Tropojë, Vorë, Rrogozhinë, Delvinë	Kuçovë, Skrapar, Bulqizë, Klos, Belsh, Mallakastër, Divjakë, Libohovë, Këlcyrë, Dropull, Memaliaj, Pustec, Fushë Arrëz, Rrogozhinë, Delvinë, Finiq, Selenicë
Dy tipologji	14	11	Poliçan, Dimal, Cërrik, Librazhd, Prrrenjas, Roskovec, Kolonjë, Kurbin, Malësi e Madhe, Pukë, Vau Dejës, Kavajë, Finiq, Selenicë	Dimal, Shijak, Peqin, Prrrenjas, Patos, Devoll, Has, Tropojë, Mirditë, Malësi e Madhe, Pukë
Tre tipologji	2	6	Mat, Pustec	Poliçan, Cërrik, Librazhd, Tepelenë, Kukës, Vau Dejës
Katër tipologji	2	5	Kukës, Kamëz	Gramsh, Roskovec, Kolonjë, Kamëz, Vorë
Pesë tipologji	4	3	Sarandë, Maliq, Fier, Dibër	Mat, Përmet, Kavajë
Gjashtë tipologji	6	1	Berat, Krujë, Lushnje, Gjirokastrë, Pogradec, Lezhë	Maliq
Shtatë tipologji	2	2	Vlorë, Durrës	Kurbin, Sarandë
Tetë tipologji		2		Dibër, Fier
Nëntë tipologji		4	Elbasan, Korçë	Krujë, Gjirokastrë, Pogradec, Lezhë
Dhjetë tipologji		1	Shkodër	Berat
Të gjitha tipologjitë		7	Tiranë	Durrës, Lushnje, Elbasan, Korçë, Shkodër, Vlorë, Tiranë

Nga kjo tabelë qartësisht konkludohet se në 40 bashki nga 61, nuk është rritur vetëm numri i ofruesve të shërbimeve, por edhe larmishmëria e tipologjive të tyre. Në 19 bashki tipologjitë e ofruesve nuk kanë ndryshuar.

Vetëm në dy bashki, përkatësisht Kamëz e Pustec, është zvogëluar numri i tipologjive, nga dy në një.

Për të përmbyllur analizën mbi ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe shërbimet që ato ofrojnë, studjojmë figurën 12, “Grupet përfituese sipas tipologjive, përqindje”.


Këto të dhëna dëshmojnë qartë se:

- Në krahasim me dy vite më parë, edhe pse jo të gjithë grupet në nevojë kanë të njëjtin akses tek shërbimet, në përgjithësi, mundësia për të përdorur shërbime është rritur, sepse ofruesit dhe shërbimet që ato sigurojnë, janë rritur ndjeshëm.
- Të rinjtë në nevojë, minoriteti Rom dhe Egjyptian, kanë më pak mundësi të përdorin shërbime të kujdesit shoqëror sepse shërbimet që adresojnë nevojat e tyre janë tepër të kufizuara.

Konkretisht:

- Të rinjtë mund të përfitojnë 22% të shërbimeve të këshillimit, ndërsa tek shërbimet e tjera, aksesit i tyre është tepër i kufizuar, rreth 4 deri 5%.
- Minoriteti Rom dhe Egjyptian mund të përdorë shërbime këshillimi, qendra ditore dhe komunitare në masën 11 deri 12%, ndërsa tek shërbimet e tjera aksesit është shumë më i kufizuar.
- Po kështu, edhe gratë, viktimat të dhunës, mund të përdorin shërbimet e strehëzave (51%), shërbime në situatë emergjence (20%), Këshillim (19%), ndërsa kanë akses të kufizuar tek qendrat ditore, komunitare ose shërbimet në familje.
- Vlen për t’u nënvizuar si arritje positive fakti se Shërbimet parashoqërore, komunitare, në familje, të specializuara dhe emergjente aksesohen kryesisht nga individët me AK, fëmijë ose të rritur, të moshuarit si dhe individët në kushte kritike ekonomike dhe shoqërore.
- Fëmijët jashtë kujdesit prindëror aksesojnë thuajse tërësisht shërbimet e kujdesit alternativ, si edhe “kryesisht” shërbimet rezidenciale.
- Shërbimet e qendrave të zhvillimit përdoren thuajse tërësisht nga individët me AK, fëmijë dhe të rritur, ndonëse të rriturit me mundësi më të kufizuara (të rriturit AK 33% kundrejt 63% që aksesojnë fëmijët AK).

Figura 12: Grupet përfituese sipas tipologjive, përqindje




Burimi: Studimi, Janar 2025

1.2. PËRFITUESIT E SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR NË NIVEL QARKU

Analiza e të dhënave sipas “Përfituesve” synon jo vetëm të informojë në lidhje me përfituesit në numër, sipas gjinisë, grup moshës, qarqeve e bashkive, llojeve të shërbimeve dhe tipologjisë, por edhe të hulumtojë më thellë në cilësitë e grupit përfitues, nevojës së tij për mbështetje monetare apo në shërbime, për të arritur deri tek vlerësimi i nevojës në raport me popullsinë.

Figura 13 paraqit grupimin e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në përputhje me llojet e institucioneve që sigurojnë shërbimet. Siç tregon figura 13, 44% e përfituesve përfitojnë shërbime nga institucione publike, ndërsa pjesa e mbetur, nga institucionet jo publike.

Figura 13: Përfituesit e shërbimeve sipas llojit të ofruesve që sigurojnë shërbimet e kujdesit shoqëror




Burimi: Studimi, Janar 2025

Nëse sjellim në vëmendje peshën e institucioneve dhe të shërbimeve ndaj numrit të përgjithshëm (Tabela 1), konstatojmë se ndërsa ndërmjet grupimit të institucioneve dhe shërbimeve sipas financuesit dhe mënyrës së administrimit ekziston një ndarje thuajse e përpjesshme, grupimi i përfituesve sipas financuesit të institucioneve dhe shërbimeve, dukshëm konfirmon numrin tejte të lartë të përfituesve të shërbimeve Jo-Publike në raport me ato Publike. Kjo gjetje, nxit hulumtimin në drejtim të numrit mesatar të përfituesve në secilin tip institucioni dhe shërbimi.

Treguesit e llogaritur të numrit mesatar përkatësisht të institucioneve dhe shërbimeve sipas financuesit paraqiten në figurën 14.

Figura 14: Numri mesatar i përfituesve për shërbim dhe ofrues, sipas mënyrës së financimit të shërbimeve



Të dhënat e figurës 14 qartësisht konfirmojnë se numri mesatar i përfituesve për çdo institucion dhe shërbim Jo-Publik është 2 herë më i lartë sesa ai i institucioneve dhe shërbimeve publike. Fakti që numri mesatar i përfituesve është 2 herë më i lartë në insitucionet Jo-Publike në krahasim me Publiket mund të tregojë për kërkesën e lartë për shërbime, për kapacitetet e kufizuara të sektorit publik, për ngurtësinë e procedurave të pranimit apo shpërndarjen e ofruesve në territor.

Pavarësisht arsyeve, kjo gjetje mund dhe duhet të shërbejë për nxitjen e një diskutimi të thelluar mbi “Raportin Numër/Cilësi e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, së pari, në raport me përcaktimin në ligj të standartit të numrit mesatar të përfituesve për shërbim, dhe së dyti, në lidhje me vëzhgimin e kujdesshëm dhe të pandërprerë të mënyrës se si ofrohen shërbimet dhe si analizohet ndikimi i tyre tek qytetarët në nevojë.

Tabela 9 sjell informacion të detajuar mbi grupimin e përfituesve sipas qarqeve dhe llojit e mënyrës së administrimit e financimit të ofruesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 9: Përfituesit e shërbimeve sipas qarqeve, llojit të qendrave të përkujdesit shoqëror si edhe mënyrës së administrimit e financimit të shërbimeve, numër dhe përqindje

Qarqet	Ofrues Publikë						Ofrues Jo Publikë					Gjithsej
	Qeveria	Qarku	Bashkia	Fondi social	Përzier	Gjithsej	OJF	Org.Nd	Fondacion/privat	Përzier	Gjithsej	
Berat	78	0	251	67	225	621	473	0	0	0	473	1.094
Durrës	77	0	761	392	196	1.426	863	25	131	476	1.495	2.921
Dibër	9	0	40	132	234	415	0	0	0	129	129	544
Elbasan	0	18	93	598	485	1.194	80	70	41	809	1.000	2.194
Fier	55	0	224	842	265	1.386	135	177	777	25	1.114	2.500
Gjirokastrë	60	78	144	478	37	797	0	0	109	0	109	906
Korçë	51	200	240	278	136	905	0	126	1.138	719	1.983	2.888
Kukës	128	0	122	0	6	256	0	0	34	0	34	290
Lezhë	0	0	0	208	326	534	300	0	585	115	1.000	1.534
Shkodër	129	0	1.753	414	79	2.375	294	1.023	226	3.593	5.136	7.511
Tiranë	535	0	1.872	562	3.212	6,181	3.682	223	1.605	3.255	8.765	14.946
Vlorë	0	0	325	97	499	921	306	60	476	0	842	1.763
Gjithsej	1.122	296	5.825	4,068	5.700	17.011	6.133	1.704	5.122	9.121	22.080	39.091
Në %	3	1	15	10	15	44	16	4	13	23	56	100
Në %	7	2	34	24	34	100	28	8	23	41	100	100

Burimi: Studimi, Janar 2025

Sipas Tabelës 9, 34% e përfituesve të shërbimeve publike, i përkasin Institucioneve që financohen nga bashkitë, 24% e përfituesve të shërbimeve publike i përkasin projekteve të financuara vetëm nga fondi social, ndërsa 28% e përfituesve të shërbimeve Jo-Publike i takojnë institucioneve që financohen nga OJF lokale.

Numri i përgjithshëm i përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror që i dedikohet mbështetjes së fondit social është shumë më i lartë, sepse fondi social aplikohet kryesisht nëpërmjet projekteve me bashkëfinancim, dy ose më shumë partnerë. Mbështetur në të dhënat e mbledhura për qëllim të këtij studimi rezulton se (Tabela 10).


Tabela 10: Ofruesit dhe përfituesit e mbështetur drejtpërsëdrejti ose në partneritet, nga fondi social, numër dhe përqindje

Qarqet	Fondi Social			
	Ofrues	%	Përfitues	%
Berat	5	29	128	13
Durrës	4	24	492	49
Dibër	4	27	132	28
Elbasan	12	33	1.176	63
Fier	9	31	892	50
Gjirokastër	8	38	478	99
Korçë	10	23	513	17
Kukës	2	29	170	64
Lezhë	3	17	474	57
Shkodër	6	12	464	7
Tiranë	7	5	0	0
Vlorë	8	38	538	32
Gjithsej	78	18	5.457	15

Burimi: Studimi, Janar 2025

Përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror janë (figura 15) kryesisht fëmijët deri 15 vjeç (35%), të pasuar nga tre grup moshat e tjera, pesha e të cilave kundrejt totalit është afërsisht e njëjtë, 21-23%. Në krahasim me vitin 2023, pesha e të moshuarve është dyfishuar, nga 12% në vitin 2023¹ në 23% në 2025.

Figura 15: Përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror sipas grup moshës



Burimi: Studimi, Janar 2025

Mbi 50% e përfituesve të shërbimeve janë të gjinisë femërore (52%). Tabela 10 pasqyron në mënyrë të detajuar numrin e përfituesve sipas qarqeve, gjinisë dhe grupeve.



1 Hartëzimi i Shërbimeve Sociale, 2023, <https://www.undp.org/albania/publications/mapping-social-services-albania-0>

Tabela 11: Përfituesit e shërbimeve sipas qarqeve, grupeve dhe gjinisë, numër

Qarqet	Sipas kategorive		Individë në nevojë		Fëmijë JKP		Fëmijë AK		Të rritur AK		Të rinj në nevojë		Viktima dhune		Romë & Egjiptianë		Të moshuar	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Berat	1.094	535	274	166	10	5	160	74	60	20	141	42	48	48	219	140	182	40
Durrës	2.921	1.465	1.447	798	213	95	466	168	125	66	0	0	80	75	249	120	341	143
Dibër	544	221	49	18	0	0	154	62	27	15	100	50	39	39	110	43	176	38
Elbasan	2.194	1.014	288	159	59	28	499	177	51	20	186	99	90	81	438	214	711	305
Fier	2.500	1.091	1.203	627	0	0	187	54	334	148	362	87	39	39	112	45	223	49
Gjirokastrë	906	476	242	140	14	10	136	54	90	52	30	20	76	71	279	136	318	140
Korçë	2.888	1.375	1.306	715	23	11	214	65	201	106	115	63	39	39	110	43	824	250
Kukës	290	132	0	0	0	0	98	32	100	69	0	0	76	71	249	120	78	17
Lezhë	1.534	719	688	324	37	32	102	33	51	28	60	48	39	39	316	157	194	24
Shkodër	7.511	4.448	4.069	2.600	167	39	291	128	573	231	461	122	161	156	457	249	448	167
Tiranë	14.946	7.828	7.269	4.245	644	252	1.452	526	628	427	1.220	393	106	106	529	330	2.036	688
Vlorë	1,763	1.013	312	164	27	15	148	71	106	46	119	43	89	84	300	165	386	128
Gjithsej	39.091	20.317	17.147	9.956	1.194	487	3.907	1.444	2.346	1.228	2.794	967	2.249	2.118	3.537	2.128	5.917	1.989


Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 11 gjithashtu tregon se:

- ✓ Individët në nevojë, fëmijët dhe të rriturit AK, gratë në nevojë, komuniteti etnik Rom dhe Egjiptian dhe të moshuarit janë grupet që përfitojnë shërbime në çdo qark të vendit.
- ✓ Fëmijët jashtë kujdesit prindëror dhe të “Rinj të nevojë” përfitojnë shërbime përkatësisht në 9 dhe në 10 qarqe nga 12. Në Dibër, Fier dhe Kukës dhe në Durrës e Kukës nuk ofrohen shërbime përkatësisht për secilin grup.

Figura 16 ilustron peshën në përqindje të përfituesve të secilit grup ndaj totalit si edhe peshën në përqindje të përfituesve të gjinisë femërore ndaj grupit përkatës.

Figura 16: Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror sipas grupeve dhe gjinisë, përqindje



Burimi: Studimi, Janar 2025

Siç tregon figura 16, përfituesit e gjinisë femërore mbizotërojnë ndaj gjinisë mashkullore, kryesisht tek grupi “Individë në familje në nevojë”, si edhe tek grupet e Viktimave të dhunës, “Romë dhe Egjiptianë” dhe “Të rritur AK”. Në të gjitha grupet e tjera, pesha në përqindje e përfituesve “femra” është më e vogël se sa ajo e meshkujve.


Figura 17 plotëson informacionin mbi përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror sepse paraqit grupet e përfituesve si edhe shërbimet që ato përfitojnë. Figura 17 është ndërtuar bazuar tek të dhënat e tabelës 12, e cila e paraqit informacionin të detajuar sipas qarqeve.

Tabela 12: Shërbimet sipas grupeve të përfituesve si edhe përfituesit në numër, sipas qarqeve

Qarqet	Sipas kategorive		Individë në nevojë		Fëmijë JKP		Fëmijë AK		Të rritur AK		Të rinj në nevojë		Viktima dhune		Romë&Egjiptianë		Të moshuar	
	Përfitues	Shërbime	Përfitues	Shërbime	Përfitues	Shërbime	Përfitues	Shërbime	Përfitues	Shërbime	Përfitues	Shërbime	Përfitues	Shërbime	Përfitues	Shërbime	Përfitues	Shërbime
Berat	1.094	85	274	11	10	9	160	22	60	6	141	3	48	12	219	5	182	17
Durrës	2.921	132	1.447	39	213	16	466	35	125	10	0	0	80	13	249	8	341	11
Dibër	544	55	49	4	0	0	154	22	27	8	100	4	39	6	110	0	176	11
Elbasan	2.194	179	288	25	59	11	499	50	51	13	186	22	90	9	438	25	711	24
Fier	2.500	104	1.203	27	0	0	187	20	334	6	362	19	39	11	112	3	223	18
Gjirokastrë	906	105	242	18	14	2	136	21	90	13	30	3	76	11	279	5	318	32
Korçë	2.888	214	1.306	34	23	20	214	36	201	40	115	17	39	15	110	14	824	38
Kukës	290	29	0	0	0	0	98	12	100	3	0	0	76	8	249	0	78	6
Lezhë	1.534	82	688	14	37	11	102	15	51	9	60	3	39	11	316	13	194	6
Shkodër	7.511	205	4.069	34	167	24	291	32	573	27	461	22	161	17	457	10	448	39
Tiranë	14.946	375	7.269	44	644	25	1.452	77	628	46	1.220	32	106	54	529	24	2.036	73
Vlorë	1.763	104	312	13	27	10	148	18	106	7	119	7	89	19	300	8	386	22
Gjithsej	39.091	1.669	17.147	263	1.194	128	3.907	360	2.346	188	2.794	132	2.249	186	3.537	115	5.917	297

Burimi: Studimi, Janar 2025

Figura 17: Grupet e përfituesve dhe shërbimet që përfitojnë në përqindje




Burimi: Studimi, Janar 2025

Siç vërehet nga figura 17, përqindja e përfituesve ndaj totalit nuk përputhet me përqindjen e shërbimeve në funksion të tyre. Kështu, 44% e përfituesve (Individë të familjeve në nevojë) përfitojnë vetëm 16% të shërbimeve. Ndërsa shërbimet për “Fëmijët AK”, të “Moshuarit” dhe “Viktimat e dhunës” përbëjnë një përqindje më të lartë ndaj totalit të shërbimeve se sa grupi për të cilin këto shërbime ofrohen. Kjo gjetje e thjeshtë mund të jetë rrjedhojë e vendimeve të rastësishme, të kushtëzuara nga rrethanat ose nga mundësitë e financimit të shërbimeve. Sidoqoftë, planifikimi i shërbimeve duhet të udhëhiqet nga vlerësimi i nevojës.

Figura 18 paraqit renditjen e qarqeve sipas numrit të përfituesve, e cila ndryshon pak nga renditja e shërbimeve të ofruara në secilin qark (Figura 7). Sidoqoftë, çështja themelore nuk është numri i shërbimeve apo i përfituesve në çdo qark të vendit, sepse numri i përfituesve deri diku është i kushtëzuar nga numri i shërbimeve funksionale, të cilat mund të aksesojnë individët në nevojë.

Figura 18: Qarqet sipas numrit të përfituesve




Burimi: Studimi, Janar 2025

Problemet themelore që motivojnë ndërmarrjen e studimeve të tilla, si “Hartëzimi i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror”, janë më komplekse, sepse kërkojnë të hulumtojnë thellë në përmbajtjen e faktorëve të cilët kushtëzojnë:

- ✓ Pamjaftueshmërinë e shërbimeve në numër
- ✓ Larmishmërinë e tipologjisë, në përputhje me nevojën
- ✓ Shpërndarjen e shërbimeve sipas dimensionit gjeografik
- ✓ Mundësinë e qytetarëve për të aksesuar shërbimet
- ✓ Cilësinë dhe koston e shërbimeve.

Për të kontribuar sadopak në trajtimin e problemeve të mësipërme, janë analizuar tregues të drejtëpërdrejtë dhe jo të drejtëpërdrejtë. Kësisoj, është llogaritur treguesi i “Përfituesve për 10 mijë banorë” (figura 19) e më tej, ky tregues është krahasuar me treguesin e shërbimeve për 10 mijë banorë. Gjithashtu është llogaritur edhe treguesi i numrit mesatar të përfituesve për një shërbim, sipas qarqeve dhe në nivel kombëtar (figura 20).

Figura 19: Përfituesit për 10 mijë banorë sipas qarqeve



Burimi: Studimi, Janar 2025

Figura 19 paraqit renditjen e qarqeve sipas treguesit “Përfitues për 10 mijë banorë”. Ky është një tregues i llogaritur, jo i drejtëpërdrejtë, i krijuar për qëllim të këtij studimi. Sipas këtij treguesi, qarku Kukës është qarku me numrin më të vogël të përfituesve për 10 mijë banorë, ndërsa Shkodra është qarku me numrin më të lartë të përfituesve, çka dëshmon një gjetje kontradiktore: Numri i përfituesve për 10 mijë banorë është i ulët në qarkun e Kukësit sepse qytetarët nuk kanë nevojë për shërbime apo sepse nuk ka shërbime? Edhe pa bërë llogaritje të tjera, mund të perceptohet se arsyeja e vërtetë është pamjaftueshmëria e shërbimeve, pasi në 1.1. kjo çështje u analizua gjerësisht dhe qartësisht u tregua se shërbimet ekzistuese janë të pamjaftueshme.


Gjetjet sipas figurës 19 nuk përputhen plotësisht me gjetjet sipas figurës 8 (Shërbimet për 10 mijë banorë sipas qarqeve). Sipas figurës 8, renditja e qarqeve sipas treguesit të Shërbimeve për 10 mijë banorë është: Dibër, Kukës, Berat, Elbasan, Korçë, Lezhë, Fier, Durrës, Vlorë, Tiranë, Gjirokastrë, Shkodër. Megjithatë vetëm me një bazë të tillë informacioni nuk mund të formulohet gjetje shkencërisht e saktë e mjaftueshmërisë apo pamjaftueshmërisë së shërbimeve.

Në studimet e mëparshme analiza është plotësuar me interpretimin edhe të treguesit Përfitues/Shërbim. Por gjykohet që çfarëdo treguesi jo i drejtëpërdrejtë që të llogaritet dhe përdoret nuk mund të shërbejë për të identifikuar me vërtetësi çështjen e mjaftueshmërisë apo pamjaftueshmërisë të shërbimeve të përkujdesit shoqëror sepse të gjitha këta tregues mbështeteten mbi çfarë ofrohet dhe jo mbi çfarë është e nevojshme apo kërkohej apo është planifikuar në plane strategjike afatgjata.

Për këtë arsye, për të argumentuar në mënyrë të qëndrueshme gjetjet e studimit, analiza plotësohet me të dhënat dhe treguesit jo të drejtëpërdrejtë të paraqitur tek kapitulli 1.4, të cilët konsiderojnë përveç çfarë ofrohet, edhe nevojën si edhe kapacitetet akomoduese të nevojës. Analiza mbi bazën e këtyre tre treguesve jo të drejtëpërdrejtë është risi i këtij studimi.



1.3. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE DHE INSTITUCIONALE, NË FUNKSION TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR



Analiza e kapaciteteve institucionale dhe njerëzore në funksion të sigurimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, është një element i ri, i shtuar për herë të parë në Hartëzimin e vitit 2023, me qëllim që përveç argumentimit mbi shërbimet dhe shpërndarjen e tyre, apo nevojën e paplotësuar për shërbime të përkujdesit shoqëror, të evidentohen edhe kapacitetet, për të gjykuar saktë e plotësisht mbi mundësitë për rritjen e shkallës të mbulimit me shërbime të cilësishme të përkujdesit shoqëror, por edhe më tej, në realizimin e të drejtës së qytetarëve për përfshirje sociale.

Sot në Shqipëri, janë 4,163 punonjës (11% më shumë se sa në vitin 2023), që planifikojnë, administrojnë, sigurojnë dhe ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror në të gjithë vendin, në bashki dhe institucione të përkujdesit shoqëror, publike ose jo publike. 77% e tyre ose 3,187 punonjës janë drejtëpërsëdrejti të angazhuar me funksionimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në institucione, ndërsa 23% ose 976 punonjës mbështesin funksionimin e sistemit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në bashkitë e vendit. 79% e administratës së shërbimeve të përkujdesit shoqëror në institucione dhe 77% e administratës së shërbimeve në bashki, është e gjinisë femërore.


95% e stafit të bashkive është me arsim të lartë dhe pas universitar, ndërsa 69% e stafit të ofruesve të shërbimeve është gjithashtu me arsim të lartë.

Tabela 13 sjell të dhëna të plota mbi stafin e ofruesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, si edhe përbërjen e tij sipas gjinisë, funksionit, arsimit dhe tipit të kontratës. Siç konstatohet, 78% e stafit të ofruesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror i përket gjinisë femërore, ndërsa 67% e stafit është me arsim të lartë. Gjithashtu 65% e stafit është e angazhuar në sigurimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, 25% është staf mbështetës, ndërsa drejtuesit përbëjnë 10% të të gjithë burimeve njerëzore. 82% e stafit është i angazhuar me kontratë me kohë të plotë, ndërsa pjesa tjetër, me kontratë me kohë të pjesshme. Vlen për t'u nënvizuar fakti se 190 (24 më pak se sa në vitin 2023) punonjës janë të angazhuar si vullnetarë, në institucionet e katër qarqeve të vendit, përkatësisht në Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Dibër. Nga 190 vullnetarë, 170 janë të angazhuar në qarkun e Tiranës. Kjo kategori nuk është llogaritur në shumën e përgjithshme të burimeve njerëzore meqenëse është e angazhuar në mënyrë të përkohshme dhe/ose sezonale.

Tabela 13: Kapacitetet administrative, burimet njerëzore që sigurojnë shërbimet e përkujdesit shoqëror tek ofruesit e shërbimeve

Qarqet	Staf gjithsej		Drejtues sipas arsimit				Stafi mbështetës sipas arsimit				Stafi ofrues i shërbimeve sipas arsimit				Stafi sipas kontratës, kohë			
	Femra	Meshkuj	Lartë	Mesëm	Bazë	Gjithsej	Lartë	Mesëm	Bazë	Gjithsej	Lartë	Mesëm	Bazë	Gjithsej	Të plotë	Të pjesshme	Vullnetare	Gjithsej
Berat	98	18	14	0	0	14	0	20	12	32	57	13	0	70	102	14	0	116
Durrës	200	30	20	1	0	21	0	7	36	43	143	15	8	166	198	32	2	232
Dibër	43	10	3	1	0	4	0	3	6	9	36	4	0	40	49	4	3	56
Elbasan	222	68	36	0	0	36	3	74	8	85	152	17	0	169	226	64	15	305
Fier	123	44	23	0	0	23	20	16	2	38	84	22	0	106	126	41	0	167
Gjirokastrë	96	26	10	0	0	10	2	7	6	15	92	5	0	97	98	24	0	122
Korçë	230	138	25	0	0	25	25	63	7	95	116	132	0	248	212	156	0	368
Kukës	16	4	2	1	0	3	0	3	0	3	13	1	0	14	18	2	0	20
Lezhë	67	16	30	1	0	31	0	8	8	16	23	13	0	36	59	24	0	83
Shkodër	389	103	32	1	0	33	22	51	23	96	242	120	1	363	437	55	0	492
Tiranë	866	202	94	6	0	100	95	214	15	324	565	79	0	644	921	147	170	1.238
Vlorë	154	24	17	2	0	19	8	36	1	45	108	3	3	114	158	20	0	178
Gjithsej	2.504	683	306	13	0	319	175	502	124	801	1.631	424	12	2.067	2.604	583	190	3.377

Figura 20 ilustron më tej përbërjen e stafit të përgjithshëm të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, sipas arsimit. Siç konstatohet, punonjësit me arsim të lartë dominojnë si nëpër bashki ashtu edhe nëpër institucione, përkatësisht 98% e stafit të bashkive dhe 66% e stafit të ofruesve të përkujdesit shoqëror.




Burimi: Studimi, Janar 2025

Edhe analiza sipas stafit të dedikuar tek sigurimi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe përfituesve të shërbimeve dëshmon se kapacitetet njerëzore janë mëse të mjaftueshme në numër dhe formim për të siguruar shërbime të cilësishme (figurat 21 dhe 22).

Figura 21 mbështet idenë se burimet njerëzore të ofruesve të përkujdesit shoqëror kudo në Shqipëri janë të mjaftueshme për të siguruar shërbime të cilësishme tek ofruesit e shërbimeve sepse çdo punonjësi i takon të kujdeset mesatarisht për 7 (Gjirokastra) deri 15 (Kukësi) përfitues shërbimesh, plotësisht e mundshme dhe e arritshme. Sidoqoftë, kjo gjetje duhet të krahasohet me standartet e miratuara të shërbimeve të përkujdesit shoqëror si edhe me vlerësimin e performancës të stafeve përkatëse, për të konkluduar nëse burimet njerëzore të institucioneve janë të mjaftueshme apo të pamjaftueshme.

Pavarësisht numrit të stafit që ofron shërbime të përkujdesit shoqëror, çështja e nevojës së vazhdueshme për investim në drejtim të kualifikimit profesional dhe rritjes, kryesisht në drejtim të planifikimit të shërbimeve mbi bazën e nevojave, identifikimit të nevojës si edhe të rritjes cilësore të shërbimeve që ofrohen, është çështje vazhdimisht e kërkuar me prioritet. Veçanërisht, stafet e institucioneve jo publike kërkojnë nga strukturat qeveritare më shumë vëmendje dhe ndërgjegjësim për punën e palodhur që ata realizojnë në shërbim të qytetarëve në nevojë.

Figura 21: Treguesi Përfitues/Staf, Ofruesit e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, numër



Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 14 paraqit stafin e bashkive, përgjegjës për administrimin, planifikimin, krijimin, monitorimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror si edhe vlerësimin e rasteve të aplikimeve dhe referimin e tyre pranë shërbimeve përkatëse, të grupuar sipas qarqeve.



Tabela 14: Stafi i bashkive sipas llojit të formimit dhe qarqeve, numër


Qarqet	Staf		Punonjës Socialë		Psikologë		Juristë		Ekonomistë		Tjetër	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Berat	58	40	24	18	8	8	1	1	7	4	18	9
Durrës	66	58	36	33	1	1	3	3	9	5	17	16
Dibër	74	41	13	11	2	2	2	0	17	6	40	22
Elbasan	103	77	27	26	5	4	2	1	17	8	52	38
Fier	72	59	12	11	2	2	0	0	17	11	41	35
Gjirokastrë	45	32	11	6	0	0	0	0	9	6	25	20
Korçë	89	69	6	6	0	0	0	0	9	4	74	59
Kukës	60	41	14	11	1	1	0	0	7	7	38	22
Lezhë	30	21	12	11	3	3	0	0	6	4	9	3
Shkodër	101	75	14	11	12	10	2	2	17	10	56	42
Tiranë	211	185	132	120	1	1	1	1	13	10	64	53
Vlorë	64	56	15	12	1	1	0	0	9	6	39	37
Gjithsej	973	754	316	276	36	33	11	8	137	81	473	356

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 14 dëshmon se 77% e stafit i përket gjinisë femërore. Në tabelë paraqitet stafi i grupuar edhe sipas formimit, përkatësisht Punonjës socialë, psikologë, juristë, ekonomistë dhe profesione të tjera. Të dhënat dëshmojnë për përqindje mjaft të ulët të profesionistëve të fushës, përkatësisht vetëm 32% e stafit përbëhet nga punonjës socialë, 4% nga psikologë, 1% nga juristë, 14% nga ekonomistë, ndërsa në masën 49%, pra thuajse gjysma e stafit kanë formim krejtësisht tjetër, kryesisht inxhinjerë, mësues, agronomë, veterinerë etj.

Figura 22 plotëson kuadrin e njohjes së stafit të bashkive nëpërmjet paraqitjes së vlerave të treguesit “Treguesi Përfitues/Staf, Bashkitë”. Këtu nuk janë konsideruar përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, por përfituesit e shërbimeve në bashki, përfshirë ndihma monetare. Rezulton se mesatarisht një punonjës duhet të kujdeset për 107 (Berati) deri 629 (Kukësi) përfitues. Me përjashtim të Kukësit, në të gjitha qarqet e tjera, të paktën në vlerësim sipërfaqësor, situata ngjan e përballeshme. Gjithashtu duhet të nënvizohet fakti se edhe ngarkesa për staf në krahasim me dy vite më parë është thuajse përgjysmuar tek bashkitë më problematike si Kukësi, Dibra, Elbasani, Tirana etj.

Figura 22: Treguesi Përfitues/Staf, Bashkitë, numër



Burimi: Studimi, Janar 2025

Studimi gjithashtu evidentoi edhe disa të dhëna të tjera të rëndësishme, që ilustronë situatën e kapaciteteve njerëzore në shërbim të qytetarëve, në nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror.

Konkretisht:

- Sektori i NE është ende sektori më i vlerësuar, mirëorganizuar dhe i kompletuar me staf profesionist.
- 5 bashki nuk kanë person të caktuar për NjMF. Funksionet e NjMF realizohen, por nga persona të drejtorisë, të cilët mbulojnë 2 deri 3 funksione. Këto bashki janë: Gramsh, Libohovë, Dropull, Pustec, Pukë.
- Në 41 bashki, funksionet e NjVNR nuk realizohen nga staf i emëruar në atë detyrë.
- Punonjës të emëruar për të realizuar funksionimin e MIS janë vetëm në dy bashki, përkatësisht Gjirokastrë dhe Krujë, ndërsa bashkia Tiranë nuk përdor sistemin MIS për menaxhimin e të dhënave por sistemin Opendata.
- Në 16 bashki nuk ka person të emëruar për të mbuluar funksionet e “Shërbimeve për viktimat e dhunës në familje”.
- Në 15 bashki nuk ka person të emëruar për AK.
- Vetëm në 9 bashki ka person të emëruar për “Shërbimet ndaj komunitetit Rom dhe Egjiptian”.

1.3.1. Përdorimi i aplikimit për Fondin Social

Fondi social është përqafuar gjerësisht nga bashkitë, si një mekanizëm efektiv për rritjen e mundësive të bashkive për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Vetëm 9 nga 61 bashki (15%) nuk kanë aktualisht asnjë projekt të mbështetur nga Fondi Social. Në vijim paraqiten të gjitha bashkitë që aktualisht nuk kanë projekte të fondit social si edhe arsyet e mungesës së financimit:

- Skrapar (ka aplikuar në tetor 2024 por ende nuk ka përgjigje);
- Peqin (Nuk ka aplikuar);
- Mallakastër (Ka aplikuar por nuk ka fituar);
- Tropojë (Nuk ka aplikuar sepse nuk ka kapacitete);
- Mirditë (Nuk ka informacion);
- Kamëz (Financimi ka përfunduar, tani e mbështet bashkia);
- Kavajë (Nuk ka aplikuar sepse nuk kanë patur informacion);
- Himarë (Nuk ka fituar);
- Konispol (Nuk ka aplikuar sepse nuk kanë kapacitete të kualifikuara për projekte).

Sidoqoftë, me përjashtim të bashkive Tropojë, Konispol dhe Mirditë, të gjitha bashkitë deklarojnë se do të vijojnë të aplikojnë për mbështetje nga fondi social, për shkak të rolit që ky program luan në krijimin dhe funksionimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

1.4. VLERËSIMI I NEVOJËS PËR SHËRBIME TË PËRKUJDESIT SHOQËROR

Në ndryshim nga të gjitha vlerësimet e mëparshme për hartëzimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në vlerësimin e vitit 2025, u përdor një metodologji tjetër, risi e këtij vlerësimi.

Në pyetësor përveç pyetjeve që kërkonin të vlerësonin situatën aktuale të ofruesve, shërbimeve dhe përfituesve, u përfshinë edhe pyetje të cilat kërkonin të vlerësonin:

- Kapacitetet fizike dhe infrastrukturore të ofruesve të shërbimeve;
- Aplikantët, kërkesa e të cilëve pranë ofruesve të shërbimeve ishte refuzuar për arsye të ndryshme;
- Aplikantët, të cilët i drejtohen mesatarisht në një muaj bashkisë për të aksesuar shërbime të përkujdesit shoqëror, por aplikimi i tyre nuk është pranuar, gjithashtu për arsye nga më të ndryshmet.

Përveç të dhënave të mësipërme, nëpërmjet intervistave individuale u mbledhën të dhëna rreth:

- Përfituesve të NE, familje dhe individë si edhe përbërjes së tyre, përkatësisht fëmijë nën 16 vjeç, fëmijë me status jetim, fëmijë AK, të rritur AK, gra të vetme, të moshuar.
- Individë me AK, fëmijë dhe të rritur, përfitues të PAK si edhe Pagesës së kujdestarisë.
- Kërkesave të papranuara për mbështetje ekonomike dhe me shërbime për shkak të statusit si i varfër, fëmijë jashtë kujdesit prindëror, fëmijë AK, rritur AK, të rinj me probleme, gra në nevojë për mbrojtje, të moshuar në nevojë, romë & egjiptianë.
- Kërkesa të papranuara nga ofruesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të njëjtat kategori në nevojë.

Me të dhënat e mësipërme, si edhe nën supozimin se përfituesit e NE si edhe ata të pagesave të aftësisë së kufizuar, janë dy grupe tejet kritike në nevojë për shërbime, u ndërtuan treguesit që vijojnë:

- Treguesi i “Nevojës të paplotësuar për shërbime” sipas grupeve më kritike dhe në total për çdo bashki, qark dhe nivel kombëtar, numër absolut; (Për informacion të detajuar sipas grupeve dhe bashkive, shih Shtojcë 2 dhe 3)
- Treguesi i “Peshës së Përfituesve të shërbimeve ndaj aplikimeve”, i shprehur në përqindje, si raport ndërmjet: Përfitues të shërbimeve të përkujdesit shoqëror/Përfitues+ Aplikime të papranuara²
- Treguesi i “Shkallës së nevojës për shërbime të plotësuar”, i shprehur në përqindje, si raport ndërmjet Përfitues të shërbimeve të përkujdesit shoqëror/Përfitues+Nevoja për shërbime³. (Për informacion të detajuar sipas bashkive, shih Shtojcë 2).
- Koeficienti mjaftueshmërisë akomoduese i shprehur në përqindje, si raport ndërmjet kapaciteteve akomoduese ende të lira për secilin grup në nevojë dhe kapaciteteve gjithsej për atë grup, në secilën bashki të vendit⁴. (Për informacion të detajuar sipas bashkive, shih Shtojcë 2).
- Pësia e grupeve më kritike, përkatësisht Fëmijë në nevojë, Të moshuar në nevojë, Gra në nevojë, të Rinj në nevojë, të shprehur në përqindje, si raport ndërmjet numrit të individëve të rezultuar në nevojë nga ky vlerësim me grupin përkatës në strukturën e popullsisë, mbështetur në të dhënat e Censurit 2023.

2 Dy kufizat duhet të mblidhen sepse “Përfituesit e Shërbimeve” nuk janë pjesë e “Aplikimeve të papranuara”

3 Dy kufizat duhet të mblidhen sepse “Përfituesit e Shërbimeve” nuk janë pjesë e “Nevojës për shërbime”

4 Kapacitetet gjithsej akomoduese u llogaritën si shumë e kapaciteteve të të gjithë ofruesve të së njëjtës tipologji, të destinuara për të njëjtën kategori individësh në nevojë.

Të dhënat e mbledhura u përdorën për ndërtimin e tabelës 15.

Tabela 15: Përmbledhje e treguesve të vlerësimit të nevojës për shërbime

Grupet në nevojë për shërbime	Nevoja për shërbime	Kapaciteti Ofruesve	Përfitues aktual	Aplikime të papranuara	Nevoja për shërbime e plotësuar %	Përfitues/Aplikime %	Koeficienti Mjaftueshmërisë Akomoduese %
Të varfër	171.012	13.152	17.147	5.754	9	75	-30
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	1.439	1.163	1.194	309	45	79	-3
Fëmijë AK	17.155	4.846	3.907	825	19	83	19
Të rritur AK	77.512	1.969	2.346	2.243	3	51	-19
Të rinj	1.440	2.105	2.794	2.243	66	55	-33
Gra	6.278	1.919	2.249	1.118	26	67	-17
Të moshuar	5.106	6.046	5.917	2.553	54	70	2
Romë dhe Egjyptianë	549	2.370	3.537	549	87	87	-49
Gjithsej	280.491	33.570	39.091	15.594	12	71	-16

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 15 dëshmon se 280.491 persona janë në nevojë për shërbime në Shqipëri, nga të cilët mëse 60% janë të varfër, 28% janë të rritur me AK, 6% janë fëmijë me AK, ndërsa 6% janë të gjitha grupet e tjera. Nevoja për shërbime në nivel kombëtar plotësohet në masën 12%, ku grupet më të trajtuara janë: Romët, të Rinjtë, Të moshuarit, Fëmijët jashtë kujdesit prindëror, gratë në nevojë, fëmijët me AK, të varfërit dhe në fund, të rriturit me AK.

Kjo gjetje plotësohet nga treguesi i “Nivelit të aplikimeve të realizuara”, i cili rezulton 71% në rang kombëtar. Të dy treguesit duhet të analizohen në bashkëpunim me njeri tjetrin sepse nuk ilustrojnë të njëjtat gjetje. Kështu për shembull, shkalla e plotësimit të nevojës të të rinjve për shërbime rezulton 66%, gjë që tregon se 66% e të rinjve në nevojë, aksesojnë shërbime të përkujdesit shoqëror. Ndërsa vlera 55% e shkallës të aplikimeve të plotësuara tregon se ç’pjesë e atyre që kanë aplikuar, kanë përfituar. Kjo vlerë mund të kushtëzohet nga mungesa e informacionit, por edhe nga mungesa e kapaciteteve.

Për këtë arsye është llogaritur për herë të parë, edhe Koeficienti i Mjaftueshmërisë Akomoduese, i cili rezulton negativ, gjë që vërteton mungesën e shërbimeve për secilin grup në nevojë si edhe në rang vendi. Në rang vendi, mungesa është 16%, gjë që interpretohet si nevojë 16% më e madhe se sa kapacitetet ekzistuese.

Nëse analizojmë këtë koeficient për secilin grup, konstatojmë se me përjashtim të të moshuarve dhe fëmijëve AK, për asnjë grup tjetër në nevojë nuk ka kapacitete të lira. Analiza sipas qarqeve dhe bashkive në kapitullin e dytë tregon saktësisht jo vetëm situatën e kapaciteteve në përgjithësi por edhe shpërndarjen gjeografike të tyre.

Pyetja intriguese në këtë pjesë lidhet me çështjen nëse ka kontradita ndërmjet tre treguesve të përzgjedhur për të ilustruar nevojën për shërbime.

Gjykohet që nuk ekziston asnjë kontraditë. Përkundrazi, secili nga treguesit shërben për të ilustruar një komponent të nevojës. Kështu, treguesi i shkallës së plotësimit të nevojës nënvizon faktin se për një trajtim më cilësor të të gjithë atyre që kanë të paktën një arsye për të qenë të përjashtuar ose në rrezik përjashtimi, duhet të ndërtohen shërbime të reja.

Treguesi i shkallës së plotësimit të aplikimeve tregon se në ç’masë sistemi iu përgjigjet atyre që aplikojnë, pa analizuar cilësinë e aplikimeve si edhe të drejtën e përfitimit.


Treguesi i kapacitetit akomodues tregon nëse sistemi ka realisht mundësi akomodimi të aplikimeve dhe për cilat grupe.

Përfundimisht, gjetjet e tabelës 15 mund të përmbledhen si vijon:

- Nevoja për shërbime në rang kombëtar plotësohet në masën 12%, ku grupet më të përjashtuara janë të varfërit dhe të rriturit AK.
- Aplikimet për shërbime plotësohen në masën 71%, ku më të përjashtuarit janë të rriturit AK dhe të rinjtë, të cilët e kanë më të vështirë se grupet e tjera që të plotësojnë kërkesën e tyre.
- Pavarësisht kërkesave dhe shkallës së plotësimit të aplikimeve për këto kërkesa, kapacitetet akomoduese janë të pamjaftueshme për të gjitha grupet, me përjashtim të të moshuarve dhe fëmijëve me AK.

Çështja e fundit që trajtohet në këtë kapitull është paraqitja e shpërndarjes së individëve në nevojë në çdo qark të vendit në raport me popullsinë. Figura 23 pasqyron peshën e individëve në nevojë për shërbime, kundrejt popullsisë, në të gjitha qarqet e vendit. Siç konfirmon figura 23, treguesi është më i lartë se sa mesatarja e vendit në qarqet Lezhë, Shkodër, Korçë, Elbasan, Dibër dhe Kukës. Vlera e treguesit për Elbasanin është 2 herë më e lartë se sa mesatarja e vendit, për Dibrën është 3 herë më e lartë, ndërsa për Kukësin është 5 herë më i lartë.


Figura 23: Individë në nevojë për shërbime ndaj popullsisë, sipas qarqeve, %



Burimi: Studimi, Janar 2025

Figura 24 plotëson gjetjet, nëpërmjet paraqitjes së shkallës së plotësimit të nevojave në çdo qark, duke konsideruar numrin e individëve në nevojë si edhe numrin e personave që përfitojnë shërbime në çdo qark. I njëjti tregues, por për bashkitë paraqitet tek shtojca 2 dhe i detajuar sipas bashkive dhe grupeve në nevojë, tek shtojca 3.

Figura 24-% e individëve që realizojnë nevojën e tyre për shërbime në çdo qark




Burimi: Studimi, Janar 2025

Siç tregon figura 24, në Kukës vetëm 1% e personave në nevojë arrijnë të përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror. Në qarkun e Tiranë, qarku më i zhvilluar i vendit, 34% e personave në nevojë përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror. Edhe pse kjo është e dhëna më premtuese, ende është larg 100% të plotësimit të nevojave.

Përfundimisht, analiza e situatës së shërbimeve të përkujdesit shoqëror e plotësuar me analizën e përfituesve, qartësisht lejon formulimin e gjetjeve që vijnë:

- ✓ Shërbimet e përkujdesit shoqëror si në numër e tipologji janë të **pamjaftueshme**.
- ✓ Shpërndarja e shërbimeve të përkujdesit shoqëror nuk është e **njëtrajtshme** nga pikëpamja gjeografike dhe as në përputhje me nevojën apo probleme të tjera ekonomike e sociale të zonave të vendit.
- ✓ Shërbimet e përkujdesit shoqëror sipas grupeve përfituese nuk reflektojnë plotësisht **nevojat** e grupeve meqenëse ka grupe për të cilat shërbime ofrohen në shumicën e bashkive të vendit, ndërsa ka grup të tjera për të cilat ofrohen shumë pak ose nuk ofrohet asnjë shërbim.
- ✓ Shërbimet e përkujdesit shoqëror janë ende **“të papërcaktuara qartë”** në atë që nuk përputhen ende me nevojën e përgjithshme dhe specifike të qytetarëve për shërbime.
- ✓ Ofrimi i shërbimeve nuk është i kushtëzuar nga **studimi dhe analiza e nevojës** për shërbime, për të cilën ende nuk ka një **metodologji** unike.



Analiza në nivel qarku/bashkie ka për qëllim të identifikojë:

- ✓ Zhvillimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror nëpërmjet ndryshimit të numrit të ofruesve, shërbimeve dhe përfituesve.
- ✓ Evidentimin e faktorëve kryesorë që kanë ndikuar në zhvillimin e sistemit.
- ✓ Përshkrimin e cilësive themelore të sistemit në çdo bashki
- ✓ Vlerësimin e nevojës për shërbime të përkujdesit shoqëror
- ✓ Identifikimin e problemeve më kritike në çdo qark, të cilat duhet të shërbejnë si udhërrëfyes për hartimin e projekteve të ardhme për zhvillimin e sistemit dhe plotësimin e nevojave më kritike të qytetarëve.

Komponenti sasior i zhvillimit të sistemit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, është realizuar, siç edhe përshkruhet në metodologji, nëpërmjet treguesve që përshkruajnë numrin e ofruesve, shërbimeve dhe përfituesve si edhe ndryshimin e tyre në periudha të ndryshme. Sidoqoftë, siç u komentua edhe në kapitullin e parë, vetëm përshkrimi i aspektit sasior të ofruesve dhe shërbimeve, edhe pse mundëson vlerësimin e aksesit të qytetarëve ndaj shërbimeve, nuk mjafton për të krijuar idenë e qartë mbi përdorimin e cilësishëm të shërbimeve.

Për këtë qëllim, në këtë kapitull, janë përdorur disa tregues të tjerë, të ndërtuar specifikisht për këtë vlerësim. Këta janë:

Treguesi i integruar i **“Shpërndarjes së përfituesve për çdo shërbim** sipas tipologjisë së shërbimeve”, i cili llogaritet si raport ndërmjet numrit të përfituesve për çdo tipologji shërbimi me numrin e shërbimeve të asaj tipologjie në çdo bashki të qarkut. Ky tregues shërben për të identifikuar:

- ✓ Bashkitë sipas tipologjive të shërbimeve që sigurojnë.
- ✓ Shpërndarjen e tipologjive nëpër bashkitë e qarkut.
- ✓ Shpërndarjen e tipologjive në përqindje brenda të njëjtës bashki.

Pra, ky tregues shërben kryesisht për të vlerësuar shkallën e barazisë të qytetarëve sipas vendbanimit gjeografik, në aksesimin e tipologjive të ndryshme të shërbimeve.

Treguesi i integruar i **“Përfitues për një shërbim”**, i llogaritur si raport ndërmjet numrit të përfituesve të çdo kategorie në nevojë me numrin e shërbimeve që përfiton secila kategori, për çdo bashki. Përdorimi i këtij treguesi, risi e këtij vlerësimi, plotëson kuadrin e vlerësimit të aksesit dhe përdorimit të cilësishëm të shërbimeve, sepse ky tregues mundëson krahasimin e vlerave me vlerën maksimale të numrit të përfituesve të një grupi kritik për një shërbim në rang qarku, me qëllim evidentimin e numrit më të madh të përfituesve për çdo shërbim dhe shpërndarjen e tyre në bashkitë e qarkut.. Ky tregues shërben për të evidentuar:

- ✓ Numrin më të madh dhe më të vogël të përfituesve për një shërbim në të njëjtën bashki.
- ✓ Numrin më të madh dhe më të vogël të përfituesve për një shërbim të të njëjtit grup në bashki.
- ✓ Numrin më të madh dhe më të vogël të përfituesve për një shërbim të të njëjtit grup në bashki të ndryshme.

Pra, ky tregues jo vetëm thellon më tej analizën sipas mundësisë së aksesimit të shërbimeve duke treguar grupet më të përjashtuara, por edhe tërheq vëmendjen mbi shkallën e zbatimit të standarteve të cilësisë së shërbimeve.

Risia tjetër e vlerësimit qëndron në metodologjinë e përdorur për vlerësimin e nevojës dhe shkallës së plotësimit të saj. Treguesit e përzgjedhur për këtë qëllim u përshkruan dhe sqaruan gjerësisht në kapitullin e parë. Në këtë kapitull, paraqiten tabelat (duke filluar nga tabela 1, në çdo qark) me treguesit përkatës për çdo bashki të vendit, të cilat paraqisin treguesit e:


- ✓ Shkallës së plotësimit të nevojës për shërbime në çdo bashki të qarkut.
- ✓ Shkallën e plotësimit të aplikimeve për çdo bashki.
- ✓ Koeficientin e mjaftueshmërisë akomoduese për çdo bashki (KMA).

Koeficienti i Mjaftueshmërisë Akomoduese, një tregues i ri, i përdorur për herë të parë në këtë vlerësim, është llogaritur vetëm për ata ofrues që ofrojnë shërbime aktualisht në bashki. Në këtë kontekst, duhet të kuptohet se vlera 0 e treguesit dëshmon për plotësimin 100% të kapaciteteve ekzistuese, vlera negative e treguesit dëshmon për mungesën e kapaciteteve tek ofruesit që funksionojnë dhe ofrojnë shërbime, vlera pozitive dëshmon për kapacitete të lira, ndërsa shënimi “nuk ka kapacitete” tregon se nuk ka ofrues të asaj tipologjie për atë grup.

Vlen të nënvizohet fakti se të tre treguesit duhet të përdoren njëkohësisht dhe në harmoni me njeri tjetrin, për të patur një analizë reale sepse siç dëshmon analiza në nivel kombëtar, shërbimet e përkujdesit shoqëror nuk janë të shpërndara njëtrajtësisht në Shqipëri. Përkundrazi, ato janë të përqendruara kryesisht në qendrat e qarqeve si edhe në zonat urbane. Për rrjedhojë, nuk ka vlerë të veçantë treguesi i shkallës së aplikimeve të plotësuara 90% ose 100%, nëse shkalla e plotësimit të nevojave për shërbime është 2% apo edhe 10%. Gjithashtu, nuk është veçanërisht domethënës fakti i vlerës së treguesit KMA pozitiv, 5% ose edhe 20%, nëse treguesi i shkallës së plotësimit të nevojave është 5%, sepse KMA mund të jetë pozitiv pasi bashkia ofron vetëm një shërbim, në të cilin ka disa kapacitete të lira, ndërsa meqenëse nuk ofron asnjë shërbim tjetër, shkalla e plotësimit të nevojave është tejet e ulët. Vetëm analiza e harmonizuar dhe integruar mund të nxjerrë në pah problemet më kritike për çdo bashki dhe më tej, çdo qark.

Analiza e thelluar e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në nivel bashkie është jo vetëm domethënëse në raport me qëllimin e këtij studimi, por edhe funksionale sepse ofron - evidenca të mirë argumentuara mbi drejtimit në të cilat bashkitë dhe partnerët e tyre duhet të orientojnë vëmendjen për ngritjen e shërbimeve të reja si edhe forcimin e zhvillimit të shërbimeve ekzistuese.

2.1. BASHKITË E QARKUT BERAT



Qarku Berat, me një popullsi prej 140.956 banorë⁵, përbëhet nga 5 bashki, ndër të cilat Bashkia Berat(62.232 banorë) është bashkia më e madhe, më e zhvilluar e qarkut si edhe qendra e qarkut.

Në qarkun e Beratit ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror 17 ofrues, nga të cilët 94% janë publikë (Tabela 1). Thuhet se 59% e ofruesve ushtrojnë funksionin e tyre në bashkinë Berat. Bashkitë Kuçovë dhe Skrapar janë bashkitë me numrin më të vogël të ofruesve (1), bashkia Dimal me 2 ofrues dhe ajo e Poliçanit me 3 ofrues.

Tabela 1: Ofrues, Shërbime dhe Përfitues, numër


Bashkitë	Ofrues të shërbimeve			Shërbime sipas ofruesve			Përfitues sipas ofruesve		
	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej
Berat	9	1	10	41		41	369	473	842
Kuçovë	1	0	1	4	0	4	11	0	11
Poliçan	3	0	3	15	0	15	142	0	142
Skrapar	1	0	1	3	0	3	8	0	8
Dimal	2	0	2	19	0	19	91	0	91
Gjithsej	16	1	17	82	0	82	621	473	1.094

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 1 sjell gjithashtu informacion edhe për numrin e shërbimeve që sigurojnë të gjithë ofruesit si edhe përfituesit e tyre. Siç edhe konstatohet, 77% e përfituesve i përkasin bashkisë Berat.

Vlen të nënvizohet fakti se në krahasim me dy vite më parë, numri i ofruesve të shërbimeve është rritur 30% në të gjithë qarkun. Figura 1 qartësisht tregon se në bashkitë Berat dhe Poliçan, numri i ofruesve është rritur, ndërsa në bashkitë e tjera nuk ka ndryshuar.


Figura 1 - Ofruesit e shërbimeve, numër



Burimi: Studimi, Janar 2025

Rritja e numrit të ofruesve nuk ka ndikuar në rritjen e konsiderueshme të numrit të përfituesve, numër i cili ka ndryshuar me vetëm 8%. (Figura 2)


Figura 2 - Përfituesit e shërbimeve



Burimi: Studimi, Janar 2025

Investimi nëpërmjet fondit social ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e numrit të ofruesve. Me përjashtim të bashkisë Skrapar, në të gjitha bashkitë e tjera është investuar nëpërmjet fondit social (5 ofrues nga 17 që ka qarku, 30%). (figura 3).

Figura 3 - Ofruesit e shërbimeve mbështetur nga fondi social kundrejt të gjithë ofruesve, 2025



Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 2 evidenton të gjithë ofruesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror sipas tipologjive të tyre, shoqëruar edhe me numrin përkatës të shërbimeve që sigurojnë si edhe me numrin përkatës të përfituesve.

Tabela 2: Ofruesit, shërbimet dhe përfituesit e përkujdesit shoqëror, sipas tipologjive të ofruesve, numër


Tipologjitë	Rezidenciale			Ditore			Komunitare			Qendra zhvillimi			Shumëdisiplinore			Strehëz emergjence			Shërbim lëvizës			Fondacione/Shoqata			Gjithsej		
	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P
Berat				1	3	30	2	6	61	2	9	108	1	8	70	1	4	8	2	11	92	1	3	473	10	44	842
Kuçovë				1	4	11																			1	4	11
Poliçan				1	9	50							1	4	42				1	2	50				3	15	142
Skrapar				1	3	8																			1	3	8
Dimal													1	16	66				1	3	25				2	19	91
Gjithsej	0	0	0	4	19	99	2	6	61	2	9	108	3	28	178	1	4	8	4	16	167	1	3	473	17	85	1.094

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 2 konfirmon se qarku i Beratit është i varfër në tipologji. Edhe në bashkinë Berat nuk funksionojnë të gjitha tipologjitë. Tipologjia e ofruesve rezidencialë mungon. Në bashkitë e tjera ofrohen vetëm tre tipologji.

Figura 4 paraqit vlerat e treguesit “Shpërndarja e përfituesve për çdo shërbim, sipas tipologjive”.

Figura 4-Shpërndarja e përfituesve për çdo shërbim, sipas tipologjive



Burimi: Studimi, Janar 2025

Treguesi i mësipërm i paraqitur në figurën 4, në përputhje me përkufizimin dhe mënyrën e tij të llogaritjes, informon se:

- Bashkia Berat ofron të gjitha tipologjitë e shërbimeve, Bashkia Dimal ofron 7 nga 11 tipologji, Bashkia Kuçovë vetëm 4 tipologji, e kështu për të gjitha bashkitë.
- Shërbimet parashoqërore ofrohen në çdo bashki; Kujdesi alternativ ofrohet vetëm në Berat dhe Dimal; Shërbime rezidenciale ofrohen gjithashtu vetëm në Berat, dhe kështu vijon për të gjitha bashkitë.
- Bashkia Berat ofron 100% të shërbimeve rezidenciale, të qendrave të zhvillimit dhe strehëzave të qarkut, 85% të shërbimeve të këshillimit, 50% të shërbimit të kujdesit alternativ të të gjithë qarkut; etj.

Tabela 3 plotëson kuadrin e vlerësimit të aksesit dhe përdorimit të cilësishëm të shërbimeve, nëpërmjet treguesit tjetër të integruar “Përfitues për një shërbim”, por sipas grupeve kritike, jo më sipas tipologjive të shërbimeve.

Kjo tabelë tregon se:

- Në bashkinë Berat marrin shërbime të gjitha grupet. Në Dimal vetëm 4 grupe marrin shërbime. Në bashkitë e tjera vetëm nga një grup.
- Në Berat, 49 individë në nevojë ekonomike, 55 romë dhe egjiptianë dhe 71 të rinj përfitojnë mesatarisht nga një shërbim, ndërsa në Dimal vetëm 4 dhe në Poliçan vetëm 7 individë në nevojë përfitojnë një shërbim, një diferencë mjaft e thellë ndërmjet të njëjtit grup të së njëjtës tipologji.
- Pavarësisht faktorit “Popullsi”, kjo diferencë duhet të nxisë debate në lidhje me standartet e cilësisë së shërbimeve si edhe standartet e ngarkesës së stafit pa cenuar cilësinë e shërbimeve.

Tabela 3: Përfitues për një shërbim në çdo bashki

Berat	Individë përfitues për një shërbim në çdo bashki				
	Berat	Kuçovë	Poliçan	Skrapar	Dimal
Individë në nevojë	49	0	6	0	4
Fëmijë jashtë kujdesit	1	0	0	0	1
Fëmijë AK	7	3	0	3	12
Të rritur AK	20	0	0	0	0
Të rinj në nevojë	71	0	0	0	0
Gra në nevojë	6	0	0	0	1
Romë dhe Egjiptianë	55	0	0	0	0
Të moshuar	9	0	12	0	0

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabelat 4 deri 8 përmbajnë vlerat e tre treguesve të ndërtuar për qëllim të këtij vlerësimi, përkatësisht Shkallës së plotësimit të nevojës për shërbime në çdo bashki të qarkut; Shkallën e plotësimit të aplikimeve për çdo bashki; Koeficientin e Mjaftueshmërisë Akomoduese për çdo bashki. Sipas të dhënave të tabelave 4 deri 8 rezultojnë se:



Bashkia Dimal, e pasuar nga bashkia Berat dhe Poliçan, kanë shkallën më të lartë të plotësimit të nevojave për shërbime, përkatësisht në masën 25%, 20% dhe 14%, ndërsa në dy bashkitë e tjera, Kuçovë dhe Skrapar, ky tregues ka vlerën tejet të ulët, 1%.

Bashkia Poliçan ka shkallën më të lartë të plotësimit të aplikimeve, 100%, ndërsa bashkitë Dimal dhe Berat e kanë gjithashtu të lartë, mbi 90%. Skrapari ka shkallën më të ulët, 23%. Fakti që bashkia Poliçan ka 100% shkallën e plotësimit të aplikimeve, nuk tregon se çdo individ në nevojë që i drejtohet strukturave të mbrojtjes, gjen zgjidhjen e problemit të tij. Treguesi ka këtë vlerë sepse numri i grupeve për të cilat ofrohen shërbime në Poliçan është tejet i kufizuar, për rrjedhojë, është e lehtë që kushdo që aplikon të përfitojë shërbim. Meqenëse ky tregues nëse përdoret i vetëm mund të udhëheqë audiencën në konkluzione të gabuara, vlerësimi plotësohet me përdorimin e të gjithë grupit të treguesve, të aplikuar për këtë qëllim.

KMA paraqitet në vlera pozitive për 4 nga 8 grupet kritike në bashkinë Berat; Për nga një grup në bashkitë Kuçovë, Skrapar e Poliçan (ndonëse në vlerë modeste) dhe për të gjitha grupet në bashkinë Dimal, me përjashtim të fëmijëve AK, për të cilët kapacitetet janë jashtëzakonisht të kufizuara.

Tabela 4: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Berat

Berat	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	1.154	30	245	34	18%	88%	-717%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	55	10	7	2	11%	78%	30%
Fëmijë me aftësi të kufizuar	209	20	59	1	22%	98%	-195%
Të rritur me aftësi të kufizuar	1.876	80	60	5	3%	92%	25%
Të rinj në kushte kritike	6	0	141	6	96%	96%	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	5	50	41	5	89%	89%	18%
Të moshuar	16	100	219	8	93%	96%	-119%
Romë dhe Egjiptianë	0	80	70	0	100%	100%	13%
Gjithsej	3.321	370	842	61	20%	93%	-128%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 5: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Kuçovë

Kuçovë	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	441	0	0	57	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	4	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	88	12	11	8	11%	58%	8%
Të rritur me aftësi të kufizuar	602	0	0	2	0%	0%	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	10	0	0	3	0%	0%	S'ka kapacitet
Të moshuar	54	0	0	27	0%	0%	S'ka kapacitet
Romë dhe Egjiptianë	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gjithsej	1.199	12	11	97	1%	10%	8%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 6: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Poliçan

Poliçan	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	453	25	18	0	4%	100%	28%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	4	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	30	0	12	0	29%	100%	S'ka kapacitet
Të rritur me aftësi të kufizuar	373	25	0	0	0%	S'ka përfitues	100%
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	7	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të moshuar	0	140	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	100%
Romë dhe Egjiptianë	0	0	112	0	100%	100%	S'ka kapacitet
Gjithsej	867	190	142	0	14%	100%	25%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 7: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Skrapar

Skrapar	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	277	0	0	22	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	3	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	100	15	8	0	7%	100%	47%
Të rritur me aftësi të kufizuar	225	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	9	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të moshuar	10	0	0	5	0%	0%	S'ka kapacitet
Romë dhe Egjiptianë	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gjithsej	624	15	8	27	1%	23%	47%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 8: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Dimal


Dimal	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	53	30	11	0	17%	100%	63%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	0	10	3	0	100%	100%	70%
Fëmijë me aftësi të kufizuar	14	15	70	2	83%	97%	-367%
Të rritur me aftësi të kufizuar	189	15	0	0	0%	S'ka përfitues	100%
Të rinj në kushte kritike	0	10	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	100%
Gra në kushte kritike	10	10	7	6	41%	54%	30%
Të moshuar	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Romë dhe Egjiptianë	0	10	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	100%
Gjithsej	266	100	91	8	25%	92%	9%

Burimi: Studimi, Janar 2025

2.1.1. Vlerësim përmbljedhës për bashkitë e qarkut Berat

1. Me një popullsi 140.956 banorë, qarku Berat renditet i teti në listën e qarqeve. Ai përbëhet nga 5 bashki.
2. Pavarësisht rritjes së numrit të ofruesve, të shërbimeve dhe të përfituesve në vijimësi, ka ende nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror.
3. Janë 6,277 individë në nevojë në qarkun e Beratit, ndërsa përfitues të shërbimeve janë 1,094 individë, me një shkallë plotësimi të nevojës 15%.
4. 85% e aplikantëve për shërbime arrijnë të përfitojnë shërbimet e kërkuara.
5. Koefficienti i Mjaftueshmërisë Akomoduese është -55% në rang qarku, e dhënë e cila tregon se kapacitetet ekzistuese janë thellësisht të pamjaftueshme për të akomoduar të gjitha kërkesat.
6. Ndërsa tabelat dhe figurat e mësipërme sjellin të dhëna të detajuara mbi shërbimet e munguara, tipologjitë dhe grupet përkatëse, analiza tregon se grupet më kritike, në kushte përjashtimi ekstrem (grupet për të cilat shkalla e plotësimi të nevojës është më e ulët se 10%) janë:
 - Të rritur me AK në Berat.
 - Të gjitha grupet në bashkitë Kuçovë me përjashtim të fëmijëve AK, Romëve dhe të Rinjve në nevojë.
 - Të gjitha grupet në Poliçan, me përjashtim të Fëmijëve AK, të Moshuarve dhe Romëve.
 - Të gjitha grupeve në Skrapar, me përjashtim të Rinjve dhe Romëve.
 - Të rriturit me AK në Dimal.

2.2. BASHKITË E QARKUT DURRËS



Qarku Durrës, me një popullsi prej 226.863 banorë⁶, përbëhet nga 3 bashki, ndër të cilat Bashkia Durrës (153.614 banorë) është bashkia më e madhe, më e zhvilluar e qarkut si edhe qendra e qarkut.

Në qarkun e Durrësit ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror 32 ofrues, nga të cilët 41% janë publikë (Tabela 1). Thuajse 66% e ofruesve ushtrojnë funksionin e tyre në bashkinë Durrës. Bashkia Shijak është bashkia me numrin më të vogël të ofruesve (2).

Tabela 1: Ofrues, Shërbime dhe Përfitues, numër


Bashkitë	Ofrues të shërbimeve			Shërbime sipas ofruesve			Përfitues sipas ofruesve		
	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej
Durrës	9	12	21	32	46	78	1.151	1.121	2.272
Shijak	2	0	2	9	0	9	128	0	128
Krujë	2	7	9	7	38	45	147	374	521
Gjithsej	13	19	32	48	84	132	1.426	1.495	2.921

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 1 sjell gjithashtu informacion edhe për numrin e shërbimeve që sigurojnë të gjithë ofruesit si edhe përfituesit e tyre. Siç edhe konstatohet, 78% e përfituesve i përkasin bashkisë Durrës.

Vlen të nënvizohet fakti se në krahasim me dy vite më parë, numri i ofruesve të shërbimeve është rritur 10% në të gjithë qarkun. Figura 1 qartësisht tregon se në Durrës dhe Shijak numri i ofruesve është rritur, ndërsa në Krujë nuk ka ndryshuar.


Figura 1 - Ofruesit e shërbimeve, numër



Burimi: Studimi, Janar 2025

Rritja e numrit të ofruesve ka ndikuar në rritjen e numrit të përfituesve të shërbimeve, me rreth 17%, rritje e cila konstatohet në çdo bashki të qarkut, edhe në ato bashki në të cilat numri i ofruesve nuk ka ndryshuar (Figura 2)


Figura 2 - Përfituesit e shërbimeve



Burimi: Studimi, Janar 2025

Faktori më thelbësor që ka ndikuar në rritjen e numrit të ofruesve si edhe të shërbimeve që ato sigurojnë, është investimi nëpërmjet fondit social. Siç tregon figura 3, fondi social ka mundësuar ngritjen e shërbimeve të reja në të gjitha bashkitë e qarkut. 12% e ofruesve (4/32 ofrues) janë pjesë e projekteve të financuara dhe mbështetura nga fondi social.

Figura 3 - Ofruesit e shërbimeve mbështetur nga fondi social kundrejt të gjithë ofruesve, 2025



Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 2 eidenton të gjithë ofruesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror sipas tipologjive të tyre, shoqëruar edhe me numrin përkatës të shërbimeve që sigurojnë si edhe me numrin përkatës të përfituesve.

Tabela 2: Ofruesit, shërbimet dhe përfituesit e përkujdesit shoqëror, sipas tipologjive të ofruesve, numër


Tipologjitë	Rezidenciale			Ditore			Komunitare			Qendra zhvillimi			Shumëdisiplinore			Strehëz emergjence			Shërbim lëvizës			Fondacione/Shoqata			Gjithsej		
	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P
Durrës	2	8	77	2	5	203	5	18	591				2	6	382	2	8	171	1	4	160	7	29	688	21	78	2.272
Shijak													1	3	20				1	6	108				2	9	128
Krujë	2	13	84	3	14	187	1	6	167													3	12	83	9	45	521
Gjithsej	4	21	161	5	19	390	6	24	758	0	0	0	3	9	402	2	8	171	2	10	268	10	41	771	32	132	2.921

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 2 konfirmon se vetëm në bashkinë Durrës funksionojnë thuajse të gjitha tipologjitë e ofruesve duke mundësuar aksesin e qytetarëve ndaj shërbimeve që ata kanë nevojë. Në bashkinë Krujë funksionojnë vetëm katër tipologji, ndërsa në bashkinë Shijak, vetëm dy tipologji ofruesish.

Figura 4 paraqit vlerat e treguesit “Shpërndarja e përfituesve për çdo shërbim, sipas tipologjive”.

Figura 4-Shpërndarja e përfituesve për çdo shërbim, sipas tipologjive



Burimi: Studimi, Janar 2025

Treguesi i mësipërm i paraqitur në figurën 4, në përputhje me përkufizimin dhe mënyrën e tij të llogaritjes, informon se:

- Bashkitë Durrës dhe Krujë ofrojnë të gjitha tipologjitë e shërbimeve, ndërsa bashkia Shijak vetëm 5 tipologji.
- Bashkia Durrës mban peshën kryesore të shërbimeve të kujdesit alternativ, të emergjencës së dhe të qendrave të zhvillimit, ndërsa dy bashkitë e tjera ndajnë përgjegjësinë për pjesën tjetër të shërbimeve.
- Bashkia Krujë, ndonëse modeste në raport me popullsinë ofron shërbime të konsiderueshme dhe të pasura, në tipologji dhe numër.

Tabela 3 plotëson kuadrin e vlerësimit të aksesit dhe përdorimit të cilësishëm të shërbimeve, nëpërmjet treguesit tjetër të integruar “Përfitues për një shërbim”, por sipas grupeve kritike, jo më sipas tipologjive të shërbimeve.

Kjo tabelë tregon se:

- Në bashkinë Krujë marrin shërbime të gjitha grupet me përjashtim të të Rinjve në nevojë, ndërsa në Durrës nuk marrin shërbime të Rinjtë dhe të Rriturit AK. Në Shijak vetëm dy grupe marrin shërbime.
- Në Durrës dhe Krujë, mesatarisht 30-32 të moshuar dhe romë përfitojnë 1 shërbim.
- Ndërmjet numrit mesatar për një shërbim të individëve në nevojë, të fëmijëve jashtë kujdesit prindëror dhe të fëmijëve AK në bashkitë Durrës dhe Krujë ekziston një diferencë e thellë. Ky numër është rreth 6 herë më i madh në bashkinë Durrës se sa në bashkinë Krujë.

Tabela 3: Përfitues për një shërbim në çdo bashki

Durrës	Individë përfitues për një shërbim në çdo bashki		
	Durrës	Shijak	Krujë
Individë në nevojë	48	0	13
Fëmijë jashtë kujdesit	17	0	3
Fëmijë AK	18	10	3
Të rritur AK	0	23	8
Të rinj në nevojë	0	0	0
Gra në nevojë	7	0	5
Romë dhe Egjiptianë	32	0	30
Të moshuar	31	0	31

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabelat 4 deri 6 përmbajnë vlerat e tre treguesve të ndërtuar për qëllim të këtij vlerësimi, përkatësisht Shkallës së plotësimit të nevojës për shërbime në çdo bashki të qarkut; Shkallën e plotësimit të aplikimeve për çdo bashki; Koeficientin e Mjaftueshmërisë Akomoduese për çdo bashki. Sipas të dhënave të tabelave 4 deri 6 rezultojnë se:

Bashkia Durrës ka shkallën më të lartë të plotësimit të nevojave për shërbime, në masën 25%, e pasuar nga bashkia Krujë, 23% dhe në fund, bashkia Shijak, 13%.

Bashkia Krujë paraqitet me shkallën më të lartë të plotësimit të aplikimeve, 90%, e pasuar nga bashkia Durrës, 70% dhe në fund bashkia Shijak, 58%.

KMA paraqitet në vlera pozitive për 4 nga 6 grupet për të cilat bashkia Durrës ofron shërbime; Për 4 nga 7 grupet e trajtuara në bashkinë Krujë, ndërsa për dy grupe vlera është zero, që do të thotë se përfituesit dhe kapacitetet janë të barabarta; Për të gjitha grupet me përjashtim të individëve me AK, në bashkinë Shijak nuk ka asnjë kapacitet.

Tabela 4: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Durrës

Durrës	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	771	1140	1.293	181	63%	88%	-13%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	113	214	203	19	64%	91%	5%
Fëmijë me aftësi të kufizuar	746	385	383	70	34%	85%	1%
Të rritur me aftësi të kufizuar	3.522	0	0	178	0%	0%	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	243	0	0	243	0%	0%	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	99	110	50	78	34%	39%	55%
Të moshuar	358	160	189	179	35%	51%	-18%
Romë dhe Egjiptianë	56	210	154	56	73%	73%	27%
Gjithsej	5.908	2.219	2.272	1.004	28%	69%	-2%

Burimi: Studimi, Janar 2025



Tabela 5: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Shijak

Shijak	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	211	0	0	85	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	6	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	112	90	58	0	34%	100%	36%
Të rritur me aftësi të kufizuar	500	70	70	0	12%	100%	0%
Të rinj në kushte kritike	5	0	0	5	0%	0%	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	3	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të moshuar	6	0	0	3	0%	0%	S'ka kapacitet
Romë dhe Egjiptianë	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gjithsej	843	160	128	93	13%	58%	20%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 6: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Krujë

Krujë	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	1.325	160	154	30	10%	84%	4%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	16	15	10	0	38%	100%	33%
Fëmijë me aftësi të kufizuar	259	51	25	5	9%	83%	51%
Të rritur me aftësi të kufizuar	274	55	55	12	17%	82%	0%
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	57	30	30	2	34%	94%	0%
Të moshuar	0	200	60	0	100%	100%	70%
Romë dhe Egjiptianë	8	50	187	8	96%	96%	-274%
Gjithsej	1.939	561	521	57	21%	90%	7%

Burimi: Studimi, Janar 2025

2.2.1. Vlerësim përmbledhës për bashkitë e qarkut Durrës

- Me një popullsi 226.863 banorë, qarku Durrës është qarku i katërt më i populluar i vendit, i përbërë nga 3 bashki.
- Pavarësisht rritjes së numrit të ofruesve, të shërbimeve dhe të përfituesve në vijimësi, nevoja për shërbime të përkujdesit shoqëror është e evidente.
- Janë 8,690 individë në nevojë në qarkun e Durrësit, ndërsa përfitues të shërbimeve janë vetëm 2,921 individë, ose 25% e nevojës plotësohet me shërbime.
- 72% e aplikantëve për shërbime arrijnë të përfitojnë shërbimet e kërkuara.

- Koeficienti i Mjaftueshmërisë Akomoduese është 1% në rang qarku, e dhënë e cila tregon se kapacitetet ekzistuese janë thuajse të kompletuara.
- Ndërsa tabelat dhe figurat e mësipërme sjellin të dhëna të detajuara mbi shërbimet e munguara, tipologjitë dhe grupet përkatëse, analiza tregon se grupet më kritike, në kushte përjashtimi ekstrem (grupet për të cilat shkalla e plotësimit të nevojës është më e ulët se 10%) janë:
 - Të rriturit me AK dhe të Rinjtë në nevojë në bashkinë Durrës.
 - Të gjitha grupet, me përjashtim të fëmijëve me AK në bashkinë Shijak.
 - Fëmijët me AK në Krujë.

2.3. BASHKITË E QARKUT DIBËR

Qarku Dibër, me një popullsi prej 107.18 banorë⁷, përbëhet nga 4 bashki, ndër të cilat Bashkia Dibër (50.775 banorë) është bashkia më e madhe e qarkut.

Në qarkun e Dibrës ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror 15 ofrues, nga të cilët 65% janë publikë (Tabela 1). Mëse 50% e ofruesve ushtrojnë funksionin e tyre në bashkinë Dibër. Bashkitë Bulqizë e Klos janë bashkitë me numrin më të vogël të ofruesve (1).

Tabela 1: Ofrues, Shërbime dhe Përfitues, numër


Bashkitë	Ofrues të shërbimeve			Shërbime sipas ofruesve			Përfitues sipas ofruesve		
	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej
Dibër	6	2	8	16	6	22	212	38	250
Bulqizë	1	0	1	5	0	5	17	0	17
Klos	1	0	1	9	0	9	66	0	66
Mat	2	3	5	7	12	19	120	91	211
Gjithsej	10	5	15	37	18	55	415	129	544

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 1 sjell gjithashtu informacion edhe për numrin e shërbimeve që sigurojnë të gjithë ofruesit si edhe përfituesit e tyre. Siç edhe konstatohet, 46% e përfituesve i përkasin bashkisë Dibër.

Vlen të nënvizohet fakti se në krahasim me dy vite më parë, numri i ofruesve të shërbimeve është rritur 7% në të gjithë qarkun, sepse është shtuar vetëm një shërbim në bashkinë Dibër, ndërsa në bashkitë e tjera numri i ofruesve është i njëjtë (figura 1).


Figura 1 - Ofruesit e shërbimeve, numër



Burimi: Studimi, Janar 2025

Ndonëse numri i ofruesve nuk është rritur ndjeshëm, numri i përfituesve është rritur 17%, rritje e cila konstatohet në bashkinë Dibër dhe Klos, ndërsa numri i përfituesve në Mat është zvogëluar (Figura 2).


Figura 2 - Përfituesit e shërbimeve



Burimi: Studimi, Janar 2025

Faktori më domethënës, me ndikim në rritjen e aksesit të qytetarëve ndaj shërbimeve të përkujdesit shoqëror është investimi nëpërmjet fondit social. Siç tregon figura 3, në të gjitha bashkitë e qarkut fondi social ka mundësuar ngritjen e shërbimeve të reja. 26% e ofruesve (4/15 ofrues) janë pjesë e projekteve të financuara dhe mbështetura nga fondi social.

Figura 3 - Ofruesit e shërbimeve mbështetur nga fondi social kundrejt të gjithë ofruesve, 2025



Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 2 evidenton të gjithë ofruesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror sipas tipologjive të tyre, shoqëruar edhe me numrin përkatës të shërbimeve që sigurojnë si edhe me numrin përkatës të përfituesve.

Tabela 2: Ofruesit, shërbimet dhe përfituesit e përkujdesit shoqëror, sipas tipologjive të ofruesve, numër


Tipologjitë	Rezidenciale			Ditore			Komunitare			Qendra zhvillimi			Shumëdisiplinore			Strehëz emergjence			Shërbim lëvizës			Fondacione/Shoqata			Gjithsej		
	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P
Dibër				1	9	40	3	4	153							1			1	3	19	2	6	38	8	22	250
Bulqizë							1	5	17																1	5	17
Klos																			1	9	66				1	9	66
Mat				3	9	181	1	5	30													1	5		5	19	211
Gjithsej	0	0	0	4	18	221	5	14	200	0	0	0	0	0	0	1	0	0	2	12	85	3	11	38	15	55	544

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 2 konfirmon se bashkitë e qarkut Dibër janë të varfëra në tipologji ofruesish. Në bashkinë Dibër funksionojnë 4 tipologji, në bashkinë Mat tre tipologji, ndërsa në bashkitë e tjera vetëm një tipologji.

Figura 4 paraqit vlerat e treguesit “Shpërndarja e përfituesve për çdo shërbim, sipas tipologjive”.

Figura 4-Shpërndarja e përfituesve për çdo shërbim, sipas tipologjive



Burimi: Studimi, Janar 2025

Treguesi i mësipërm i paraqitur në figurën 4, në përputhje me përkufizimin dhe mënyrën e tij të llogaritjes, informon se:

- Dy tipologji shërbimesh nuk ofrohen në asnjë nga bashkitë e qarkut.
- Bashkia Dibër ofron 9 nga 11 tipologji. Bashkia Mat ofron 7 nga 11 tipologji, Bashkia Bulqizë ofron 5 dhe bashkia Klos vetëm 4 tipologji, e kështu për të gjitha bashkitë.
- Shërbimet parashoqërore dhe të specializuara ofrohen në çdo bashki;
- Bashkia Dibër ofron 100% të shërbimit të strehëzave, 50% të shërbimeve të këshillimit, shërbimeve në familje, qendrave të zhvillimit, komunitare etj.
- Bashkitë e tjera ofrojnë pjesë më të vogël të shërbimeve.

Tabela 3 plotëson kuadrin e vlerësimit të aksesit dhe përdorimit të cilësishëm të shërbimeve, nëpërmjet treguesit tjetër të integruar “Përfitues për një shërbim”, por sipas grupeve kritike, jo më sipas tipologjive të shërbimeve.

Kjo tabelë tregon se:

- Në bashkinë Dibër dhe Mat marrin shërbime vetëm 4 grupe, ndërsa në dy bashkitë e tjera përkatësisht 3 grupe dhe një grup.
- Numri mesatar i përfituesve për një shërbim është thujse proporcional në të gjitha bashkitë e për të gjitha grupet, me përjashtim të të Rinjve në nevojë.

Tabela 3: Përfitues për një shërbim në çdo bashki

Dibër	Individë përfitues për një shërbim në çdo bashki			
	Dibër	Bulqizë	Klos	Mat
Individë në nevojë	0	0	0	12
Fëmijë jashtë kujdesit	0	0	0	0
Fëmijë AK	8	3	10	7
Të rritur AK	0	0	4	3
Të rinj në nevojë	25	0	0	0
Gra në nevojë	6	0	0	0
Romë dhe Egjiptianë	0	0	0	0
Të moshuar	13	0	9	22

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabelat 4 deri 7 përmbajnë vlerat e tre treguesve të ndërtuar për qëllim të këtij vlerësimi, përkatësisht Shkallës së plotësimit të nevojës për shërbime në çdo bashki të qarkut; Shkallën e plotësimit të aplikimeve për çdo bashki; Koeficientin e Mjaftueshmërisë Akomoduese për çdo bashki. Sipas të dhënave të tabelave 4 deri 7 rezulton se në të katër bashkitë e qarkut, shkalla e plotësimit të nevojave është tejet e ulët, 1 deri 3%, gjë e cila lidhet dhe kushtëzohet tërësisht nga niveli i lartë i varfërisë në qark si edhe numri relativisht i ulët i shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Bashkia Dibër karakterizohet nga shkalla më e lartë e plotësimit të aplikimeve, 54%, gjithsesi kjo nuk ka ndonjë domethënie të veçantë në kontekstin e shkallës tepër të ulët të plotësimit të nevojave.

KMA paraqitet në vlera negative ose jo ekzistente për pjesën më të madhe të grupeve në të gjitha bashkitë, me përjashtim të grupit “Fëmijë me AK” (Bulqizë, Mat, Klos) si edhe “Gra në kushte kritike” (Bashkia Dibër) për të cilat vlerat e KMA janë pozitive. Ky nuk është një përfundim i papritur sepse kapacitetet e shërbimeve në këtë qark janë mjaft të kufizuara.

Tabela 4: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Dibër

Dibër	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	18.854	0	0	100	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	11	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	988	69	72	104	7%	41%	-4%
Të rritur me aftësi të kufizuar	1.819	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	0	100	100	0	100%	100%	0%
Gra në kushte kritike	311	47	38	7	11%	84%	19%
Të moshuar	0	40	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	100%
Romë dhe Egjiptianë	0	0	40	0	100%	100%	S'ka kapacitet
Gjithsej	21.983	256	250	211	1%	54%	2%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 5: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Bulqizë

Bulqizë	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	3.924	0	0	25	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	11	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	189	25	17	0	8%	100%	32%
Të rritur me aftësi të kufizuar	736	0	0	8	0%	0%	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	4	0	0	4	0%	0%	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	430	0	0	1	0%	0%	S'ka kapacitet
Të moshuar	10	0	0	5	0%	0%	S'ka kapacitet
Romë dhe Egjiptianë	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gjithsej	5.304	25	17	43	0%	28%	32%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 6: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Klos

Klos	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	5.805	0	0	354	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	180	30	29	4	14%	88%	3%
Të rritur me aftësi të kufizuar	1.385	10	11	0	1%	100%	-10%
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	160	0	0	1	0%	0%	S'ka kapacitet
Të moshuar	24	20	0	12	0%	0%	100%
Romë dhe Egjiptianë	0	0	26	0	100%	100%	S'ka kapacitet
Gjithsej	7.554	60	66	371	1%	15%	-10%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 7: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Mat

Mat	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	4.050	55	49	160	1%	23%	11%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	8	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	152	40	36	15	19%	71%	10%
Të rritur me aftësi të kufizuar	1.537	20	16	43	1%	27%	20%
Të rinj në kushte kritike	56	0	0	56	0%	0%	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	110	0	0	7	0%	0%	S'ka kapacitet
Të moshuar	80	110	0	40	0%	0%	100%
Romë dhe Egjiptianë	12	0	110	12	90%	90%	S'ka kapacitet
Gjithsej	6.005	225	211	333	3%	39%	6%

Burimi: Studimi, Janar 2025


2.3.1. Vlerësim përmbledhës për bashkitë e qarkut Dibër

- Me një popullsi 107.178, qarku Dibër, i përbërë nga 4 bashki, është qarku më i populluar i zonës verilindore, ndonëse një nga qarqet më të varfëra të vendit.
- Nevoja për shërbime të përkujdesit shoqëror është tejet kritike.
- Janë 40,846 individë në nevojë në qarkun e Dibrës, ndërsa përfitues të shërbimeve janë vetëm 544 individë, ose vetëm 1% e nevojës plotësohet me shërbime.
- 36% e aplikantëve për shërbime arrijnë të përfitojnë shërbimet e kërkuara.
- Koeficienti i Mjaftueshmërisë Akomoduese është 4% në rang qarku, e dhënë e cila tregon se kapacitetet ekzistuese janë thujtë të plotësuara me përfitues, ndërsa nevoja për shërbime është tejet e lartë.
- Ndërsa tabelat dhe figurat e mësipërme sjellin të dhëna të detajuara mbi shërbimet e munguara, tipologjitë dhe grupet përkatëse, analiza tregon se grupet më kritike, në kushte përjashtimi ekstrem (grupet për të cilat shkalla e plotësimit të nevojës është më e ulët se 10%) janë:
 - Të rriturit me AK, Individë në nevojë ekonomike, Fëmijët jashtë kujdesit prindëror, në çdo bashki.
 - Gra në nevojë, të Moshuar dhe të Rinj në nevojë, në çdo bashki përveç bashkisë Dibër.
 - Fëmijët me AK në Dibër dhe Bulqizë.



2.4. BASHKITË E QARKUT ELBASAN

Qarku Elbasan, me një popullsi prej 232.580 banorë⁸, përbëhet nga 7 bashki, ndër të cilat Bashkia Elbasan(115.101 banorë) është bashkia më e madhe, më e zhvilluar e qarkut si edhe qendra e qarkut.



Në qarkun e Elbasanit ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror 36 ofrues, nga të cilët rreth 40% janë publikë (Tabela 1). Thuajse 60% e ofruesve ushtrojnë funksionin e tyre në bashkinë Elbasan. Bashkia Belsh është bashkia me numrin më të vogël të ofruesve (1), ndërsa në bashkitë e tjera ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror 2 deri 4 ofrues.

Tabela 1: Ofrues, Shërbime dhe Përfitues, numër


Bashkitë	Ofrues të shërbimeve			Shërbime sipas ofruesve			Përfitues sipas ofruesve		
	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej
Elbasan	5	16	21	26	75	101	767	781	1.548
Cërrik	1	2	3	6	13	19	101	70	171
Belsh	1	0	1	8	0	8	60	0	60
Peqin	1	1	2	3	8	11	13	18	31
Gramsh	3	1	4	9	3	12	32	40	72
Librazhd	1	2	3	12	7	19	97	91	188
Prrrenjas	2	0	2	9	0	9	124	0	124
Gjithsej	14	22	36	73	106	179	1.194	1.000	2.194

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 1 sjell gjithashtu informacion edhe për numrin e shërbimeve që sigurojnë të gjithë ofruesit si edhe përfituesit e tyre. Siç edhe konstatohet, 70% e përfituesve i përkasin bashkisë Elbasan.

Vlen të nënvizohet fakti se në krahasim me dy vite më parë, numri i ofruesve të shërbimeve është rritur 25% në të gjithë qarkun. Figura 1 qartësisht tregon se në çdo bashki të qarkut , me përjashtim të bashkisë Belsh dhe Prrrenjas, numri i ofruesve është rritur.


Figura 1 - Ofruesit e shërbimeve, numër



Burimi: Studimi, Janar 2025

Rritja e numrit të ofruesve ka ndikuar në rritjen e numrit të përfituesve të shërbimeve, me rreth 18%, rritje e cila konstatohet në çdo bashki të qarkut, edhe në ato bashki në të cilat numri i ofruesve nuk ka ndryshuar (Figura 2)


Figura 2 - Përfituesit e shërbimeve



Burimi: Studimi, Janar 2025

Faktori më thelbësor që ka ndikuar në rritjen e numrit të ofruesve si edhe të shërbimeve që ato sigurojnë, është investimi nëpërmjet fondit social. Siç tregon figura 3, me përjashtim të bashkisë Peqin, fondi social ka mundësuar ngritjen e shërbimeve të reja në të gjitha bashkitë e qarkut. 1/3 e ofruesve (12/36 ofrues) janë pjesë e projekteve të financuara dhe mbështetura nga fondi social.

Figura 3 - Ofruesit e shërbimeve mbështetur nga fondi social kundrejt të gjithë ofruesve, 2025



Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 2 evidenton të gjithë ofruesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror sipas tipologjive të tyre, shoqëruar edhe me numrin përkatës të shërbimeve që sigurojnë si edhe me numrin përkatës të përfituesve.

Tabela 2: Ofruesit, shërbimet dhe përfituesit e përkujdesit shoqëror, sipas tipologjive të ofruesve, numër


Tipologjitë	Rezidenciale			Ditore			Komunitare			Qendra zhvillimi			Shumëdisiplinore			Strehëz emergjence			Shërbim lëvizës			Fondacione/Shoqata			Gjithsej		
	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P
Elbasan	3	10	52	5	29	748	3	13	157	3	12	128	3	15	287	2	16	92	1	4	70	1	2	14	21	101	1.548
Cërrik	1	8	8	1	5	62							1	6	101										3	19	171
Belsh													1	8	60										1	8	60
Peqin				1	8	18				1	3	13													2	11	31
Gramsh				3	9	58													1	3	14				4	12	72
Librazhd				2	14	127							1	5	61										3	19	188
Prrenjas				1	3	50	1	6	74																2	9	124
Gjithsej	4	18	60	13	68	1.063	4	19	231	4	15	141	6	34	509	2	16	92	2	7	84	1	2	14	36	179	2.194

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 2 konfirmon se vetëm në bashkinë Elbasan funksionojnë të gjitha tipologjitë e ofruesve duke mundësuar të gjitha tipologjitë e shërbimeve dhe rritur mundësinë e qytetarëve për të aksesuar shërbimet që ata kanë nevojë. Në bashkinë Cërrik ofrojnë shërbime ofrues të tre tipologjive, në bashkitë Peqin, Gramsh, Librazhd dhe Prrenjas, vetëm dy, ndërsa në bashkinë Belsh vetëm një tipologji, tipologjia e “Ofruesit shumë disiplinor”.

Figura 4 paraqit vlerat e treguesit “Shpërndarja e përfituesve për çdo shërbim, sipas tipologjive”.

Figura 4-Shpërndarja e përfituesve për çdo shërbim, sipas tipologjive



Burimi: Studimi, Janar 2025

Treguesi i mësipërm i paraqitur në figurën 4, në përputhje me përkufizimin dhe mënyrën e tij të llogaritjes, informon se:

- Bashkia Elbasan ofron të gjitha tipologjitë e shërbimeve, Bashkia Cërrik ofron 8 nga 11 tipologji, Bashkia Belsh ofron vetëm 4 tipologji, e kështu për të gjitha bashkitë.
- Shërbimet parashoqërore ofrohen në çdo bashki; Kujdesi alternativ ofrohet vetëm në Elbasan dhe Cërrik; Shërbime rezidenciale ofrohen gjithashtu vetëm në Elbasan dhe Cërrik, dhe kështu vijon për të gjitha bashkitë.

- Bashkia Elbasan ofron 90% të shërbimit të kujdesit alternativ të të gjithë qarkut, 20% të shërbimeve të emergjencës, 50% të këshillimit etj. Bashkia Belsh ofron 20% të shërbimeve të emergjencës, 10% të qendrave ditore, 15% të shërbimeve parashoqërore; etj.

Tabela 3 plotëson kuadrin e vlerësimit të aksesit dhe përdorimit të cilësishëm të shërbimeve, nëpërmjet treguesit tjetër të integruar “Përfitues për një shërbim”, por sipas grupeve kritike, jo më sipas tipologjive të shërbimeve.

Kjo tabelë tregon se:

- Në bashkinë Elbasan marrin shërbime të gjitha grupet. Në Cërrik vetëm 4 grupe marrin shërbime. Në Belsh vetëm 3 grupe, etj.
- Në Elbasan, 49 të moshuar përfitojnë mesatarisht një shërbim, ndërsa vetëm 7 të rinj në nevojë përfitojnë një shërbim. Arsyeja mund të lidhet me nevojën, mundësinë, kapacitetet ose koston e ndryshme. Sidoqoftë, intervale të theksuara ndërmjet vlerave maksimale dhe minimale duhet të shërbejnë për hulumtime më të thelluara.
- Ndërmjet grupit të përftuesve “të moshuar për një shërbim” në Elbasan, Belsh, Prrenjas dhe Librazhd ekziston një diferencë e thellë. Numri i përftuesve të moshuar në Elbasan është rreth 5 herë më i lartë se sa numri i përftuesve për një shërbim në Librazhd. Pavarësisht faktorit “Popullsi”, kjo diferencë duhet të nxisë debate në lidhje me standartet e cilësisë së shërbimeve si edhe standartet e ngarkesës së stafit pa cenuar cilësinë e shërbimeve.

Tabela 3: Përfitues për një shërbim në çdo bashki

Elbasan	Individë përfitues për një shërbim në çdo bashki						
	Elbasan	Cërrik	Belsh	Peqin	Gramsh	Librazhd	Prrenjas
Individë në nevojë	12	5	0	0	0	0	0
Fëmijë jashtë kujdesit	8	1	0	0	4	15	12
Fëmijë AK	11	0	1	4	3	3	0
Të rritur AK	12	0	2	0	0	0	0
Të rinj në nevojë	7	13	0	0	0	0	0
Gra në nevojë	10	0	0	0	0	0	0
Romë dhe Egjiptianë	19	12	0	2	13	8	17
Të moshuar	49	0	17	0	0	10	14

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabelat 4 deri 10 përmbajnë vlerat e tre treguesve të ndërtuar për qëllim të këtij vlerësimi, përkatësisht Shkallës së plotësimit të nevojës për shërbime në çdo bashki të qarkut; Shkallën e plotësimit të aplikimeve për çdo bashki; Koeficientin e Mjaftueshmërisë Akomoduese për çdo bashki. Sipas të dhënave të tabelave 4 deri 10 rezultojnë se:

Bashkia Elbasan ka shkallën më të lartë të plotësimit të nevojave për shërbime, në masën 7%, e pasuar nga bashkia Cërrik, në masën 4%, ndërsa tek bashkitë e tjera kjo shifër lëkundet ndërmjet 1 dhe 2%.

Bashkia Prrenjas ka shkallën më të lartë të plotësimit të aplikimeve, 76% ndërsa bashkia Peqin ka shkallën më të ulët, 8%.

KMA paraqitet në vlera pozitive për 7 nga 8 grupet kritike në bashkinë Elbasan; Për 2 nga 3 grupet e trajtuara në bashkinë Cërrik (për grupin kritik të “Individëve në nevojë” në bashkinë Cërrik nuk ka kapacitete ofrimi shërbime); Për një grup nga 3 të trajtuara në Belsh; Për 1 nga 2 grupe në Peqin dhe Prrenjas; Për 1 nga 3 grupe në Librazhd dhe për 2 nga 3 grupe në Gramsh.

Tabela 4: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Elbasan



Elbasan	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	10.825	560	272	268	2%	50%	51%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	97	60	54	47	36%	53%	10%
Fëmijë me aftësi të kufizuar	925	263	242	42	21%	85%	8%
Të rritur me aftësi të kufizuar	7.904	24	23	52	0%	31%	4%
Të rinj në kushte kritike	187	125	98	187	34%	34%	22%
Gra në kushte kritike	611	145	93	147	13%	39%	36%
Të moshuar	928	580	227	464	20%	33%	61%
Romë dhe Egjiptianë	240	130	539	240	69%	69%	-315%
Gjithsej	21.717	1.887	1.548	1.447	7%	52%	18%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 5: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Cërrik

Cërrik	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	2.141	16	16	47	1%	25%	0%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	4	10	5	0	56%	100%	50%
Fëmijë me aftësi të kufizuar	139	0	0	7	0%	0%	S'ka kapacitet
Të rritur me aftësi të kufizuar	1.195	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	61	100	88	61	59%	59%	12%
Gra në kushte kritike	71	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të moshuar	56	0	62	28	53%	69%	S'ka kapacitet
Romë dhe Egjiptianë	0	100	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	100%
Gjithsej	3.667	226	171	143	4%	54%	24%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 6: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Belsh

Belsh	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	1.730	0	0	50	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	4	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	12	0	1	0	8%	100%	S'ka kapacitet
Të rritur me aftësi të kufizuar	1.123	8	7	60	1%	10%	13%
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	12	0	0	6	0%	0%	S'ka kapacitet
Të moshuar	100	52	0	50	0%	0%	100%
Romë dhe Egjiptianë	0	0	52	0	100%	100%	S'ka kapacitet
Gjithsej	2.981	60	60	166	2%	27%	0%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 7: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Peqin

Peqin	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	4.342	0	0	68	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	8	0	0	3	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	208	15	13	16	6%	45%	13%
Të rritur me aftësi të kufizuar	1.072	0	0	117	0%	0%	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	11	0	0	11	0%	0%	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	157	0	0	38	0%	0%	S'ka kapacitet
Të moshuar	158	0	18	79	10%	19%	S'ka kapacitet
Romë dhe Egjiptianë	10	20	0	10	0%	0%	100%
Gjithsej	5.966	35	31	342	1%	8%	11%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 8: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Gramsh

Gramsh	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	5.194	0	0	120	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	18	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	218	44	24	35	10%	41%	45%
Të rritur me aftësi të kufizuar	1.219	25	8	5	1%	62%	68%
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	217	0	0	2	0%	0%	S'ka kapacitet
Të moshuar	50	50	0	25	0%	0%	100%
Romë dhe Egjiptianë	0	0	40	0	100%	100%	S'ka kapacitet
Gjithsej	6.916	119	72	187	1%	28%	39%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 9: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Librazhd

Librazhd	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	6.538	0	0	95	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	9	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	218	100	145	27	40%	84%	-45%
Të rritur me aftësi të kufizuar	1.047	20	13	39	1%	25%	35%
Të rinj në kushte kritike	67	0	0	67	0%	0%	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	266	0	0	15	0%	0%	S'ka kapacitet
Të moshuar	98	40	0	49	0%	0%	100%
Romë dhe Egjiptianë	0	0	30	0	100%	100%	S'ka kapacitet
Gjithsej	8.243	160	188	292	2%	39%	-18%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 10: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Prrenjas

Prrenjas	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	5.951	0	0	23	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	1	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	448	180	74	3	14%	96%	59%
Të rritur me aftësi të kufizuar	744	0	0	6	0%	0%	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	143	0	0	3	0%	0%	S'ka kapacitet
Të moshuar	8	50	0	4	0%	0%	100%
Romë dhe Egjiptianë	0	0	50	0	100%	100%	S'ka kapacitet
Gjithsej	7.295	230	124	39	2%	76%	46%

Burimi: Studimi, Janar 2025

2.4.1. Vlerësim përmbledhës për bashkitë e qarkut Elbasan

- Me një popullsi 232.580 banorë, qarku Elbasan është qarku i tretë më i populluar i vendit, i përbërë nga 7 bashki.
- Pavarësisht rritjes së numrit të ofruesve, të shërbimeve dhe të përfituesve në vijimësi, nevoja për shërbime të përkujdesit shoqëror është evidente.
- Janë 56,785 individë në nevojë në qarkun e Elbasanit, ndërsa përfitues të shërbimeve janë vetëm 2,194 individë, ose vetëm 4% e nevojës plotësohet me shërbime.
- 46% e aplikantëve për shërbime arrijnë të përfitojnë shërbimet e kërkuara.
- Koeficienti i Mjaftueshmërisë Akomoduese është 19% në rang qarku, e dhënë e cila tregon se kapacitetet ekzistuese janë të mjaftueshme për të akomoduar edhe 19% të kërkesave.

6. Ndërsa tabelat dhe figurat e mësipërme sjellin të dhëna të detajuara mbi shërbimet e munguara, tipologjitë dhe grupet përkatëse, analiza tregon se grupet më kritike, në kushte përjashtimi ekstrem (grupet për të cilat shkalla e plotësimit të nevojës është më e ulët se 10%) janë:
- Të rriturit me AK në çdo bashki
 - Individë në nevojë ekonomike në çdo bashki
 - Gra në nevojë, në çdo bashki përveç bashkisë Elbasan.
 - Fëmijët me AK në Belsh, Cërrik, Peqin, Librazhd, Prrenjas.
 - Fëmijët jashtë kujdesit prindëror në Prrenjas, Librazhd, Gramsh, Peqin dhe Belsh.
 - Të moshuarit në Prrenjas, Librazhd, Gramsh dhe Belsh.
 - Të Rinjtë në Librazhd dhe Peqin.

2.5. BASHKITË E QARKUT FIER

Qarku Fier, me një popullsi prej 240.377 banorë⁹, përbëhet nga 6 bashki, ndër të cilat Bashkia Fierit(101.963 banorë) është bashkia më e madhe, më e zhvilluar e qarkut si edhe qendra e qarkut.

Në qarkun e Fierit ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror 29 ofrues, nga të cilët 62% janë publikë (Tabela 1). Thuajse 30% e ofruesve ushtrojnë funksionin e tyre në bashkinë Fier, rreth 45% në bashkinë Lushnje dhe pjesa tjetër në katër bashkitë e tjera. Në bashkitë Mallakastër dhe Divjakë ofrojnë shërbime vetëm nga një ofrues.

Tabela 1: Ofrues, Shërbime dhe Përfitues, numër


Bashkitë	Ofrues të shërbimeve			Shërbime sipas ofruesve			Përfitues sipas ofruesve		
	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej
Fier	4	4	8	21	10	31	427	311	738
Patos	2	0	2	8	0	8	80	0	80
Roskovec	4	0	4	17	0	17	73	0	73
Lushnje	6	7	13	24	15	39	660	803	1.463
Mallakastër	1	0	1	5	0	5	46	0	46
Divjakë	1	0	1	4	0	4	100	0	100
Gjithsej	18	11	29	79	25	104	1.386	1.114	2.500

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 1 sjell gjithashtu informacion edhe për numrin e shërbimeve që sigurojnë të gjithë ofruesit si edhe përfituesit e tyre. Siç edhe konstatohet, 30% e përfituesve i përkasin bashkisë Fier, mëse 50% bashkisë Lushnje, ndërsa pjesa tjetër e përfituesve i përket katër bashkive të tjera.

Vlen të nënvizohet fakti se në krahasim me dy vite më parë, numri i ofruesve të shërbimeve është rritur 16% në të gjithë qarkun. Figura 1 tregon se në Patos, Roskovec dhe Lushnje numri i ofruesve është rritur, ndërsa në Fier, Mallakastër dhe Divjakë, nuk ka ndryshuar.


Figura 1 - Ofruesit e shërbimeve, numër



Burimi: Studimi, Janar 2025

Rritja e numrit të ofruesve ka ndikuar në rritjen e numrit të përfituesve të shërbimeve, me rreth 40%, rritje e cila konstatohet në çdo bashki të qarkut, edhe në ato bashki në të cilat numri i ofruesve nuk ka ndryshuar (Figura 2)


Figura 2 - Përfituesit e shërbimeve



Burimi: Studimi, Janar 2025

Faktori më thelbësor që ka ndikuar në rritjen e numrit të ofruesve si edhe të shërbimeve që ato sigurojnë, është investimi nëpërmjet fondit social. Siç tregon figura 3, me përjashtim të bashkisë Mallakastër, fondi social ka mundësuar ngritjen e shërbimeve të reja në të gjitha bashkitë e qarkut. 30% e ofruesve (9/29 ofrues) janë pjesë e projekteve të financuara dhe mbështetura nga fondi social.

Figura 3 - Ofruesit e shërbimeve mbështetur nga fondi social kundrejt të gjithë ofruesve, 2025



Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 2 evidenton të gjithë ofruesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror sipas tipologjive të tyre, shoqëruar edhe me numrin përkatës të shërbimeve që sigurojnë si edhe me numrin përkatës të përfituesve.

Tabela 2: Ofruesit, shërbimet dhe përfituesit e përkujdesit shoqëror, sipas tipologjive të ofruesve, numër.


Tipologjitë	Rezidenciale			Ditore			Komunitare			Qendra zhvillimi			Shumëdisiplinore			Strehëz emergjence			Shërbim lëvizës			Fondacione/Shoqata			Gjithsej		
	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P
Fier	1	4	55				4	16	489				1	4	100	1	4		1	3	94				8	31	738
Patos													1	4	21				1	4	59				2	8	80
Roskovec				1	3	25	1	8	23							1	4		1	2	25				4	17	73
Lushnje				1	3	35	5	15	306				2	8	440	1	5		1	3	100	3	5	582	13	39	1.463
Mallakastër													1	5	46										1	5	46
Divjakë													1	4	100										1	4	100
Gjithsej	1	4	55	2	6	60	10	39	818	0	0	0	6	25	707	3	13	0	4	12	278	3	5	582	29	104	2.500

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 2 konfirmon se vetëm në bashkinë Lushnje funksionojnë 6 nga 8 tipologjitë e ofruesve, në Fier 5 nga 8, në Roskovec 4 nga 8, ndërsa tek të tjerat 1 ose 2 tipologji ofruesish.

Figura 4 paraqit vlerat e treguesit “Shpërndarja e përfituesve për çdo shërbim, sipas tipologjive”.

Figura 4-Shpërndarja e përfituesve për çdo shërbim, sipas tipologjive



Burimi: Studimi, Janar 2025

Treguesi i mësipërm i paraqitur në figurën 4, në përputhje me përkufizimin dhe mënyrën e tij të llogaritjes, informon se:

- Bashkia Lushnje ofron 9 tipologji, Fieri ofron 8 tipologji shërbimesh, bashkia Patos ofron 6, ndërsa të tjerat ofrojnë një numër tepër të kufizuar tipologjish të shërbimeve.
- Shërbimet rezidenciale ofrohen vetëm në bashkinë Fier, e cila mbulon 100% të këtij shërbimi në rang qarku. Bashkia Fier gjithashtu siguron 60% të shërbimeve të qendrave të zhvillimit, 50% të atyre të specializuara, si edhe të shërbimeve të tjera.
- Shërbimet e Kujdesit Alternativ nuk ofrohen në asnjë bashki të qarkut.

- Bashkia Lushnje gjithashtu mbulon një gamë të konsiderueshme të tipologjive të shërbimeve, përkatësisht 100% strehëza, 85% të qendrave ditore, 60% të shërbimeve në familje, etj.

Tabela 3 plotëson kuadrin e vlerësimit të aksesit dhe përdorimit të cilësishëm të shërbimeve, nëpërmjet treguesit tjetër të integruar “Përfitues për një shërbim”, por sipas grupeve kritike, jo më sipas tipologjive të shërbimeve.


Kjo tabelë tregon se:

- Në bashkinë Lushnje marrin shërbime 6 grupe nga 8, në bashkie Fier 5 grupe në nevojë nga 8, në bashkitë e tjera ky numër qëndron ndërmjet 2 dhe 3 grupe në envojë.
- Treguesit e numrit mesatar të përfituesve për një shërbim variojnë në vlera, në bashki të ndryshme dhe në grupe të ndryshme. Kështu, numri mesatar për një shërbim i të Rriturve me AK në bashkinë Lushnje është 164 përfitues, një numër jashtëzakonisht i lartë.
- Numri mesatar i përfituesve të “Moshuar” për një shërbim është thujasë i njëjtë në bashkitë Fier, Roskovec, Lushnje, Divjakë, në të gjitha bashkitë në të cilat ky shërbim ofrohet.
- Ndërmjet grupit të përfituesve “Individë në nevojë” në Fier, Patos, Mallakastër është gjithashtu i ndryshëm, thujasë 3 herë më i lartë në Fier e Lushnje në krahasim me Patosin dhe 10 herë më i lartë se sa në Mallakastër. Pavarësisht faktorit “Popullsi”, kjo diferencë duhet të nxisë debate në lidhje me standartet e cilësisë së shërbimeve si edhe standartet e ngarkesës së stafit pa cenuar cilësinë e shërbimeve, koment i cili është nënvizuar edhe në raste të ngjashme në qarqe të tjera.

Tabela 3: Përfitues për një shërbim në çdo bashki

Fier	Individë përfitues për një shërbim në çdo bashki					
	Fier	Patos	Roskovec	Lushnje	Mallakastër	Divjakë
Individë në nevojë	50	15	0	52	5	0
Fëmijë jashtë kujdesit	0	0	0	0	0	12
Fëmijë AK	25	5	4	13	0	0
Të rritur AK	0	0	2	164	0	0
Të rinj në nevojë	22	0	0	31	15	0
Gra në nevojë	0	0	0	16	0	0
Romë dhe Egjiptianë	31	0	0	0	0	17
Të moshuar	14	0	10	13	0	14

Burimi: Studimi, Janar 2025



Tabelat 4 deri 9 përmbajnë vlerat e tre treguesve të ndërtuar për qëllim të këtij vlerësimi, përkatësisht Shkallës së plotësimit të nevojës për shërbime në çdo bashki të qarkut; Shkallën e plotësimit të aplikimeve për çdo bashki; Koeficientin e Mjaftueshmërisë Akomoduese për çdo bashki. Sipas të dhënave të tabelave 4 deri 9 rezulton se:

Në të gjitha bashkitë e qarkut shkalla e plotësimit të nevojave është tejte e ulët, me përjashtim të bashkisë Lushnje, në të cilën ky tregues është 33%. Shkalla e plotësimit të nevojave në bashkinë Fier është 14%, ndërsa në bashkitë e tjera të qarkut është 2 deri 6%.

Bashkitë Fier, Lushnje, Patos karakterizohen nga shkallë e lartë e plotësimit të aplikimeve, mbi 85%. Ndërsa, në dallim me këto bashki, bashkitë e Roskovecit, Mallakastrës, Divjakës, ky tregues është shumë më i ulët, 40% deri 50%.

KMA paraqitet në vlera pozitive për 4 grupe në Lushnje, 3 grupe në Fier, 2 në bashkinë Roskovec, një në Divjakë dhe asnjë grup në Patos. Për të gjithë grupet e tjerë KMA është negativ ose nuk ka asnjë vlerë sepse kapacitetet janë inekzistente.

Tabela 4: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Fier

Fier	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	1.470	250	250	52	15%	83%	0%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	37	0	0	3	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	433	100	100	3	19%	97%	0%
Të rritur me aftësi të kufizuar	2.261	0	0	30	0%	0%	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	0	100	239	0	100%	100%	-139%
Gra në kushte kritike	110	10	0	1	0%	0%	100%
Të moshuar	48	100	94	24	66%	80%	6%
Romë dhe Egjiptianë	0	100	55	0	100%	100%	45%
Gjithsej	4.359	660	738	113	14%	87%	-12%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 5: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Patos

Patos	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	387	40	59	13	13%	82%	-48%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	12	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	74	20	21	0	22%	100%	-5%
Të rritur me aftësi të kufizuar	723	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	13	0	0	2	0%	0%	S'ka kapacitet
Të moshuar	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Romë dhe Egjiptianë	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gjithsej	1.209	60	80	15	6%	84%	-33%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 6: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Roskovec

Roskovec	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	180	0	0	16	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	2	0	0	2	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	102	25	16	18	14%	47%	36%
Të rritur me aftësi të kufizuar	758	0	7	10	1%	41%	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	37	0	0	7	0%	0%	S'ka kapacitet
Të moshuar	8	50	0	4	0%	0%	100%
Romë dhe Egjiptianë	81	0	50	81	38%	38%	S'ka kapacitet
Gjithsej	1.168	75	73	138	6%	35%	3%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 7: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Lushnje

Lushnje	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	851	565	778	15	48%	98%	-38%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	13	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	461	175	50	1	10%	98%	71%
Të rritur me aftësi të kufizuar	1.580	297	327	10	17%	97%	-10%
Të rinj në kushte kritike	0	100	93	0	100%	100%	7%
Gra në kushte kritike	38	120	95	8	71%	92%	21%
Të moshuar	4	110	2	2	33%	50%	98%
Romë dhe Egjiptianë	0	0	118	0	100%	100%	S'ka kapacitet
Gjithsej	2.947	1.367	1.463	36	33%	98%	-7%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 8: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Mallakastër

Mallakastër	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	1.301	20	16	47	1%	25%	20%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	76	0	0	3	0%	0%	S'ka kapacitet
Të rritur me aftësi të kufizuar	902	0	0	15	0%	0%	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	10	30	30	10	75%	75%	0%
Gra në kushte kritike	45	0	0	2	0%	0%	S'ka kapacitet
Të moshuar	6	0	0	3	0%	0%	S'ka kapacitet
Romë dhe Egjiptianë	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gjithsej	2.340	50	46	80	2%	37%	8%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 9: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Divjakë

Divjakë	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	384	0	100	0	21%	100%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	2	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	510	100	0	15	0%	0%	100%
Të rritur me aftësi të kufizuar	1.818	0	0	64	0%	0%	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	50	0	0	15	0%	0%	S'ka kapacitet
Të moshuar	12	0	0	6	0%	0%	S'ka kapacitet
Romë dhe Egjiptianë	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gjithsej	2.776	100	100	100	3%	50%	0%

Burimi: Studimi, Janar 2025

2.5.1. Vlerësim përmblledhës për bashkitë e qarkut Fier

- Me një popullsi 240.377 banorë, qarku Fier është qarku i dytë më i populluar i vendit, i përbërë nga 6 bashki.
- Pavarësisht rritjes së numrit të ofruesve, të shërbimeve dhe të përfituesve në vijimësi, nevoja për shërbime të përkujdesit shoqëror është e evidente.
- Janë 14.799 individë në nevojë në qarkun e Fierit, ndërsa përfitues të shërbimeve janë vetëm 2.500 individë, ose vetëm 14% e nevojës plotësohet me shërbime.
- 84% e aplikantëve për shërbime arrijnë të përfitojnë shërbimet e kërkuara.
- Koeficienti i Mjaftueshmërisë Akomoduese është -18% në rang qarku, e dhënë e cila tregon se kapacitetet ekzistuese nuk janë të mjaftueshme për të akomoduar edhe vetëm përfituesit aktualë, pra ofruesit janë të tej ngarkuar.
- Ndërsa tabelat dhe figurat e mësipërme sjellin të dhëna të detajuara mbi shërbimet e munguara, tipologjitë dhe grupet përkatëse, analiza tregon se grupet më kritike, në kushte përjashtimi ekstrem (grupet për të cilat shkalla e plotësimit të nevojës është më e ulët se 10%) janë:
 - Fëmijët jashtë kujdesit prindëror, të rriturit AK, gratë në nevojë, në çdo bashki, përveç bashkisë Lushnje.
 - Të gjitha grupet në bashkinë Roskovec, përveç komunitetit Rom.
 - Të gjitha grupet në bashkinë Divjakë, përveç individëve në nevojë ekonomike.
 - Të gjitha grupet në bashkinë Mallakastër, përveç të Rinjve në nevojë.
 - Fëmijët me AK në bashkinë Lushnje.



2.6. BASHKITË E QARKUT GJIROKASTËR

Qarku Gjirokastrë, me një popullsi prej 60.013 banorë¹⁰, përbëhet nga 7 bashki, ndër të cilat Bashkia Gjirokastrës (23.270 banorë) është bashkia më e madhe, më e zhvilluar e qarkut si edhe qendra e qarkut.

Në qarkun e Gjirokastrës ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror 21 ofrues, nga të cilët rreth 90% janë publikë (Tabela 1). 40% e ofruesve ushtrojnë funksionin e tyre në bashkinë Gjirokastrë. Bashkia Përmet, ndonëse ka 1/3 e banorëve të Gjirokastrës ka në territorin e vet rreth 25% të ofruesve të qarkut.

Tabela 1: Ofrues, Shërbime dhe Përfitues, numër


Bashkitë	Ofrues të shërbimeve			Shërbime sipas ofruesve			Përfitues sipas ofruesve		
	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej
Gjirokastrë	6	3	9	30	19	49	406	109	515
Përmet	5	0	5	18	0	18	107	0	107
Libohovë	1	0	1	9	0	9	90	0	90
Këlcyrë	1	0	1	3	0	3	20	0	20
Dropull	1	0	1	4	0	4	61	0	61
Tepelenë	3	0	3	12	0	12	84	0	84
Memaliaj	1	0	1	10	0	10	29	0	29
Gjithsej	18	3	21	86	19	105	797	109	906

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 1 sjell gjithashtu informacion edhe për numrin e shërbimeve që sigurojnë të gjithë ofruesit si edhe përfituesit e tyre. Siç edhe konstatohet, 55% e përfituesve i përkasin bashkisë Gjirokastrë.

Vlen të nënvizohet fakti se në krahasim me dy vite më parë, numri i ofruesve të shërbimeve është thujse dyfishuar në të gjithë qarkun. Figura 1 qartësisht tregon se në çdo bashki të qarkut, me përjashtim të bashkisë Gjirokastrë, numri i ofruesve është rritur. Ndërsa dy vite më parë, në qarkun e Gjirokastrës ishin 4 bashki që nuk ofronin asnjë shërbim, tashmë kjo situatë është ndryshuar tërësisht.


Figura 1 - Ofruesit e shërbimeve, numër



Burimi: Studimi, Janar 2025

Rritja e numrit të ofruesve ka ndikuar në rritjen e numrit të përfituesve të shërbimeve, rreth dy herë, rritje e cila konstatohet në çdo bashki të qarkut, edhe në ato bashki në të cilat numri i ofruesve nuk ka ndryshuar (Figura 2)


Figura 2 - Përfituesit e shërbimeve



Burimi: Studimi, Janar 2025

Faktori më thelbësor që ka ndikuar në rritjen e numrit të ofruesve si edhe të shërbimeve që ato sigurojnë, është investimi nëpërmjet fondit social. Siç tregon figura 3, fondi social ka mundësuar ngritjen e shërbimeve të reja në të gjitha bashkitë e qarkut, edhe në ato bashki në të cilat dy vite më parë nuk ofrohej asnjë shërbim. 40% e ofruesve (8/21 ofrues) janë pjesë e projekteve të financuara dhe mbështetura nga fondi social.

Figura 3 - Ofruesit e shërbimeve mbështetur nga fondi social kundrejt të gjithë ofruesve, 2025



Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 2 evidenton të gjithë ofruesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror sipas tipologjive të tyre, shoqëruar edhe me numrin përkatës të shërbimeve që sigurojnë si edhe me numrin përkatës të përfituesve.

Tabela 2: Ofruesit, shërbimet dhe përfituesit e përkujdesit shoqëror, sipas tipologjive të ofruesve, numër


Tipologjitë	Rezidenciale			Ditore			Komunitare			Qendra zhvillimi			Shumëdisiplinore			Strehëz emergjence			Shërbim lëvizës			Fondacione/Shoqata			Gjithsej		
	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P
Gjirokastrë	2	6	74	1	3	40	2	22	213	1	4	78				1	5	40	1	9	70	1			9	49	515
Përmet							2	7	47				1	3	30	1	5		1	3	30				5	18	107
Libohovë													1	9	90										1	9	90
Këlcyrë				1	3	20																			1	3	20
Dropull																			1	4	61				1	4	61
Tepelenë							1	4	20							1	4	4	1	4	60				3	12	84
Memaliaj													1	10	29										1	10	29
Gjithsej	2	6	74	2	6	60	5	33	280	1	4	78	3	22	149	3	14	44	4	20	221	1	0	0	21	105	906

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 2 konfirmon se vetëm në bashkinë Gjirokastrë funksionojnë 7 nga 8 tipologjitë e ofruesve duke ndikuar në rritjen e mundësinë e qytetarëve për të aksesuar shërbimet që ata kanë nevojë. Në bashkinë Përmet ofrojnë shërbime ofrues të katër tipologjive, në Tepelenë funksionojnë 3 ofrues të 3 tipologjive, ndërsa në bashkitë e tjera vetëm një tipologji, kryesisht tipologjia e “Ofruesit shumë disiplinor”.

Figura 4 paraqit vlerat e treguesit “Shpërndarja e përfituesve për çdo shërbim, sipas tipologjive”.

Figura 4-Shpërndarja e përfituesve për çdo shërbim, sipas tipologjive



Burimi: Studimi, Janar 2025

Treguesi i mësipërm i paraqitur në figurën 4, në përputhje me përkufizimin dhe mënyrën e tij të llogaritjes, informon se:

- Në bashkitë e qarkut Gjirokastrë ekziston mundësia e aksesit thuajse të barabartë të qytetarëve ndaj tipologjive të ndryshme të shërbimeve, pavarësisht nga vendbanimi i tyre, meqenëse në bashkinë Gjirokastrë ofrohen të gjitha tipologjitë e shërbimeve, në bashkinë Tepelenë ofrohen 8 dhe Përmet 7 nga 11 tipologji, bashkitë e tjera ofrojnë një numër më të kufizuar të tipologjive.
- Shërbimet parashoqërore ofrohen në çdo bashki, me përjashtim të bashkisë Dropull; Kujdesi alternativ

ofrohet vetëm në Gjirokastrë; Shërbime rezidenciale ofrohen gjithashtu vetëm në Gjirokastrë dhe Dropull, dhe kështu vijon për të gjitha bashkitë.

- 100% e përfituesve të kujdesit alternativ janë banorë të Gjirokastrës, 90% e përfituesve të shërbimeve të strehëzave gjithashtu janë në Gjirokastrë, ndërsa shërbimet e tjera shpërndahen në përqindje më të ulta, në të gjithë qarkun, gjë që dëshmon për një akses relativisht të barabartë të qytetarëve në qarkun e Gjirokastrës për shërbimet parashoqërore, ditore, komunitare etj.

Tabela 3 plotëson kuadrin e vlerësimit të aksesit dhe përdorimit të cilësishëm të shërbimeve, nëpërmjet treguesit tjetër të integruar “Përfitues për një shërbim”, por sipas grupeve kritike, jo më sipas tipologjive të shërbimeve.

Kjo tabelë tregon se:

- Në bashkinë Gjirokastrë marrin shërbime të gjitha grupet, ndërsa në bashkitë e tjera 1 deri 3 grupe. Pra edhe pse figura 4 dëshmoi për një akses thuajse të barabartë të qytetarëve ndaj tipologjive të shërbimeve, analiza sipas grupeve kritike, nxjerr në pak diferencat e theksuara në mundësinë e përdorimit të shërbimeve.
- Në Gjirokastrë 21 individë në nevojë ekonomike, 13 fëmijë AK, 8 të rritur AK dhe gra në nevojë, 7 të moshuar, romë dhe po aq fëmijë jashtë kujdesit prindëror, përfitojnë mesatarisht një shërbim, fakt që rikonfirmon shpërndarjen thuajse të barabartë si edhe mundësinë e zbatimit të të njëjtave standarte cilësie.
- I njëjti vlerësim vlen edhe për bashkitë e tjera, sigurisht vetëm për ato shërbime të cilat përfitohen nga qytetarëve të grupeve në kushte kritike.

Tabela 3: Përfitues për një shërbim në çdo bashki

Gjirokastrë	Individë përfitues për një shërbim në çdo bashki						
	Gjirokastrë	Përmet	Libohovë	Këlcyrë	Dropull	Tepelenë	Memaliaj
Individë në nevojë	12	5	0	0	0	0	0
Fëmijë jashtë kujdesit	8	1	0	0	4	15	12
Fëmijë AK	11	0	1	4	3	3	0
Të rritur AK	12	0	2	0	0	0	0
Të rinj në nevojë	7	13	0	0	0	0	0
Gra në nevojë	10	0	0	0	0	0	0
Romë dhe Egjiptianë	19	12	0	2	13	8	17
Të moshuar	49	0	17	0	0	10	14

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabelat 4 deri 10 përmbajnë vlerat e tre treguesve të ndërtuar për qëllim të këtij vlerësimi, përkatësisht Shkallës së plotësimit të nevojës për shërbime në çdo bashki të qarkut; Shkallën e plotësimit të aplikimeve për çdo bashki; Koeficientin e Mjaftueshmërisë Akomoduese për çdo bashki. Sipas të dhënave të tabelave 4 deri 10 rezultojnë se:

Bashkia Gjirokastrë ka shkallën më të lartë të plotësimit të nevojave për shërbime, në masën 31%, e pasuar nga bashkitë Dropull e Libohovë, 19%, e më tej, bashkia Përmet, 17%. Bashkitë e tjera kanë një shkallë tejet të ulët të plotësimit të nevojave.

Bashkia Gjirokastrë ka shkallën më të lartë të plotësimit të aplikimeve, 89% ndërsa bashkia Përmet ka shkallën më të ulët, 37%. Në interpretim të kësaj gjetje nuk komentohen bashkitë e Këlcyrës dhe Dropullit, ndonëse vlera e këtij treguesi është 100%, por në këto bashki ofrohet vetëm një shërbim, ndërsa nuk ekzistojnë kapacitete të tjera, për rrjedhojë, edhe pse matematikisht, vlera e gjetur është e saktë, nga pikëpamja e qëllimit të kësaj analize nuk ka domethënie.

KMA paraqitet në vlera pozitive për të gjitha bashkitë përveç bashkisë Gjirokastrë, për ato grupe për të cilat këto bashki ofrojnë shërbime, gjë që dëshmon se në ato shërbime që funksionojnë, kapacitete të lita, ende ka. Në bashkinë Gjirokastrë, KMA në rang qarku është negativ, -14%, gjë që kushtëzohet nga mangësitë në kapacitete të ofruesve të shërbimeve për gra në kushte kritike. Kapacitetet e shërbimeve për të moshuar në bashkinë Gjirokastrë rezultojnë me kapacitete të lira në përmasë të konsiderueshme.

Tabela 4: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Gjirokastrë

Gjirokastrë	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	193	170	167	19	46%	90%	2%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	42	15	14	6	25%	70%	7%
Fëmijë me aftësi të kufizuar	215	90	90	10	30%	90%	0%
Të rritur me aftësi të kufizuar	644	60	59	5	8%	92%	2%
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	47	17	40	5	46%	89%	-135%
Të moshuar	32	100	34	16	52%	68%	66%
Romë dhe Egjiptianë	0	0	111	0	100%	100%	S'ka kapacitet
Gjithsej	1.173	452	515	61	31%	89%	-14%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 5: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Përmet

Përmet	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	341	0	0	141	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	1	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	19	25	17	0	47%	100%	32%
Të rritur me aftësi të kufizuar	77	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	9	40	30	9	77%	77%	25%
Gra në kushte kritike	10	6	0	3	0%	0%	100%
Të moshuar	52	65	0	26	0%	0%	100%
Romë dhe Egjiptianë	0	0	60	0	100%	100%	S'ka kapacitet
Gjithsej	509	136	107	179	17%	37%	21%

Burimi: Studimi, Janar 2025



Tabela 6: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Libohovë

Libohovë	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	58	0	0	11	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	2	0	0	1	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	17	0	1	1	6%	50%	S'ka kapacitet
Të rritur me aftësi të kufizuar	168	50	24	24	13%	50%	52%
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	1	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të moshuar	130	200	0	65	0%	0%	100%
Romë dhe Egjiptianë	0	0	65	0	100%	100%	S'ka kapacitet
Gjithsej	376	250	90	102	19%	47%	64%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 7: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Këlcyrë

Këlcyrë	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	577	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	51	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të rritur me aftësi të kufizuar	184	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të moshuar	0	25	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	100%
Romë dhe Egjiptianë	0	0	20	0	100%	100%	S'ka kapacitet
Gjithsej	812	25	20	0	2%	100%	20%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 8: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Dropull

Dropull	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	84	70	61	0	42%	100%	13%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	8	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të rritur me aftësi të kufizuar	162	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	4	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të moshuar	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Romë dhe Egjiptianë	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gjithsej	258	70	61	0	19%	100%	13%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 9: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Tepelenë

Tepelenë	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	576	6	4	45	1%	8%	33%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	3	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	65	20	20	4	24%	83%	0%
Të rritur me aftësi të kufizuar	357	0	0	9	0%	0%	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	33	0	0	1	0%	0%	S'ka kapacitet
Të moshuar	24	60	0	12	0%	0%	100%
Romë dhe Egjiptianë	0	0	60	0	100%	100%	S'ka kapacitet
Gjithsej	1.058	86	84	71	7%	54%	2%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 10: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Memaliaj

Memaliaj	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	656	20	10	10	2%	50%	50%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	14		0	9	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	101	30	8	2	7%	80%	73%
Të rritur me aftësi të kufizuar	694	20	7	0	1%	100%	65%
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	0	5	2	0	100%	100%	60%
Të moshuar	30	25	0	15	0%	0%	100%
Romë dhe Egjiptianë	0	0	2	0	100%	100%	S'ka kapacitet
Gjithsej	1.495	100	29	36	2%	45%	71%

Burimi: Studimi, Janar 2025

2.6.1. Vlerësim përmbledhës për bashkitë e qarkut Gjirokastrë

- Me një popullsi 60.013 banorë, qarku Gjirokastrë është qarku më pak i populluar i vendit, i përbërë nga 7 bashki.
- Pavarësisht rritjes së numrit të ofruesve, të shërbimeve dhe të përfituesve në vijimësi, nevoja për shërbime të përkujdesit shoqëror është evidente.
- Janë 5.681 individë në nevojë në të gjithë qarkun, ndërsa përfitues të shërbimeve janë vetëm 906 individë, ose 14% e nevojës plotësohet me shërbime.
- 69% e aplikantëve për shërbime arrijnë të përfitojnë shërbimet e kërkuara.

- Koeficienti i Mjaftueshmërisë Akomoduese është -10% në rang qarku, e dhënë e cila tregon se kapacitetet ekzistuese nuk janë të mjaftueshme për të akomoduar kërkesat aktuale.
- Ndërsa tabelat dhe figurat e mësipërme sjellin të dhëna të detajuara mbi shërbimet e munguara, tipologjitë dhe grupet përkatëse, analiza tregon se grupet më kritike, në kushte përjashtimi ekstrem (grupet për të cilat shkalla e plotësimit të nevojës është më e ulët se 10%) janë:
 - Të rriturit me AK në çdo bashki, përveç bashkisë Libohovë.
 - Individë në nevojë ekonomike dhe fëmijë jashtë kujdesit prindëror, në çdo bashki, me përjashtim të bashkive Gjirokastrë, Dropull dhe Këlcyrë.
 - Gra në nevojë, në Përmet, Tepelenë, Dropull dhe Libohovë.
 - Fëmijët me AK në Memaliaj, Dropull, Këlcyrë dhe Libohovë.
 - Të moshuarit në Përmet, Memaliaj, Tepelenë, Libohovë.

2.7. BASHKITË E QARKUT KORÇË

Qarku Korçë, me një popullsi prej 173.091 banorë¹¹, përbëhet nga 6 bashki, ndër të cilat Bashkia Korçë(60.754 banorë) është bashkia më e madhe, më e zhvilluar e qarkut si edhe qendra e qarkut. Megjithatë, edhe bashkitë Pogradec e Maliq karakterizohen jo vetëm nga popullsia relativisht e madhe por edhe situatë komplekse ekonomike e sociale.

Në qarkun e Korçës ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror 44 ofrues, nga të cilët rreth 60% janë publikë (Tabela 1). 50% e ofruesve ushtrojnë funksionin e tyre në bashkinë Korçë. Bashkia Pustec, bashkia më e vogël e Shqipërisë, 1.843 banorë, është bashkia me numrin më të vogël të ofruesve (1).

Tabela 1: Ofrues, Shërbime dhe Përfitues, numër


Bashkitë	Ofrues të shërbimeve			Shërbime sipas ofruesve			Përfitues sipas ofruesve		
	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej
Korçë	13	9	22	56	34	90	471	1.383	1.854
Pogradec	4	5	9	32	34	66	142	500	642
Devoll	2	0	2	17	0	17	135	0	135
Pustec	1		1	6		6	30		30
Kolonjë	1	3	4	3	13	16	35	92	127
Maliq	5	1	6	16	3	19	92	8	100
Gjithsej	26	18	44	130	84	214	905	1.983	2.888

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 1 sjell gjithashtu informacion edhe për numrin e shërbimeve që sigurojnë të gjithë ofruesit si edhe përfituesit e tyre. Siç edhe konstatohet, 64% e përfituesve i përkasin bashkisë Korçë.

Vlen të nënvizohet fakti se në krahasim me dy vite më parë, numri i ofruesve të shërbimeve nuk ka ndryshuar, ndonëse në disa bashki, si në Devoll, Pustec dhe Maliq, është rritur, por për shkak të mbylljes të disa ofruesve të shërbimeve në Korçë, (3 ofrues), numri i përgjithshëm nuk ka ndryshuar.


Figura 1 - Ofruesit e shërbimeve, numër



Burimi: Studimi, Janar 2025

Numri i përgjithshëm i përfituesve gjithashtu është zvogëluar, ndonëse me vetëm 4%. (Figura 2)


Figura 2 - Përfituesit e shërbimeve



Burimi: Studimi, Janar 2025

Bashkitë e qarkut Korçë janë pjesë e mbështetjes nga Fondi Social. Siç tregon figura 3, fondi social ka mundësuar ngritjen e shërbimeve të reja në të gjitha bashkitë e qarkut. 23% e ofruesve (10/44 ofrues) janë pjesë e projekteve të financuara dhe mbështetura nga fondi social, ku ½ e projekteve është e përqendruar në bashkinë Korçë.

Figura 3 - Ofruesit e shërbimeve mbështetur nga fondi social kundrejt të gjithë ofruesve, 2025



Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 2 evidenton të gjithë ofruesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror sipas tipologjive të tyre, shoqëruar edhe me numrin përkatës të shërbimeve që sigurojnë si edhe me numrin përkatës të përfituesve.

Tabela 2: Ofruesit, shërbimet dhe përfituesit e përkujdesit shoqëror, sipas tipologjive të ofruesve, numër.


Tipologjitë	Rezidenciale			Ditore			Komunitare			Qendra zhvillimi			Shumëdisiplinore			Strehëz emergjence			Shërbim lëvizës			Fondacione/Shoqata			Gjithsej		
	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P
Korçë	2	10	39				3	16	92	1	7	23	4	20	200	1	4	7	1	3	110	10	30	1.383	22	90	1.854
Pogradec							5	38	191							1	10	11				3	18	440	9	66	642
Devoll	1	2	35	1	15	100																			2	17	135
Pustec							1	6	30																1	6	30
Kolonjë	1	3	35																3	13	92				4	16	127
Maliq				2	6	54	1	4	38							2	6					1	3	8	6	19	100
Gjithsej	4	15	109	3	21	154	10	64	351	1	7	23	4	20	200	4	20	18	4	16	202	14	51	1.831	44	214	2.888

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 2 konfirmon se vetëm në bashkinë Korçë funksionojnë thuajse të gjitha tipologjitë e ofruesve, me përjashtim të qendrave ditore, duke rritur mundësinë e qytetarëve për të aksesuar shërbimet që ata kanë nevojë. Në bashkinë Maliq ofrojnë shërbime ofrues të katër tipologjive, në bashkitë e tjera, numri i tipologjive të ofruesve është i kufizuar.

Figura 4 paraqit vlerat e treguesit “Shpërndarja e përfituesve për çdo shërbim, sipas tipologjive”.

Figura 4-Shpërndarja e përfituesve për çdo shërbim, sipas tipologjive



Burimi: Studimi, Janar 2025

Treguesi i mësipërm i paraqitur në figurën 4, në përputhje me përkufizimin dhe mënyrën e tij të llogaritjes, informon se:

- Bashkia Korçë ofron të gjitha tipologjitë e shërbimeve, Bashkitë Pogradec dhe Maliq ofrojnë 10 nga 11 tipologji, Bashkia Devoll ofron 7 tipologji, ndërsa ajo e Pustecit vetëm 3 tipologji.
- Shërbimet parashoqërore dhe ato komunitare ofrohen dhe përdoren në 6 nga 7 bashkitë; Qendrat e zhvillimit aksesohen vetëm në dy bashki, Korçë dhe Pogradec, ku secila prej tyre aksesohet nga 50% e përfituesve të qarkut.

- Gjykoheq që shpërndarje e përfituesve mesatarisht për çdo tipologji shërbimi është thuajse e njëjtë, gjë që lejon formulimin e gjetjes në lidhje me barazinë në akses të individëve në nevojë.

Tabela 3 plotëson kuadrin e vlerësimit të aksesit dhe përdorimit të cilësishëm të shërbimeve, nëpërmjet treguesit tjetër të integruar “Përfitues për një shërbim”, por sipas grupeve kritike, jo më sipas tipologjive të shërbimeve.

Kjo tabelë tregon se:

- Në bashkinë Korçë marrin shërbime të gjitha grupet. Në Pogradec gjithashtu të gjitha grupet përveç grupit “Romë dhe Egjiptianë”. Në bashkitë e tjera përfitojnë dy, tre ose katër grupe nga 8 grupe në kushte kritike. Për rrjedhojë, aksesit nuk është i njëjtë në të gjitha bashkitë e qarkut, nëse analizohen grupet në kushte më kritike.
- Në Korçë, 66 individë në nevojë ekonomike përfitojnë një shërbim, kundrejt 11 individëve të të njëjtit grup që e përfitojnë atë shërbim në Kolonjë, ose 6 herë më shumë.
- Gjithashtu, shpërndarje jo e njëjtë konstatohet edhe për grupin “Gra në nevojë”, numri mesatar i përfituesve të të cilës është 18 në Pogradec kundrejt 1 përfituese në Korçë.
- Për grupet e tjera, shpërndarja e përfituesve është relativisht e njëjtë, sigurisht në ato bashki në të cilat shërbimi përkatës ofrohet.

Tabela 3: Përfitues për një shërbim në çdo bashki

Korçë	Individë përfitues për një shërbim në çdo bashki					
	Korçë	Pogradec	Devoll	Pustec	Kolonjë	Maliq
Individë në nevojë	66	25	0	0	11	0
Fëmijë jashtë kujdesit	1	2	0	0	2	1
Fëmijë AK	16	4	3	3	0	10
Të rritur AK	6	5	3	7	0	0
Të rinj në nevojë	7	5	0	0	0	0
Gra në nevojë	1	18	0	0	0	0
Romë dhe Egjiptianë	8	0	2	0	2	7
Të moshuar	24	7	32	0	12	11

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabelat 4 deri 9 përmbajnë vlerat e tre treguesve të ndërtuar për qëllim të këtij vlerësimi, përkatësisht Shkallës së plotësimit të nevojës për shërbime në çdo bashki të qarkut; Shkallën e plotësimit të aplikimeve për çdo bashki; Koeficientin e Mjaftueshmërisë Akomoduese për çdo bashki. Sipas të dhënave të tabelave 4 deri 9 rezultojnë se:

Bashkia Korçë ka shkallën më të lartë të plotësimit të nevojave për shërbime, në masën 27%, e pasuar nga bashkitë Pustec dhe Kolonjë, secila përkatësisht 12%. Bashkia Pogradec, pavarësisht madhësisë e pozicionit të përshtatshëm gjeografik të saj, ka një shkallë mjaft të ulët të plotësimit të nevojave, 5%, ndërsa dy bashkitë e tjera, Maliq dhe Devoll, përjetojnë situatë edhe më kritike, për shkak të një shkalle tejet të ulët të plotësimit të nevojave, 1 deri 3%.

Bashkia Korçë ka shkallën më të lartë të plotësimit të aplikimeve, 77% ndërsa bashkia Maliq ka shkallën më të ulët, 21%.

KMA paraqitet në vlera pozitive në Devoll e Maliq, për ato grupe për të cilat këto bashki ofrojnë shërbime. Në bashkinë Kolonjë vlera e KMA dëshmon për mangësi të theksuar të kapaciteteve akomoduese. Në dy bashkitë më të mëdha të qarkut, përkatësisht në Korçë e Pogradec, rezultojnë mangësi vetëm në disa grupe. Kështu, në bashkinë Korçë ka mangësi në kapacitete për shërbimet për fëmijë me AK, të rinj në nevojë si edhe komunitetin rom. Sa i përket grupeve të tjera, përkatësisht individëve në nevojë ekonomike, fëmijëve jashtë kujdesit prindëror, të rriturve AK, të moshuarve dhe grave në nevojë, ekzistojnë kapacitete të lira, në përmasa të moderuara.

Në bashkinë Pogradec ka mangësi të theksuara në shërbimet për individët me AK, fëmijë ose të rritur, ndërsa për shërbimet që ofrohen në bashki, ka kapacitete të lira, të ndryshme për grupe të ndryshme.

Tabela 4: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Korçë

Korçë	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	2.118	1.010	927	208	30%	82%	8%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	13	20	8	5	38%	62%	60%
Fëmijë me aftësi të kufizuar	197	50	63	16	24%	80%	-26%
Të rritur me aftësi të kufizuar	2.294	85	68	76	3%	47%	20%
Të rinj në kushte kritike	69	90	94	69	58%	58%	-4%
Gra në kushte kritike	247	8	7	87	3%	7%	13%
Të moshuar	114	395	40	57	26%	41%	90%
Romë dhe Egjiptianë	46	50	647	46	93%	93%	-1194%
Gjithsej	5.098	1.708	1.854	564	27%	77%	-9%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 5: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Pogradec

Pogradec	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	10.218	325	295	336	3%	47%	9%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	6	20	4	0	40%	100%	80%
Fëmijë me aftësi të kufizuar	570	50	89	34	14%	72%	-78%
Të rritur me aftësi të kufizuar	1.710	50	93	274	5%	25%	-86%
Të rinj në kushte kritike	128	30	21	128	14%	14%	30%
Gra në kushte kritike	345	162	127	92	27%	58%	22%
Të moshuar	44	0	0	22	0%	0%	S'ka kapacitet
Romë dhe Egjiptianë	59	0	13	59	18%	18%	S'ka kapacitet
Gjithsej	13.080	637	642	945	5%	40%	-1%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 6: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Devoll

Devoll	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	2.543	0	0	15	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	23	0	0	2	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	84	20	14	3	14%	82%	30%
Të rritur me aftësi të kufizuar	796	20	20	45	2%	31%	0%
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	177	0	0	2	0%	0%	S'ka kapacitet
Të moshuar	248	100	6	124	2%	5%	94%
Romë dhe Egjiptianë	0	0	95	0	100%	100%	S'ka kapacitet
Gjithsej	3.871	140	135	191	3%	41%	4%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 7: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Pustec

Pustec	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	159	0	0	8	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	4	10	10	2	71%	83%	0%
Të rritur me aftësi të kufizuar	41	20	20	0	33%	100%	0%
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	10	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të moshuar	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Romë dhe Egjiptianë	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gjithsej	214	30	30	10	12%	75%	0%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 8: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Kolonjë

Kolonjë	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	540	10	84	25	13%	77%	-740%
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	10	10	3	0	23%	100%	70%
Fëmijë me aftësi të kufizuar	36	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të rritur me aftësi të kufizuar	332	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	19	0	0	0	0%	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Të moshuar	10	40	5	5	33%	50%	88%
Romë dhe Egjiptianë	0	0	35	0	100%	100%	S'ka kapacitet
Gjithsej	947	60	127	30	12%	81%	-112%

Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 9: Treguesit jo të drejtëpërdrejtë të vlerësimit të nevojës për shërbime në bashkinë Maliq

Maliq	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	6.028	0	0	333	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	7	10	8	2	53%	80%	20%
Fëmijë me aftësi të kufizuar	174	45	38	8	18%	83%	16%
Të rritur me aftësi të kufizuar	1.535	0	0	25	0%	0%	S'ka kapacitet
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	137	2	0	9	0%	0%	100%
Të moshuar	4	40	20	2	83%	91%	50%
Romë dhe Egjiptianë	0	20	34	0	100%	100%	-70%
Gjithsej	7.885	117	100	379	1%	21%	15%

Burimi: Studimi, Janar 2025

2.7.1. Vlerësim përmbledhës për bashkitë e qarkut Korçë

- Me një popullsi 173.091 banorë, qarku Korçë është qarku i pestë më i populluar i vendit, i përbërë nga 6 bashki.
- Numri i ofruesve të shërbimeve dhe të përfituesve në vijimësi, në nivel qarku, nuk ka ndryshuar gjatë dy viteve të fundit.
- Janë 31.095 individë në nevojë në qarkun e Korçës, ndërsa përfitues të shërbimeve janë vetëm 2.888 individë, ose vetëm 8% e nevojës plotësohet me shërbime.
- 58% e aplikantëve për shërbime arrijnë të përfitojnë shërbimet e kërkuara.
- Koeficienti i Mjaftueshmërisë Akomoduese është -6% në rang qarku, e dhënë e cila tregon se kapacitetet ekzistuese janë të pamjaftueshme për të akomoduar edhe nivelin aktual të kërkesave.
- Ndërsa tabelat dhe figurat e mësipërme sjellin të dhëna të detajuara mbi shërbimet e munguara, tipologjitë dhe grupet përkatëse, analiza tregon se grupet më kritike, në kushte përjashtimi ekstrem (grupet për të cilat shkalla e plotësimit të nevojës është më e ulët se 10%) janë:
 - Të rriturit me AK në çdo bashki, përveç bashkisë Pustec.
 - Gra në nevojë, në çdo bashki përveç bashkisë Pogradec.
 - Individë në nevojë ekonomike në bashkitë Pogradec, Devoll, Maliq.
 - Të moshuarit në Pogradec dhe Devoll.
 - Fëmijët me AK në Kolonjë.
 - Fëmijët pa kujdes prindëror në Devoll.

2.8. BASHKITË E QARKUT KUKËS



Qarku Kukës, me një popullsi prej 61.998 banorë¹², përbëhet nga 3 bashki, ndër të cilat Bashkia Kukës(36.125 banorë) është bashkia më e madhe si edhe qendra e qarkut.

Në qarkun e Kukësit ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror 7 ofrues, nga të cilët 70% janë publikë (Tabela 1). 45% e ofruesve ushtrojnë funksionin e tyre në bashkinë Kukës. Bashkitë Tropojë dhe Has kanë numër tepër të kufizuar ofruesish, vetëm 2.

Tabela 1: Ofrues, Shërbime dhe Përfitues, numër

Bashkitë	Ofrues të shërbimeve			Shërbime sipas ofruesve			Përfitues sipas ofruesve		
	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej	Publikë	Jo Publikë	Gjithsej
Kukës	3	0	3	13	0	13	103	0	103
Has	2	0	2	11	0	11	153	0	153
Tropojë	0	2	2	0	5	5	0	34	34
Gjithsej	5	2	7	24	5	29	256	34	290


Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 1 sjell gjithashtu informacion edhe për numrin e shërbimeve që sigurojnë të gjithë ofruesit si edhe përfituesit e tyre. Siç edhe konstatohet, 30% e përfituesve i përkasin bashkisë Kukës, ndërsa 58% bashkisë Has. Vetëm 12% e përfituesve marrin shërbime në Tropojë.

Vlen të nënvizohet fakti se në krahasim me dy vite më parë, numri i ofruesve të shërbimeve është rritur 40% në të gjithë qarkun (Figura 1), ndonëse në bashkinë Kukës ky numër është zvogëluar me një ofrues.

12 Census 2023


Figura 1 - Ofruesit e shërbimeve, numër



Burimi: Studimi, Janar 2025

Rritja e numrit të ofruesve ka ndikuar në rritjen e numrit të përfituesve të shërbimeve, me rreth 10%, rritje e cila konstatohet tejte e konsiderueshme në bashkinë Has (Figura 2).

Figura 2 - Përfituesit e shërbimeve



Burimi: Studimi, Janar 2025


Tabela 2: Ofruesit, shërbimet dhe përfituesit e përkujdesit shoqëror, sipas tipologjive të ofruesve, numër.

Tipologjitë	Rezidenciale			Ditore			Komunitare			Qendra zhvillimi			Shumëdisiplinore			Strehëz emergjence			Shërbim lëvizës			Fondacione/Shoqata			Gjithsej		
	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P	O	Sh	P
Kukës	1	4	39	1	4	58							1	5	6										3	13	103
Has										1	9	128							1	2	25				2	11	153
Tropojë																						2	5	34	2	5	34
Gjithsej	1	4	39	1	4	58	0	0	0	1	9	128	1	5	6	0	0	0	1	2	25	2	5	34	7	29	290

Burimi: Studimi, Janar 2025

Faktori më thelbësor që ka ndikuar në rritjen e numrit të ofruesve si edhe të shërbimeve që ato sigurojnë, është investimi nëpërmjet fondit social. Siç tregon figura 3, edhe në Kukës, edhe në Has, funksionojnë shërbime të mbështetura nga fondi social. Në nivel qarku, 30% e ofruesve (2/7 ofrues) janë pjesë e projekteve të financuara dhe mbështetura nga fondi social.

Figura 3 - Ofruesit e shërbimeve mbështetur nga fondi social kundrejt të gjithë ofruesve, 2025




Burimi: Studimi, Janar 2025

Tabela 2 evidenton të gjithë ofruesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror sipas tipologjive të tyre, shoqëruar edhe me numrin përkatës të shërbimeve që sigurojnë si edhe me numrin përkatës të përfituesve.

Tabela 2 konfirmon se tipologjitë e ofruesve janë tepër të kufizuara në të tre bashkitë e qarkut, veçanërisht në Tropojë ku vetëm 2 ofrues fondacione private përpiqen të sigurojnë shërbime të përkujdesit shoqëror për grupet në kushte kritike përjashtimi.

Figura 4 paraqit vlerat e treguesit “Shpërndarja e përfituesve për çdo shërbim, sipas tipologjive”.



Burimi: Studimi, Janar 2025

Treguesi i mësipërm i paraqitur në figurën 4, në përputhje me përkufizimin dhe mënyrën e tij të llogaritjes, informon se:

- Bashkia Kukës ofron 6 nga 11 tipologjitë e shërbimeve, Bashkia Has ofron 5, ndërsa bashkia Tropojë vetëm 4 tipologji.
- Shërbimet rezidenciale, në familje dhe të kujdesit alternativ, nuk ofrohen fare në asnjë bashki.
- Shërbimet komunitare dhe strehëzat ofrohen vetëm në bashkinë Kukës, ndërsa shërbimet e këshillimit vetëm në bashkinë Has.
- Është shumë e vështirë që të diskutohet “barazia në akses” në të gjithë qarkun pikërisht për shkak të numrit tejet të kufizuar të tipologjive të ofruesve dhe të shërbimeve, gjë e cila ndikon drejtëpërsëdrejti në numrin e kufizuar të përfituesve për një tipologji shërbimi.

Tabela 3 plotëson kuadrin e vlerësimit të aksesit dhe përdorimit të cilësishëm të shërbimeve, nëpërmjet treguesit tjetër të integruar “Përfitues për një shërbim”, por sipas grupeve kritike, jo më sipas tipologjive të shërbimeve.

Kjo tabelë tregon se:

- Numri i përfituesve sipas grupeve dhe bashkive është tejet i kufizuar.
- Janë gjithsej 4 grupe që përfitojnë shërbime në të gjithë qarkun, konkretisht “Fëmijë me AK” në të tre bashkitë, “të moshuar dhe gra” në dy bashki dhe “të rritur me AK” në dy bashki.
- Ndonëse ndërmjet numrit mesatar të përfituesve për një grup nuk ekziston ndonjë diferencë e thellë, përsëri vlerat janë kaq modeste sa është e vështirë të argumentohet barazia në akses ose cilësia e shërbimeve.

- Vetëm numri mesatar i përfituesve të grupit “të rritur me AK” është relativisht i lartë, por meqenëse ky grup përfiton vetëm në bashkinë Has, nuk është e mundur të krahasohet me ndonjë vlerë tjetër.
